


BARAZIA GJINORE DHE PJESËMARRJA E GRAVE NË SPORTE NË SHQIPËRI

Vlerësim dhe udhëzues i përgjigjshëm gjinor



BARAZIA GJINORE DHE PJESËMARRJA E GRAVE NË SPORTE NË SHQIPËRI

UN WOMEN SHQIPËRI 2024

KLAUZOLA E PËRGJEGJËSISË

Ky botim u mbështet nga UN Women, në kuadër të nismës së Kombeve të Bashkuara 'Të rinjtë dhe të rejat për përfshirje, barazi dhe besim', financuar nga Fondi për Ndërtimin e Paqes i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe zbatuar nga agjencitë dhe përfaqësitë e OKB-së nën drejtimin e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Serbi, në bashkëpunim me UNDP, UNFPA, UNESCO dhe UN Women. Përmbajtja e këtij botimi dhe rezultatet e paraqitura në të përfaqësojnë opinionet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Fondit për Ndërtimin e Paqes të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të UN Women.

Autorë: Edlira Shima, Gazmend Malo

Dizajni dhe faqosja: HL Branding

© 2024 UN Women. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



FALËNDERIME

Hartimi i raportit “Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e grave në sporte në Shqipëri: Vlerësim dhe udhëzues i përgjigjshëm gjinor” u bë i mundur përmes kontributeve, informacioneve dhe udhëzimeve të një numri të madh partnerësh dhe të rinjsh e të rejash aktivë në fushën e sportit në Shqipëri, të cilëve u shprehim falënderimet tona më të përzemërta.

Vlerësimi u krye nga UN Women në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Të rinjtë e të rejtat për përfshirje, barazi dhe besim”. Programi zbatohet nga UNDP, UNFPA, UNESCO, dhe UN Women, me mbështetjen bujare të Fondit për Ndërtimin e Paqes të Kombeve të Bashkuara.

U shprehim mirënjohjen tonë të thellë dy konsulentëve, autorë të këtij vlerësimi, znj. Edlira Shima dhe z. Gazmend Malo, që kryen punë mjaft intensive në terren.

Po kështu, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për z. Michele Ribotta, znj. Estela Bulku, znj. Rachele Megna dhe znj. Danjela Celaj, nga UN Women Shqipëri, për kontributet e vyera dhe mbështetjen e tyre të pareshtur.

Falënderime të veçanta u shkojnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, federatave të futbollit, basketbollit dhe volejbollit; klubeve sportive, gazetarëve sportivë, përfaqësuesve nga bota e biznesit: menaxherëve të nivelit të lartë dhe/ose pronarëve të bizneseve që kanë luajtur rol qendror me mbështetjen e tyre për sportin dhe barazinë gjinore në sporte. Mendimet dhe pikëpamjet e tyre mbi barazinë gjinore në sport, si dhe informacionet e të dhënat e vlefshme, kanë rritur cilësinë dhe thellësinë e këtij vlerësimi.

Së fundi, vlerësojmë së tepërmi kontributin e të gjithë sportistëve dhe sportistëve që u angazhuan në intervista dhe në diskutime në kuadër të grupeve të fokusit, që dhanë informacion të vlefshëm për gjendjen e sporteve në Shqipëri, si edhe rekomandime të rëndësishme për arritjen e barazisë gjinore në sporte në Shqipëri.

PASQYRA E LËNDËS

Falënderime	5
Shkurtesa.....	7
Përmbledhje ekzekutive	8
Hyrje.....	11
Rëndësia e përfshirjes së perspektivës gjinore në sporte.....	11
Objektivat, përdoruesit dhe audienca e këtij vlerësimi	13
Struktura e vlerësimit.....	14
Kapitulli I. Kuadri ligjor, institucional dhe i politikave në lidhje me barazinë gjinore dhe sportet..	15
Kapitulli II. Analizë shumësektoriale e barazisë gjinore në sport dhe përmes sportit në Shqipëri.	32
Metodologjia dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave.....	33
Analiza e situatës: Barazia gjinore në sport	35
Përfundime	50
Rekomandime.....	52
Kapitulli III. Integrimi i barazisë gjinore në sport	56
Si të integrohet barazia gjinore në projekte dhe programe sportive.....	57
Si të integrohet barazia gjinore në gjashtë fushat strategjike të sportit	59
Shembuj të praktikave të mira nga vende të tjera	62
Shembull i praktikës së mirë nga Turqia: Krijimi i kushteve të barabarta për barazi gjinore.....	62
Shembull i praktikës së mirë nga Mbretëria e Bashkuar: Përshpejtuesi i investimeve në sportin e femrave	63
Praktika të tjera të mira nga vendet e BE-së për secilën nga gjashtë fushat strategjike.....	63
Bibliografi	69

SHKURTESA

BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	buxhetim i përgjigjshëm gjinor
DHBGJ	dhuna me bazë gjinore
DHF	dhuna në familje
DHnG	dhuna ndaj grave
FEF	Federata Estoniane e Futbollit
FSHF	Federata Shqiptare e Futbollit
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KEGJFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KiE	Këshilli i Evropës
KON	Komiteti Olimpik Ndërkombëtar
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
KSG	Komisioni për Statusin e Grave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NZZH	Ndihma Zyrtare për Zhvillim
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZHQ(-të)	Objektiv i (Objektivat e) Zhvillimit të Qëndrueshëm
PpVP	Platforma për Veprim e Pekinit
PVGJ	plan i veprimit gjinor
UN Women	Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vitet e fundit sportet janë afirmuar si një forcë e madhe për promovimin e fuqizimit të grave dhe vajzave në të gjithë botën, duke shërbyer si një platformë për mobilizimin e komuniteteve, ndërtimin e besimit reciprok dhe të urave kulturore mes tyre, si edhe si një instrument i rëndësishëm për përhapjen e mesazheve pozitive. Për më tepër, sportet luajnë një rol shumë të rëndësishëm në edukimin, zhvillimin shoqëror dhe promovimin e shëndetit të individëve të të gjitha gjinive, përmes rrënjosjes së vlerave si loja e ndershme, respekti i ndërsjellë dhe puna në grup, si dhe përmes kontributit në zhvillimin e gjithanshëm personal të individëve. Studimet theksojnë ndikimet pozitive që ka integrimi i barazisë gjinore në sporte, ndër të cilët forcimi i shëndetit, vetëvlerësimi, gjithëpërfshirjes sociale dhe fuqizimit të grave dhe vajzave. Gjithashtu, sportet krijojnë mundësi për t'iu kundërvënë normave gjinore ekzistuese dhe për t'i ndryshuar ato, duke u mundësuar grave dhe vajzave që të kenë akses në role udhëheqëse/drejtouese, të zhvillojnë aftësi kyçe, dhe t'iu kundërvihen pritshmëritë e shoqërisë. Për rrjedhojë, integrimi i barazisë gjinore në sporte merr rëndësi qendrore për sigurimin e mundësive të barabarta. Duke bërë punë bindëse në favor të barazisë gjinore në sporte, shoqëritë i hapin rrugën krijimit të një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe të barabartë, duke mundësuar fuqizimin e të gjithë individëve që të përparojnë dhe të japin kontribut pozitiv për ndryshime në shoqëri. Me gjithë aspektet e shumta pozitive të promovimit të barazisë gjinore në sporte, gratë ende ndeshin pengesa në akses dhe pjesëmarrje në sport, që e kanë burimin në normat shoqërore që i lidhin sportet me maskulinitetin.

Objekti kryesor i këtij dokumenti është që të paraqesë një tablo dhe vlerësim të shumanshëm të barazisë gjinore në sport dhe përmes sportit në Shqipëri, si dhe të ofrojë udhëzime konkrete për forcimin e barazisë gjinore në sport, bazuar në praktikën më të mira dhe shembuj të mirë nga vende të ndryshme në Evropë. Ai ofron një tablo të përgjithshme të kornizave ligjore dhe politikave kyçe ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare që rregullojnë barazinë gjinore në sporte; analizon përpjekjet e Shqipërisë për arritjen e barazisë gjinore në sporte; dhe paraqet informacion të vlefshëm për tendencat e përfaqësimit të

grave dhe vajzave në vend. Objekt i këtij vlerësimi janë organizata sportive, institucione publike, mediat, institucione private, komuniteti i donatorëve, dhe të tjerë, që pritet ta përdorin atë si udhëzues parësor në të gjitha përpjekjet për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse ku njerëzit trajtohen si të barabartë, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjithë individëve që të marrin pjesë në sporte pa diskriminim. Vlerësimi analizon situatën e përgjithshme të përfshirjes së grave dhe vajzave në sporte, duke u përqendruar tek futbollin, basketbolin dhe volejbollin, për të identifikuar mundësitë dhe pengesat në fushën e barazisë gjinore, dhe me fokus në gjashtë fusha strategjike: roli udhëheqës/drejtoues, trajnimi, mediat, dhuna me bazë gjinore, pjesëmarrja dhe financimi. Në vlerësim u përdor qasja me metoda të përziera, ndër të cilat studimi i literaturës së fushës, intervistat me palët e interesit dhe pyetësorët.

Vlerësimi është strukturuar në dy pjesë:

PJESA 1: Kapitujt I dhe II fokusohen në një analizë të hollësishme të kuadrit ligjor, institucional dhe të politikave që kanë lidhje me barazinë gjinore dhe sportin, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në atë kombëtar, si edhe ofrojnë një analizë shumësektoriale të barazisë gjinore në sporte dhe përmes sporteve në Shqipëri.

PJESA 2: Kapitulli III ofron udhëzime për integrimin e perspektivave gjinore në të gjitha aspektet e sporteve, si dhe jepen tregues konkretë nga fushat strategjike për të siguruar që politikën, praktikën dhe programet të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht nga gjinia e tyre. Krahas kësaj, në të përvijohen veprimet që duhet të ndërmerren për integrimin e perspektivave gjinore në qeverisjen e organizatave sportive, proceset e vendimmarrjes, politikën dhe programet, që plotësohet me shembuj praktikash të mira nga vendet e Bashkimit Evropian dhe të rajonit të Ballkanit, për të ilustruar strategji të suksesshme zbatimi.

KONSTATIMET KRYESORE

- ⊙ **Përfaqësim i ulët në role udhëheqëse/drejtuese:** Gratë janë tejet të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe menaxhuese të nivelit të lartë në organizata sportive, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel vendor, gjë që pengon pjesëmarrjen dhe ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse.
- ⊙ **Mundësi të kufizuara në role si trajnere dhe menaxhuese:** Gratë hasin pengesa në të gjitha nivelet e roleve të trajnereve dhe menaxhuese në Shqipëri, me një prani veçanërisht të ulët në nivelin e sportit elitare. Perceptimet stereotipike të trajnerëve sportivë si fushë që dominohet nga burrat, së bashku me mbështetjen e pamjaftueshme institucionale, kontribuojnë në vazhdimin e këtij nënpërfaqësimi.
- ⊙ **Pabarazi gjimore në pasqyrim në media:** Ekzistojnë dallime të konsiderueshme në pasqyrimin në media të sporteve të grave dhe të burrave, ku sporteve të burrave u kushtohet shumë më tepër vëmendje. Portretizimet në media të sporteve të grave shpesh përforcojnë stereotipet gjimore, dhe mbulimi dhe përfaqësimi në media i sportistëve dhe trajnereve femra është i kufizuar.
- ⊙ **Lufta kundër dhunës me bazë gjimore:** Ndonëse disa federata kanë vënë në zbatim masa specifike për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjimore në sporte, ende ka vështirësi për garantimin e sigurisë dhe të mirëqenies së grave dhe vajzave në mjediset sportive.
- ⊙ **Nivelet e pjesëmarrjes:** Pjesëmarrja e grave në sporte ka përparuar me kalimin e kohës, por ende mbetet e kufizuar, sidomos ndër gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat përballen me barriera shtesë. Në disa sporte, që tradicionalisht konsiderohen se janë sporte burrash, përfshirja e grave është veçanërisht e ulët.
- ⊙ **Nivel i ulët investimesh:** Investimet e pamjaftueshme në sportet e grave, përfshirë në financime dhe alokimin e burimeve, pengojnë pjesëmarrjen në to të grave dhe vajzave. Investimet e pamjaftueshme në objekte dhe pajisje sportive i përkeqësojnë edhe më shumë këto pabarazi.

REKOMANDIMET KRYESORE

Për organet e qeverisjes qendrore:

- ⊙ **Rishikimi i legjislacionit:** Të miratohen ose rishikohen legjislacioni dhe politikat që lidhen me sportet, për të siguruar integrimin e strategjive të përfshirjes së perspektivës gjimore në politikat e sporteve publike dhe të edukimit fizik.
- ⊙ **Integrimi i perspektivës gjimore në buxhetim:** Të integrohet perspektiva gjimore në proceset buxhetore që lidhen me sportet, me qëllim që të promovohet akses i barabartë në burimet sportive për gratë dhe vajzat.
- ⊙ **Dhuna me bazë gjimore:** Të zbatohen dhe monitorohen politika për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjimore në sporte, duke bashkëpunuar me organizatat sportive dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC).
- ⊙ **Bashkëpunimi me OSHC-të:** Të bashkëpunohet me OSHC-të për të promovuar pjesëmarrjen e grave në sporte përmes veprimtarive informuese dhe ndërgjegjësuere.

Për organet e qeverisjes vendore:

- ⊙ **Rritja e ndërgjegjësimi:** Të rritet ndërgjegjësimi lidhur me mundësitë për veprimtari sportive dhe mbështetjen financiare që mund të ofrohet, sidomos ndër nxënësit e shkollave.
- ⊙ **Investime në infrastrukturë:** Të sigurohet infrastrukturë e aksesueshme dhe pajisje sportive të përshtatshme në programet sportive vendore, përfshirë objektet sportive të përshtatshme për sportet e grave.
- ⊙ **Trajnim me ndjeshmëri gjimore:** Të përfshihen programe trajnimi me ndjeshmëri gjimore në planet për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve vendorë.

Për Komitetin Olimpik:

- ⊙ **Barazi gjimore në gara, ndeshje dhe kampionate:** Të sigurohet numër i barabartë i ekipeve dhe atletëve nga të dyja gjinitë në sportet dhe garat ekipore, si edhe paraqitje e

barabartë e garave dhe ndeshjeve të grave dhe burrave në kalendarët e kampionateve.

- ⊙ **Promovimi i sigurisë në sporte:** Të promovohen sportet e sigurta dhe të mbrohen atletët dhe atletet nga ngacmimet dhe abuzimi, përmes alokimit të burimeve nga buxheti operacional.
- ⊙ **Zhvillimi i sistemit të mundësive për promovim:** Të krijohen mekanizma për të shtuar mundësitë e kandidateve femra për të qenë në poste drejtuese, përfshirë përmes programeve për rekrutime të fokusuara, zhvillim të aftësive drejtuese, si edhe përmes programeve të mentorimit dhe sponsorizimit.

Për organizatat sportive:

- ⊙ **Investime në sportet e grave:** Të shtohen investimet në sportet e grave për të mbështetur zhvillimin dhe përparimin e tyre.
- ⊙ **Konsultime:** Të kryhen konsultime të shumta me palët e interesit për të kuptuar më mirë nevojat specifike gjinore dhe për t'iu përgjigjur atyre.
- ⊙ **Angazhimi i aleatëve meshkuj:** Të angazhohen atletë, gazetarë, trajnerë dhe të tjerë aleatë meshkuj për të përkrahur dhe mbrojtur sportet e grave dhe për të avokuar për barazi gjinore.
- ⊙ **Politika mbrojtëse:** Të zbatohen politika dhe procedura ruajtëse dhe mbrojtëse për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e të gjithë pjesëmarrësve.

- ⊙ **Monitorimi i të dhënave:** Të bashkëpunohet në monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të bërë në pjesëmarrjen e balancuar të vajzave, djemve, grave dhe burrave në sporte, bazuar në të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht.

Për sektorin privat dhe mediat:

- ⊙ **Mbështetje për ekipet e femrave:** Të shtohet mbështetja për ekipet profesioniste të femrave dhe sponsorizimet për sportistet, me qëllim promovimin e barazisë gjinore në sporte.
- ⊙ **Promovim i barazisë gjinore:** Të vazhdohet promovimi i mesazheve pozitive të barazisë gjinore në reklamat që lidhen me sportet, me qëllim luftimin e stereotipeve.
- ⊙ **Pasqyrim pa stereotipizim:** Të përcillen imazhe jo të stereotipizuara të grave dhe burrave në sporte, duke eliminuar përmbajtjen dhe gjuhën seksiste në pasqyrimin e tyre në media.
- ⊙ **Balanca gjinore në media:** Të sigurohet një pjesëmarrje e balancuar e grave dhe burrave në mediat sportive përmes punësimit të gazetarëve sportive femra dhe mbështetjes së karrierës së tyre në radhët e personelit redaktorial. Të bëhen përpjekje për mbulim dhe transmetim të barabartë në media të sporteve të femrave.



HYRJE

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË PERSPEKTIVËS GJINORE NË SPORTE

Vitet e fundit, sporti ka treguar kapacitet të jashtëzakonshëm për të çuar përpara fuqizimin e grave dhe vajzave. Ai mobilizon komunitetin global dhe angazhon rininë, bashkon njerëzit përtej kufijve kombëtarë dhe dallimeve kulturore. Sporti është një instrument i fuqishëm për përcjelljen e mesazheve të rëndësishme në një mjedis pozitiv dhe festiv – shpesh tek audienca masive. Krahas kësaj, u mëson grave dhe vajzave vlerat e punës në grup, të mbështetjes në forcat e veta dhe të përballimit të vështirësive; ka efekt të shumëfishtë në zhvillimin shëndetësor, arsimor dhe të aftësive drejtuese; kontribuon në forcimin e vetëvlerësimit, ndërton lidhje shoqërore dhe u kundërvihet normave të dëmshme shoqërore.¹ Në të gjithë botën, gratë marrin më pak pjesë në veprimtari sportive se burrat. Po kështu, gratë janë të nënpërfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucioneve sportive.²

Sporti është një proces shoqëror dhe kulturor ku nocionet shoqërore të maskulinitetit dhe feminitetit luajnë rol të rëndësishëm:

- Tradicionalisht, sporti është lidhur me «maskulinitetin». Në shumë shoqëri konsiderohet e papërshtatshme që gratë të merren me sport dhe, ato që merren me sport, mund të perceptohen si «mashkullore».³ Nga ana tjetër, burrat që nuk merren me sport ose që nuk kanë talent për sporte mund të etiketohen si «joburrërorë». Ndonëse maskuliniteti dhe feminiteti janë koncepte të krijuara nga shoqëria, sportet mund të ofrojnë një hapësirë ku nocionet tradicionale të maskulinitetit dhe feminitetit të rinegociohen në vend që të rikonfirmohen.
- Përkatësia dhe vetidentifikimi me një kulturë specifike, grup etnik, klasë socio-ekonomike ose kastë, gjithashtu luan rol në mënyrën se si dikush angazhohet në sport. Gratë dhe burrat priren të merren me lloje të ndryshme aktiviteteve fizike dhe qëndrimet e tyre ndaj sportit mund të jenë shumë të ndryshme. Për disa njerëz, gjëja më e rëndësishme në shumë sporte është aspekti i tyre konkurrues, ndërsa për disa të tjerë, sportet mund të jenë thjesht një mundësi për t'u mbledhur dhe për të kaluar kohën me të tjerë.
- Ushtrimi i sportit lidhet me një sërë supozimesh rreth punës dhe kohës së lirë, të cilat shpesh përjetojnë ndryshe nga gratë dhe burrat. Për këtë arsye, disa shoqëri e vlerësojnë sportin si një veprimtari produktive që kontribuon në shëndetin fizik të forcave të punës, sidomos të atyre që kryejnë punë fizike.⁴ Pavarësisht se numri i grave që marrin pjesë në forcat e punës është në rritje, duke qenë se puna e rëndë fizike (si për shembull në ndërtim, prodhim industrial, bujqësi, etj.) kryhet më së shumti nga burrat, prej tyre pritet të jenë më aktivë dhe të marrin pjesë më shumë në sporte, për të qenë në gjendje ta kryejnë më mirë punën fizike. Nga ana tjetër, kujdesi për të sëmuret dhe të moshuarit, rritja e fëmijëve dhe punët e tjera në shtëpi – veprimtaritë riprodhuese dhe të papaguara – ende kryhen më së shumti nga gratë dhe vajzat dhe përgjithësisht nuk njihen shoqërisht dhe ekonomikisht si punë. Veprimtaritë riprodhuese që kryhen jashtë shtëpisë dhe që njihen si “punë”, që shpesh janë punë të paguara – dhe

1. UN Women (2020). *Sport for Generation Equality: advancing gender equality in and through sport* (Sporti për brezin e barazisë: avancimi i barazisë gjinore në sport dhe përmes sportit). Gjetet në: <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/3/news-sport-for-generation-equality>

2. Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ). *Gender in Sport* (Gjinia në sport). Gjetet në: https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/ti_pubpdf_mh0616311enn_pdfweb_20170125171327_corr.pdf

3. Agjencia Zvicerane për Zhvillim.

4. *Gender and Sports, Mainstreaming Gender in Sports Projects* (Gjinia dhe sportet: integrimi i gjinisë në projekte sportive). Gjetet në: https://www.sportanddev.org/sites/default/files/downloads/9_gender_and_sport_mainstream_gender_in_sports_projects.pdf

sidomos kur kryhen nga burrat – bartin me vete të drejtën për të pasur kohë të lirë jashtë punës.

Për shkak të këtyre konsideratave, integrimi i barazisë gjinore në sporte është i rëndësishëm pasi mund të ndihmojë të sigurojë që të gjitha ndërhyrjet në fushën e sporteve të shtojnë mundësitë e grave dhe burrave për të ushtruar plotësisht të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë dhe për të pasur akses dhe kontroll të barabartë në të mirat e zhvillimit. Vlerësimi aktual i shkallës së integritit të barazisë gjinore në sporte në Shqipëri ofron një analizë të bazuar në fakte të gjendjes, sfidave, dhe mundësive aktuale, si dhe jep informacion dhe njohuri të vlefshme për përpjekjet në vijimësi për nxitjen e barazisë gjinore në fushën e sporteve. Në këtë vlerësim gjinor të sporteve shqyrtohet me kujdes mënyra se si sportet në Shqipëri ofrojnë mundësi të drejta dhe të barabarta për gratë dhe për burrat. Në të analizohen disa dallime dhe sfida, si dhe jepen udhëzime se si sportet të bëhen më gjithëpërfshirëse dhe të ofrojnë mundësi më të drejta si për burrat, ashtu edhe për gratë, në Shqipëri. Sportet u ofrojnë vajzave, djemve, grave dhe burrave mjedis të favorshëm për të mësuar për punën në ekip, menaxhimin e kohës dhe disiplinën, që janë aspekte me rëndësi edhe në kontekstet arsimore dhe profesionale dhe mund të kontribuojnë më shumë në suksesin e përgjithshëm të tyre. Po kështu, ato mundësojnë që vajzat dhe djemtë të mbruhen me vlera thelbësore si loja e ndershme, respekti për të tjerët dhe respektimi i rregullave, toleranca dhe përgjegjësia, të cilat i ndihmojnë të përgatiten për të qenë qytetarë të përgjegjshëm. Sportet mund të promovojnë integrimin shoqëror të grupeve të pafavorizuara dhe me cenueshmëri të shumta, si dhe mund të kontribuojnë për një mirëkuptim më të mirë midis komuniteteve, përfshirë në

zona pas konfliktit.⁵Një numër studimesh kanë konfirmuar rëndësinë e integritit të barazisë gjinore në sporte dhe ndikimet pozitive të tij:

- **Shëndeti dhe mirëqenia e grave dhe vajzave.** Studimet kanë treguar se pjesëmarrja në sportet individuale dhe ekipe sportive kontribuon në arritjen e rezultateve të mira fizike, shoqërore, psikologjike dhe kognitive. Pjesëmarrja në sporte, sidomos në sportet me ekipe, lidhet me një shëndet mendor dhe mirëqenie psikologjike më të madhe tek të rriturit.⁶ Studimet tregojnë se gratë që kryejnë veprimtari fizike të rregullta kanë më pak gjasa të vuajnë nga osteopenia dhe osteoporozja,⁷ kanë densitet më të madh mineralesh në eshtra, që ul rrezikun e çrregullimeve dhe të frakturave ndër gratë më të moshuara, si dhe kanë nivel më të ulët të yndyrave, që ul rrezikun e kancerit të mushkërive dhe të gjirit. Studimet kërkimore në fushën e shëndetit riprodhues dhe të përdorimit të paligjshëm të drogave tregojnë se sportistet femra kanë më pak gjasa të shfaqin sjellje seksuale të rrezikshme⁸ dhe më shumë gjasa të përdorin kontraceptivë.⁹ Prova të mbledhura ndër vajzat dhe gratë e reja në vendet me të ardhura të larta tregojnë gjithashtu se sportistet femra kanë më pak gjasa të përdorin droga (si kokainë, marihuanë, etj.) se sa ato që nuk janë sportiste.¹⁰
- **Vetëvlerësimi dhe vetëfuqizimi i vajzave dhe grave.** Disa studime në fushën e vetëvlerësimit sugjerojnë se vajzat dhe gratë që marrin pjesë në sporte dhe veprimtari fizike tregojnë vlerësim më të

5. *Recommendation CM/Rec(2015)2 of the Committee of Ministers to member States on gender mainstreaming in sport* Rekomandimi CM/Rec(2015)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me integrimin gjinor në sport (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 janar 2015 në mbledhjen e 1217 të të zëvendësministrave). Gjetet në: <https://www.icsspe.org/system/files/Council%20of%20Europe%20-%20Recommendation%20Gender%20Mainstreaming%20CM%20Rec%20%282015%292.pdf>

6. Eather, N., Wade, L., Pankowiak, A. et al. *The impact of sports participation on mental health and social outcomes in adults: a systematic review and the 'Mental Health through Sport' conceptual model* (Ndikimi i pjesëmarrjes në sporte në shëndetin mendor dhe arritjet sociale të të rriturve: studim sistematik dhe model konceptual mbi shëndetin mendor përmes sportit) Syst Rev 12, 102 (2023), <https://doi.org/10.1186/s13643-023-02264-8>

7. *The role of sport in gender equality* (Roli i sportit në barazinë gjinore). Gjetet në: <https://www.sportanddev.org/thematic-areas/gender/role-sport-addressing-gender-issues#:~:text=Current%20research%20indicates%20that%20regular%20physical%20activity%20may,developing%20bone%20disorders%20and%20fractures%20among%20older%20women.>

8. Po aty.

9. *The role of sport in gender equality* (Roli i sportit në barazinë gjinore). Gjetet në: <https://www.sportanddev.org/thematic-areas/gender/role-sport-addressing-gender-issues>

10. Organizata Sportanddev. *The role of sports in addressing gender issues* (Roli i sporteve në adresimin e çështjeve gjinore). Gjetet në: <https://www.sportanddev.org/thematic-areas/gender/role-sport-addressing-gender-issues>

madh për veten, si edhe perceptim, vlerësim, dhe efikasitet, etj., më të mirë të vetes, falë ndjenjave më të forta të arritjeve dhe suksesit, perceptimit të përmirësimit të pamjes fizike dhe përkushtimit ndaj aktivitetit fizik. Përfshirja në veprimtari sportive ndihmon vajzat të forcojnë ndjenjat e të qenit të zonjat e vetes, të vetëfuqizimit, autonomisë më të madhe trupore dhe lirisë personale.

- ⊙ **Përfshirja sociale dhe integrimi social i grave dhe vajzave.** Ekziston një mori provash bindëse që dëshmojnë për marrëdhënien midis pjesëmarrjes në sporte dhe integritit social dhe përfshirjes sociale të grave dhe vajzave. Për shembull, të dhënat nga intervistat me sportistë dhe sportiste në kuadër të këtij studimi tregojnë se vajzat dhe gratë e reja me prejardhje të ndryshme mund ta përdorin futbollin si platformë për t'u shoqëruar me njëra-tjetrën, për të këshilluar dhe ndihmuar njëra-tjetrën, për të krijuar miqësi dhe për të forcuar marrëdhëniet me njerëzit. Studime të ngjashme sugjerojnë se sportet luajnë rol thelbësor në forcimin e kohezionit social dhe nxitjen e ndërveprimit social ndër gratë dhe vajzat e reja, përfshirë ndër ato me prejardhje të ndryshme shoqërore dhe ekonomike.¹¹

- ⊙ **Kundërshtimi dhe transformimi i normave gjinore.** Sportet mund të ndihmojnë në promovimin e objektivave më të gjera të barazisë gjinore, duke u dhënë grave dhe vajzave akses në mjedise publike dhe në pozita udhëheqëse/drejtuese, duke nxitur zhvillimin e aftësive dhe shprehive të reja dhe duke u mundësuar grave dhe vajzave që të kenë mbështetjen e të tjerëve dhe të gëzojnë lirinë e shprehjes dhe të lëvizjes. Ato mund të promovojnë arsimimin, komunikimin, aftësitë negociuese dhe udhëheqëse/drejtuese – të cilat që të gjitha janë thelbësore për fuqizimin e grave.¹²

OBJEKTIVAT, PËRDORUESIT DHE AUDIENCA E KËTJ VLERËSIMI

Objektivi kryesor i këtij dokumenti është që të ofrojë një pasqyrë dhe vlerësim të gjithanshëm të barazisë gjinore në sporte dhe përmes sporteve në Shqipëri, si dhe udhëzime konkrete për forcimin e barazisë gjinore në sporte, bazuar në praktikatat më të mira dhe në shembuj të mirë nga vende të ndryshme të Evropës.

OBJEKTIVA SPECIFIKËS

- ✓ Të ofrohet një tablo e dokumenteve dhe politikave kyçe ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për rritjen e disponueshmërisë së të dhënave dhe njohurive mbi sportet dhe barazinë gjinore në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke e lidhur këtë me kontekstin shqiptar;
- ✓ Të analizohen përpjekjet e Shqipërisë drejt arritjes së barazisë gjinore në sporte;
- ✓ Të paraqitet informacion i vlefshëm dhe rekomandime mbi nevojat e grave dhe vajzave në sporte në vend, përmes historive dhe përvojave të tyre jetësore.

Përdoruesit e këtij vlerësimi janë organizata sportive, institucione publike, mediat, institucione private, komuniteti i donatorëve, etj., nga të cilët pritet ta përdorin këtë dokument si burim kryesor udhëzues në të gjitha përpjekjet e tyre për të krijuar mjedise gjithëpërfshirëse dhe të barabarta, që promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizojnë të gjithë individët që të marrin pjesë në sporte pa diskriminim.

11. Katherine Raw, Emma Sherry & Katie Rowe (2022) *Sport for social cohesion: exploring aims and complexities*, *Sport Management Review* (Sporti për arritjen e kohezionit social: qëllimet dhe kompleksitetet, Revista e Menaxhimit Sportiv) , 25:3, 454-475, DOI: 10.1080/14413523.2021.1949869

12. European Institute for Gender Equality (Instituti Evropian për Barazi Gjinore) (2017). *Gender in Sport* (Gjinia në sport). Gjendet në: https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/policy-areas/sport?language_content_entity=en

STRUKTURA E VLERËSIMIT

Ky udhëzues është strukturuar në dy pjesë:



Pjesa 1 (Kapitujt I dhe II): Kapitulli I ofron një analizë të hollësishme të kuadrit ligjor, institucional, dhe të politikave mbi barazinë gjinore dhe sportet, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe në nivel kombëtar. Në Kapitullin II bëhet një analizë shumësektoriale e barazisë gjinore në sporte dhe përmes sporteve në Shqipëri. Kjo analizë gjinore shumësektoriale merr në shqyrtim kuadrin ligjor dhe të politikave lidhur me statusin, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave në sporte (futboll, basketboll dhe volejbol). Analiza vlerëson mundësitë, sfidat dhe dallimet me të cilat përballen gratë dhe vajzat në këto sporte dhe ofron përfundime dhe rekomandime specifike për secilin palë të interesit.



Pjesa II (Kapitulli III). Kapitulli III ofron udhëzime për përfshirjen e perspektivave gjinore në të gjitha aspektet e sporteve. Në këtë pjesë jepen udhëzime dhe tregues konkretë për secilën prej fushave strategjike për të siguruar që politikat, praktikrat dhe programet të jenë të ndjeshme ndaj çështjeve që lidhen me gjininë dhe të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht nga gjinia e tyre. Gjithashtu, në të ofrohen udhëzime mbi veprimet kyçe që duhen ndërmarrë për integrimin e perspektivave gjinore në të gjitha aspektet e organizatave sportive, si qeverisja, proceset e vendimmarrjes, politikrat dhe programet. Këtu janë përfshirë edhe disa nga praktikrat më të mira nga vendet e BE-së dhe vende të tjera në rajon që kanë trajtuar me sukses pabarazitë në sporte, si ilustrim për zbatimin e disa veprimeve konkrete në këtë fushë.

KAPITULLI I.

KUADRI LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE I
POLITIKAVE NË LIDHJE ME BARAZINË
GJINORE DHE SPORTET



KUADRI LIGJOR DHE POLITIK NDËRKOMBËTAR

ANGAZHIMET E OKB-SË DHE STANDARDE TË TJERA TË APLIKUESHME NDËRKOMBËTARE MBI BARAZINË GJINORE DHE SPORTET

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGJFDG),¹³ miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979, njeh specifikisht se gratë dhe vajzat kanë të njëjtat të drejta si burrat dhe djemtë “për të marrë pjesë në aktivitete zbavitëse, sportive, dhe në të gjitha aspektet e jetës kulturore” (neni 13c), dhe se shtetet duhet të sigurojnë të njëjtat mundësi për gratë dhe vajzat në fushën e arsimit “për të marrë pjesë aktivisht në sporte dhe edukim fizik” (neni 10g).

Platforma për Veprim e Pekinit (PpVP),¹⁴ miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në vitin 1995, është projekti më progresiv për përparimin e të drejtave të grave. Ajo njeh të drejtën për akses në sport për të gjithë individët në të gjithë botën dhe, në të sporti, përmendet posaçërisht: “Të sigurohen objekte zbavitëse dhe sportive të aksesueshme dhe të krijohen dhe forcohen programe të ndjeshme gjinore për vajzat dhe gratë e të gjitha moshave në institucione arsimore dhe komunitare dhe të mbështetet avancimi i grave në të gjitha fushat e atletikës dhe aktiviteteve fizike, përfshirë trajnimin, menaxhimin dhe administrimin, si edhe si pjesëmarrëse në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare”. Gjithashtu, PpVP-ja bën thirrje për krijimin e programeve arsimore që u ofrojnë të njëjtat mundësi vajzave dhe grave të të gjitha moshave që të marrin pjesë në sporte, aktivitete fizike dhe zbavitëse si ato që u ofrohen burrave dhe djemve. Platforma përmend gjithashtu ekzistencën e

stereotipeve negative sa u takon grave dhe burrave në role vendimmarrëse dhe vë në dukje përfaqësimin e ulët të grave në pozita vendimmarrëse në fushat e artit, kulturës dhe sporteve. Platforma fokusohet në shembjen e barrierave sistemike që i pengojnë gratë dhe vajzat të ushtrojnë në praktikë të drejtat e tyre dhe të shfrytëzojnë mundësitë për zhvillim dhe rritje.

Komisioni për Statusin e Grave (KSG), një organ ndërqeveritar global që harton politika të barazisë gjinore, i ka trajtuar sportet dhe aktivitetin fizik në kuadër të vlerësimit të përparimit të bërë në zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit.¹⁵ Në përfundimet e tij mbi gratë dhe shëndetin, KSG u bëri thirrje qeverive, Kombeve të Bashkuara, dhe shoqërisë civile që të inkurajojnë gratë të ushtrojnë sporte dhe të marrin pjesë në aktivitete zbavitëse, duke theksuar ndikimin pozitiv të tyre në shëndetin fizik, mirëqenien, shëndetin mendor dhe gjendjen fizike të grave, si dhe t’u sigurojnë grave akses në mundësi të barabarta për ushtrimin e sporteve, përdorimin e objekteve sportive, dhe pjesëmarrjen në gara sportive njësoj si burrat.

Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK),¹⁶ miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2006, në nenin 30, rikonfirmon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara “për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në aktivitete argëtuese, të kohës së lirë dhe sportive.” Në të njëjtin nen, Konventa i nxit shtetet të marrin masat e duhura që “të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive dhe argëtuese të përshtatura për aftësitë e kufizuara. Për

13. <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>

14. UN Women (2014) *Beijing Declaration and Platform for Action: Beijing+5 Political Declaration and Outcome* (Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim: Deklarata politike e Pekinit +5 dhe rezultati). Gjetet në: https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSW/PFA_E_Final_WEB.pdf

15. Kombet e Bashkuara (2010) *Agreed Conclusions of the Commission on the Status of Women on the Critical Areas of Concern of the Beijing Platform for Action 1996-2009* (Përfundimet e rena dakord të Komisionit për Statusin e Grave dhe fusha shqetësuese kritike të Platformës për Veprim të Pekinit 1996-2009). Gjetet në: <https://doi.org/10.18356/5fa286bb-en>.

16. <https://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>

këtë qëllim, të inkurajojnë ofrimin e instruksioneve, trajnimit dhe burimeve të duhura, njësoj si gjithë të tjerët” si edhe “të sigurojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në lojëra, aktivitete argëtuese, sportive dhe të kohës së lirë, ndër të cilat edhe aktivitetet që zhvillohen në sistemin shkollor.”

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF),¹⁷ miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989, i njeh “fëmijës të drejtën të pushojë dhe të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari të kohës së lirë të përshtatshme për moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike” (neni 31).

Deklarata e Maglingenit¹⁸ mbi rolin e sporteve në zhvillim, u nënshkrua në Zvicër në vitin 2003. Pas Konferencës së Maglingenit, u krijua Platforma Ndërkombëtare për Sportin dhe Zhvillimin, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Kombet e Bashkuara, federata sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata joqeveritare (OJQ) dhe organe të tjera sportive. Deklarata e Maglingenit e përkufizon sportin si një e drejtë njerëzore. Por, përveç faktit se në të gjitha pjesët e rekomandimeve përmendet rëndësia që ka përfshirja e grave dhe të grupeve të tjera të marginalizuara në nismat sportive dhe përmendjes shprehimisht të nevojës për eliminimin e stereotipizimit gjinor, njohja e natyrës së gjinorizuar të sportit në këtë Deklaratë është e paktë.

Deklarata e Brajtonit (Brighton) dhe Thirrja për Veprim e Uindhuk-ut (*Windhoek*). Konferenca e Parë Botërore mbi Gratë dhe Sportet u mbajt në Brajton të Britanisë së Madhe, në vitin 1994. Ajo u kurorëzua me Deklaratën e Brajtonit dhe krijimin e Grupit Ndërkombëtar të Punës për Gratë dhe Sportet. Në vitin 1995, sporti u përfshi në Platformën për Veprim të Pekinit (paragrafët 83, 107, 290) dhe më vonë në dokumentin Rezultati i Pekinit+5, pesë vjet më vonë. Konferenca e Dytë Botërore për Gratë dhe Sportet u zhvillua në Uindhuk, Namibi, në vitin 1998. Thirrja për veprim kërkon pjesëmarrjen e grave në sport si dhe promovimin e sportit si mjet për realizimin e objektivave më të përgjithshme në shëndetësi, arsim dhe

të drejtat e njeriut të grave – një ide që u promovua më tej në Konferencën e Tretë për Gratë dhe Sportet në Montreal, Kanada, në vitin 2002. Kjo ka të bëjë me integrimin e sportit në projekte zhvillimi në komunitete, fushata informuese për shëndetin dhe çështje të tjera, dhe fushata kombëtare avokimi për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave.

Deklarata e Brajtonit bën thirrje për:

- ⊙ Mundësi të drejta dhe barazi në shoqëri dhe sport.
- ⊙ Planifikim, hartim dhe menaxhim të objekteve sportive për t’iu përgjigjur nevojave të grave.
- ⊙ Rol udhëheqës/drejtues, përfshirë përmes rritjes së numrit të grave trajnere, këshilltare dhe vendimmarrëse.
- ⊙ Programe arsimore, edukative, trajnimi dhe zhvillimi që trajtojnë barazinë gjinore.
- ⊙ Informacion dhe studime mbi gratë dhe sportin.
- ⊙ Burime për gratë sportiste dhe për programe të posaçme për rritjen e pjesëmarrjes së grave në sport.
- ⊙ Bashkëpunim brenda vendit dhe ndërkombëtar, si dhe shkëmbim të njohurive dhe përvojave.

Deklarata e Uindhukut bën thirrje për:

- ⊙ Më shumë bashkëpunim ndërmjet agjencive të ndryshme përgjegjëse për çështjet e grave në sport dhe midis këtyre agjencive dhe aktorëve të tjerë që punojnë për të drejtat e grave dhe barazi gjinore.
- ⊙ Programe të ndihmës ndërkombëtare që “ofrojnë mundësi të barabarta për zhvillimin e vajzave dhe të grave dhe njohin potencialin e sportit për të arritur objektivat e zhvillimit.”

17. <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>

18. Deklarata e Maglingenit. Gjetet në: https://www.sportanddev.org/sites/default/files/downloads/18_the_maglingen_declaration.pdf

Në nëntor të vitit 2003 u miratua Rezoluta 58/5 e Kombeve të Bashkuara, e cila u bëri thirrje qeverive që ta përdorin sportin si mjet për promovimin e arsimit, shëndetit, zhvillimit dhe paqes. Nga kampionatet sportive profesioniste elitare deri tek lojërat e zhvilluara në nivel komuniteti apo në institucione arsimore, sporti mund të përdoret për të arritur një numër objektivash zhvillimorë, ndër të cilët:

- Zhvillimi njerëzor: përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së publikut, mbështetja e arsimit dhe aktiviteteve të kohës së lirë.
- Zhvillimi social: promovimi i stabilitetit, tolerancës, përfshirjes sociale dhe i forcimit të komuniteteve.
- Zhvillimi ekonomik: shtimi i investimeve dhe i mundësive të punësimit.
- Zhvillimi politik: promovimi i paqes dhe respektimit të rregullave të demokracisë.

Në vitin 2020, nën drejtimin e UN Women, u krijua **nisma "Sportet për brezin e barazisë"**¹⁹ "që synon përshtetimin e përparimit në lidhje me një numër parimesh të përbashkëta dhe objektivash të harmonizuara, që do të shfrytëzojnë fuqinë e sportit për ta bërë barazinë gjinore realitet në sport dhe përmes sportit," (f.1). Parimet e Sportit për Brezin e Barazisë bazohen në Planin e Veprimit të Kazanit²⁰ dhe në PpVP, dhe trajtojnë fusha kritike shqetësuese dhe objektivat në lidhje me barazinë gjinore në sport, duke kërkuar që:

- Të bëhen përpjekje për të promovuar rolin udhëheqës/drejtnes të grave dhe barazinë gjinore në modelet e qeverisjes.

- Të bëhen përpjekje për të parandaluar dhe për t'iu kundërvënë dhunës ndaj grave dhe vajzave në sport dhe përmes sportit.
- Të ndërmerren hapa për eliminimin e dallimit në investime në sportet e grave dhe të promovohen mundësi ekonomike të barabarta për gratë dhe vajzat.
- Të bëhen përpjekje për të nxitur pjesëmarrjen e barabartë dhe përfaqësimin pa paragjykime të grave në mediat sportive, përfshirë përmes komunikimeve për eliminimin e stereotipeve të dëmshme gjinore dhe promovimin e shembujve pozitivë.
- Të bëhen përpjekje për të mbështetur mundësi të barabarta për gratë në sporte, aktivitete fizike dhe edukim fizik.
- Të bihet dakord për të monitoruar dhe për të raportuar çdo vit publikisht lidhur me përparimin e bërë.

E drejta njerëzore bazë për të marrë edukim fizik dhe për të pasur akses të papenguar në sporte u theksua edhe në **Kartën për Edukimin Fizik dhe Sportet të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO)**:²¹ "Çdo qenie njerëzore ka të drejtën themelore për të pasur akses në edukim fizik dhe sporte, që janë thelbësore për zhvillimin e plotë të personalitetit të tij/saj. Liria për të zhvilluar aftësi fizike, intelektuale dhe morale përmes edukimit fizik dhe sportit duhet të garantohej si brenda sistemit arsimor, ashtu edhe në aspekte të tjera të jetës sociale." (neni 1). Karta u rishikua në vitin 2015,²² duke përcaktuar më tej se "mundësia e barabartë për të marrë pjesë dhe për t'iu përfshirë në të gjitha nivelet e mbikëqyrjes dhe të vendimmarrjes në edukim fizik, aktivitet fizik dhe sport, qoftë për

19. UN Women (2020) *Sports for Generation Equality Framework: Driving Implementation of the Beijing Platform for Action through the Power of the Sport Ecosystem* (Sportet në kuadrin e brezit të barazisë: Forcimi i zbatimit të Platformës për Veprim të Pekinimit përmes forcës së ekosistemit të sportit). Gjetet në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/News%20and%20events/Stories/2020/Sport-GenerationEquality.pdf>

20. <https://www.un.org/development/desa/dspd/wp-content/uploads/sites/22/2018/06/10.pdf>

21. Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (1978). *International Charter of Physical Education and Sport* (Karta Ndërkombëtare e Edukimit Fizik dhe Sportit). Gjetet në: https://en.unesco.org/sites/default/files/sport_e.pdf

22. Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (2015) *International Charter of Physical Education and Sport* (Karta Ndërkombëtare e Edukimit Fizik dhe Sportit). Gjetet në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000235409>

qëllime argëtimi, të forcimit të shëndetit apo për arritje të larta sportive, është e drejtë e çdo vajze dhe çdo gruaje që duhet të zbatohet aktivisht” (neni 1).

Agjenda e Zhvillimit të Qëndrueshëm e OKB-së²³ trajton OZHQ 5 dhe kërkon veprime urgjente për eliminimin e shkaqeve të diskriminimit që i pengojnë gratë të realizojnë të drejtat e tyre në të gjitha sferat e jetës. Të drejta dhe mundësi të barabarta për vajzat në të gjitha fushat, përfshirë edhe përmes sportit, janë pjesë e përpjekjeve për arritjen e këtij objektiv. Krahas kësaj, OZHQ 3, “sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë, në të gjitha moshat”, është gjithashtu i rëndësishëm, duke pasur parasysh ndikimin e sportit tek shëndeti. Sporti për zhvillim është një mjet i fuqishëm për arritjen e ndryshimeve sociale, zhvillimit social dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Ai luan një rol të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe, duke i kontribuar solidaritetit, mosdiskriminimit, përfshirjes sociale, diversitetit dhe respektit.

Sporti shpallet si e drejtë njerëzore edhe nga **Karta Olimpik**,²⁴ në seksionin “Parimet themelore të olimpizmit”, ku shtohet se kjo e drejtë duhet të ushtrohet pa diskriminim të asnjë lloji, për të cilën janë shumë të rëndësishme fryma e miqësisë, solidaritetit dhe e lojës së ndershme. Karta thekson gjithashtu rëndësinë e sigurimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrje në sport, që duhet të bëhet e mundur për çdo individ, pavarësisht nga gjinia. Në vitin 2017, u miratua **Plani i Veprimit i Kazanit**²⁵, i cili lidh politikat sportive me OZHQ-të. Në bazë të Planit të Veprimit të Kazanit, në vitin 2021 u krijua në Lozanë të Zvicrës Observatori Global për Gratë, Sportin, Edukimin Fizik dhe Aktivitetin Fizik, që synon kapërcimin e pabarazive globale dhe sistematike me të cilat përballen vajzat dhe gratë në sport.²⁶

Objektivat e Barazisë Gjinore dhe të Përfshirjes 2021-2024²⁷ të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON) rekomandojnë pesë fusha kryesore që janë harmonizuar me parimet e nismës së UN Women “Sportet për brezin e barazisë”.

Objektivat fokusohen në këto fusha:



Pjesëmarrja: Akses dhe mundësi për të gjithë sportistët dhe sportistët në fushën e lojës, si dhe për stafin e organizatave sportive.



Roli udhëheqës/drejtues: Pozita me kompetenca vendimmarrëse dhe/ose me ndikim.



Sporti i sigurt: Një mjedis sportiv ku njerëzit trajtohen me respekt, në mënyrë të drejtë dhe pa asnjë formë ngacmimi.



Portretizimi: Gjuha, pamjet dhe zërat e përdorur, cilësia dhe sasia e pasqyrit dhe vendi që zënë në përshkrimet e individëve ose grupeve në komunikime dhe në media.



Alokimi i burimeve: Shpërndarja e fondeve, objekteve dhe e mbështetjes jofinanciare.

23. Kombet e Bashkuara (2015) Transforming Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development. Gjetet në: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>

24. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (2020) Karta Olimpik, Lozanë. Gjetet në: <https://stillmed.olympic.org/media/Document%20Library/OlympicOrg/General/EN-Olympic-Charter.pdf>

25. UNESCO (2017) *Kazan Action Plan International Conference of Ministers and Senior Officials Responsible for Physical Education and Sport* (Plani i Veprimit i Konferencës së Gjashtë Ndërkombëtare të ministrave dhe zyrtarëve të lartë përgjegjës për edukimin fizik dhe sportin, Kazan, Federata Ruse, 2017). Gjetet në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000252725>

26. <https://www.unesco.org/en>

27. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (2022). *Gender Equality and Inclusion Objectives 2021-2024* (Objektivat e barazisë gjinore dhe të përfshirjes gjinore 2021/2024) Lozanë. Gjetet në: <https://stillmed.olympics.com/media/Documents/Beyond-the-Games/GenderEquality-in-Sport/IOC-Gender-Equality-and-Inclusion-Objectives-2021-2024.pdf>

Raportet periodike që i dorëzohen Komitetit të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në kuadër të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ofrojnë informacion mbi masat ligjore, administrative, dhe masa të tjera që merren për zbatimin e Paktit në nivel vendor, përfshirë në sektorin e sportit. Për shembull, në raportin e pestë periodik të dorëzuar nga Maqedonia e Veriut më 12 tetor 2023 në kuadër të neneve 16 dhe 17 të Paktit,²⁸ u raportua për zhvillimet në lidhje me ligjin e ri për sportet në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Agjencinë për Rininë dhe Sportet.

ANGAZHIMET E BE-SË DHE TË KËSHILLIT TË EVROPËS (KIE)

Barazia gjinore është një prej parimeve themelore të BE-së të përcaktuara në traktatet e BE-së dhe mishëruar në nenin 23 të **Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore**.²⁹ **Strategjia e Barazisë Gjinore e BE-së 2020-2025**³⁰ përcakton gjashtë objektiva kryesore, njëri prej të cilit thekson “adresimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në të gjithë botën.” BE-ja promovon të drejta të barabarta dhe trajton pabarazitë gjinore në shtetet anëtare, por këtë e bën edhe në shkallë më të gjerë përmes **Planit të Veprimit Gjinor III (PVGJ III)**.³¹ PVGJ III përcakton tre parime themelore për të luftuar faktorët që

shkaktojnë pabarazi gjinore: ai ndërmerr një qasje transformuese gjinore; trajton ndërthurjen e diskriminimit gjinor me format e tjera të diskriminimit, dhe zbaton një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Përmes PVGJ III, BE-ja synon të përshejtojë përparimin e fuqizimit të grave dhe vajzave dhe të mbrojë sukseset e arritura në fushën e barazisë gjinore në 25 vitet që nga miratimi i Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim të saj.

Objektivat strategjike kryesore të **Strategjisë së Barazisë Gjinore të Këshillit të Evropës 2018-2023**³² janë: parandalimi dhe luftimi i stereotipeve gjinore dhe seksizmit; parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi; arritja e një pjesëmarrjeje të balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike; mbrojtja e të drejtave të grave dhe vajzave migrante, refugjate dhe azilkërkuese; dhe përfshirja e integritimit gjinor në të gjitha politikat dhe masat. Në **Librin e Bardhë për Sportin të vitit 2007**,³³ BE-ja theksoi rëndësinë e trajtimit të çështjeve gjinore dhe zbatimin e aksesit të barabartë në sporte, pavarësisht nga gjinia, mosha, prejardhja shoqërore, etj. Në vitin 2011, me **Komunikatën për Zhvillimin e Dimensionit Evropian në Sport**,³⁴ Komisioni Evropian propozoi ndërmarrjen e veprimeve të rëndësishme me fokus në çështje si aksesit i grave në pozita vendimmarrëse dhe aksesit në sporte të grave migrante dhe të grave nga pakicat etnike. **Rezoluta për Dimensionin Evropian në**

28. *Fifth periodic report submitted by North Macedonia under articles 16 and 17 of the Covenant, due in 2021* (Raporti i pestë periodik i dorëzuar nga Maqedonia e Veriut sipas neneve 16 dhe 17 të Paktit, për t'u dorëzuar në vitin 2021): Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Gjetendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbol-no=E%2FC.12%2FMKD%2F5&Lang=en

29. Parlamenti Evropian (2012) *Charter of Fundamental Rights of the Bashkimi Evropian* (Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian). Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:12012P/TXT&from=cs>

30. Komisioni Evropian (2020) Komunikatë e Komisionit Drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, *A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025* (Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025), Bruksel. Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN>

31. Bashkimi Evropian (2020) *Joint Communication to the European Parliament and the Council: EU Gender Action Plan (GAP) III – an Ambitious Agenda for Gender Equality and Women’s Empowerment in EU External Action* (Komunikatë e përbashkët drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit: Plani i Veprimit Gjinor (PVGJ) III i BE-së – një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shërbimin e Jashtëm të BE-së). Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020JC0017>

32. Këshilli i Evropës (2018) *Council of Europe Gender Equality Strategy 2018-2023* (Strategjia e Barazisë Gjinore e Këshillit të Evropës 2018-2023, Strasburg. Gjetendet në: <https://rm.CoE.int/prems-093618-gbr-gender-equality-strategy-2023-web-a5/16808b47e1>.

33. Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *White Paper on Sport* (Libri i bardhë për sportin), Bruksel. Gjetendet në: <https://eurlex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52007DC0391&from=CS>.

34. Komisioni Evropian (2011) *Developing the European Dimension in Sport* (Zhvillimi i dimensionit evropian në sport), Bruksel. Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0012:FIN:en:PDF>

Sport,³⁵ e miratuar nga Parlamenti Evropian në vitin 2012, u bën thirrje shteteve anëtare “të përfshijnë integrimin gjinor në të gjitha veprimtaritë e tyre që lidhen me sportet, me fokus të veçantë tek aksesit në sporte të grave migrante dhe grave nga pakicat etnike, aksesit të grave në poste vendimmarrëse në fushën e sportit dhe pasqyrimin në media të grave dhe vajzave në sporte, dhe të sigurojnë që politikën dhe legjislacionin sportiv të bazohet në parimin e barazisë së seksive” (pika 23).

Në vitin 2014, BE-ja miratoi **Konkluzionet mbi Barazinë Gjimore në Sporte**,³⁶ ku u njoh fakti se gratë janë të nënpërfaqësuar në shumë fusha të sportit. Gjithashtu, ajo i ftoi shtetet anëtare që, ndër të tjera, “të përfshijnë perspektivën gjimore në të gjitha aspektet e sportit dhe të promovojnë eliminimin e stereotipeve gjimore në sporte në të gjitha nivelet” (40); “të kryejnë studime mbi barazinë gjimore në sporte në të gjitha nivelet dhe fushat e sportit, me fokus të veçantë mbi menaxhimin, trajnimin, administrimin dhe arbitrimin, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Evropian për Barazi Gjimore” (43); si dhe “të mbështesin zhvillimin dhe nxisin përdorimin e instrumente të përshtatura për përfshirjen e perspektivës gjimore, si buxhetimi gjinor dhe vlerësimet e ndikimit gjinor” (44).

Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje e Këshillit të Evropës (KIE) (Konventa e Stambollit),³⁷ është dokumenti më gjithëpërfshirës mbi dhunën me bazë gjimore (DHBGJ) dhe dhunën në familje (DHF). Kjo konventë, që u ratifikua në 2017, e trajton sportin në kuadër të fushës së arsimit (neni 14), dhe shpreh se “[palet ndërmarrin [...] hapat e nevojshme për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla

si barazia midis burrave dhe grave, rolet gjimore jo të stereotipizuara, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna me bazë gjimore kundër grave dhe e drejta për integritet personal [...] në programet zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore,” dhe “në mjedise informale arsimore, si dhe në mjedise sportive, kulturore, argëtuese dhe në media.”

Rekomandimi CM/Rec (2015) i KiE-së mbi Integrimin e Perspektivës Gjimore në Sport,³⁸ jep rekomandime për të gjitha aspektet e barazisë gjimore në sport, më konkretisht, që të “promovohen dhe nxiten politika dhe praktika që synojnë përfshirjen, zbatimin dhe sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet e sportit dhe të krijohen mekanizma të posaçëm për këtë qëllim,” sa i përket legjislacionit, politikave në nivel vendor, politikave dhe programeve për luftimin e dhunës gjimore, ndërgjegjësimin, trajnimin, mediave, mbledhjes së të dhënave dhe studimeve, monitorimit dhe vlerësimit, gjuhës, financimit, etj.

Rekomandimi CM/Rec (2019) i KiE-së mbi Parandalimin dhe Luftimin e Seksizmit³⁹ kërkon që palët “të nxisin tolerancën zero ndaj seksizmit dhe gjuhës së urrejtjes seksiste në veprimtari kulturore dhe sportive,” dhe identifikon fushat që duhet të adresohen: “qëndrimet seksiste të mediave, organizatave sportive, trajnerëve, menaxherëve sportivë, sportistëve, etj.; portretizimet seksiste të grave në sport, nënvlerësimi i arritjeve sportive të grave, duke i portretizuar ato në role stereotipike dhe duke shpërfillur sportet që praktikohen prej tyre; dhe seksizmit dhe gjuha e urrejtjes seksiste në veprimtari sportive.” Ndër masat për të adresuar çështjet e seksizmit në sport janë hartimi dhe promovimi i

35. Shih: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2012-0025_EN.html

36. Katsarova, I. (2019) *Gender Equality in Sport: Getting Closer Every Day* (Barazia gjimore në sport: më afër çdo ditë), Shërbimi i Kërki-meve Shkencore i Parlamentit Evropian. Gjendet në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/EPRS_BRI\(2019\)635560_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/EPRS_BRI(2019)635560_EN.pdf)

37. Gjendet në: <https://rm.CoE.int/168008482e>

38. Këshilli i Evropës (2015). *Recommendation CM/Rec(2015)2 of the Committee of Ministers to member States on gender mainstreaming in sport* (Rekomandimi CM/Rec(2015)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me integrimin gjinor në sport), Pub. L. No. CM/Rec(2015)2 (2015). Gjendet në: <https://www.icsspe.org/system/files/Council%20of%20Europe%20%20Recommendation%20Gender%20Mainstreaming%20CM%20Rec%20%282015%292.pdf>.

39. Këshilli i Evropës (2019). *Recommendation CM/Rec(2019)1 on Preventing and combating sexism* (Rekomandimi CM/Rec(2019) mbi parandalimin dhe luftimin e seksizmit). Gjendet në: <https://rm.CoE.int/cm-rec-2019-1-on-preventing-and-combating-sexism/168094d894>.

mjeteve si materialet e trajnimit ose ato që lidhen me gjuhën dhe komunikimin e ndjeshëm gjinor, inkurajimi i personaliteteve të njohura sportive që të korrigjojnë supozimet seksiste dhe të dënojnë gjuhën e urrejtjes seksiste, nxitja e federatave dhe shoqatave sportive që të përgatisin kode etike për parandalimin e seksizmit dhe të sjelljeve seksiste, ku të përfshihen edhe masa disiplinore, si dhe nxitja e organizatave sportive që të promovojnë barazinë gjinore dhe portretizimin jo të stereotipizuar të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Rekomandimi CM/Rec (2021) i Këshillit të Evropës mbi Kartën Evropiane të Sporteve, e Rishikuar⁴⁰ thekson nevojën dhe rëndësinë e barazisë gjinore në sporte dhe shërben si një instrument reference i rëndësishëm për hartimin e politikave kombëtare të sporteve (angazhimi i KiE-së për të kontribuar në arritjen e barazisë gjinore në sporte e ka zanafillën që në Kartën Evropiane të Sporteve të vitit 1975). Karta e vë theksin veçanërisht në konceptin e “sportit për të gjithë” dhe nevojën për të mundur pjesëmarrjen në sporte, për të përfutur nga të mirat që sjell kjo pjesëmarrje për shëndetin, përfshirjen dhe edukimin, e të gjithë popullatës. Karta gjithashtu njihë rolin e autoriteteve publike në sporte, theksin rolin kyç të shoqatave sportive, si dhe konfirmon nevojën për bashkëpunim me aktorë të tjerë, si organet e qeverisjes vendore, sektorin privat, dhe organizatat profesionale. Në mars të vitit 2022, Komisioni Evropian botoi një dokument me titull **“Drejt një barazie më të madhe gjinore në sport”**,⁴¹ me rekomandime dhe një plan veprimi të hartuar nga grupi i punës i nivelit të lartë për barazinë gjinore në sporte. Raporti përmban reflektime, të dhëna, rekomandime dhe praktika të mira për forcimin e barazisë gjinore në sporte. Ai kombinon veprime për promovimin e barazisë gjinore dhe kërkon përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe nismat e BE-së. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi dhe fokusi i këtij dokumenti

mbështetet në PVGJ III të BE-së dhe në të njihen temat gjithëpërfshirëse si: integrimi i perspektivës gjinore, buxheti/financimi gjinor, monitorimi i politikave, vlerësimi dhe puna kërkimore, arsimit, komunikimi, koordinatorët e barazisë gjinore, dhe angazhimi i burrave si aleatë. Ai thekson gjithashtu gjashtë fushat kyçe tematike të angazhimit, që janë të rëndësishme për autoritetet publike dhe federatat sportive.

GJASHTË FUSHAT KYÇE TEMATIKE



Pjesëmarrja



Roli udhëheqës/drejtuës



Pasqyrimi në media



Trajnimi dhe arbitrimi



Aspektet sociale dhe ekonomike



Dhuna me bazë gjinore

Platforma e Integritit Gjinor e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ) trajton pesë fusha kryesore që lidhen me pabarazitë gjinore në fushën e sporteve dhe pjesëmarrjes së grave në veprimtari sportive; përfaqësimi i barabartë dhe vëmendje ndaj çështjeve gjinore në vendimmarrje; barazia gjinore në rolet trajnuese në sporte; dhuna me bazë gjinore në sport dhe përmes sportit; dhe stereotipet gjinore në sport dhe roli i mediave.

40. Komisioni Evropian (2021). *Recommendation CM/Rec(2021) of the Committee of Ministers to Member States on the Revised European Sports Charter* (Rekomandimi CM/Rec(2021) i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi Kartën Evropiane të Sportit, e rishikuar), Bruksel. Gjetet në: <https://rm.coe.int/recommendation-cm-rec-2021-5-on-the-revision-of-the-european-sport-cha/1680a43914>

41. Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin, Rininë, Sportin dhe Kulturën (2022) *Towards more gender equality in sport: Recommendations and Action Plan From the High Level Group on gender equality in sport* (Drejt një barazie më të madhe gjinore në sport: rekomandime dhe plan veprimi nga grupi i nivelit të lartë mbi barazinë gjinore në sport) Bruksel. Gjetet në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/publication/684ab3af-9f57-11ec-83e1-01aa75ed71a1>

Strategjia e Barazisë Gjinore 2018-2023 e KiE-së⁴² thekson se KiE do të përpiqet të arrijë integrimin gjinor në të gjitha politikat dhe masat (Objektivi strategjik 8), ku sporti mund të përdoret si mjet për vendosjen e lidhjeve mes të rinjve dhe të rejave dhe për promovimin e vlerave të barazisë.

Agjenda e Ballkanit Perëndimor mbi Novacionin, Kërkimin Shkencor, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportet⁴³ është një strategji afatgjatë e BE-së dhe

për bashkëpunim rajonal. Ajo kontribuon në zhvillimin e ekonomive dhe shoqërive të rajonit dhe organizohet mbi bazën e tri shtyllave kryesore: politike, tematike, dhe rajonale. Ajo bazohet në mbështetjen e përgjithshme të BE-së për rinovimin e shpejtë të ekonomisë së rajonit dhe procesin vijues të anëtarësimit në BE. Ajo ofron një vizion pozitiv dhe me orientim nga e ardhmja për të gjithë, veçanërisht për të rinjtë dhe të rejat.

KUADRI LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE I POLITIKAVE TË VENDIT

KUADRI LIGJOR

Duke qenë se sporti është një nga të drejtat më të rëndësishme për afirmimin e individëve si qenie njerëzore, ai gëzon mbrojtje të veçantë nga sistemi ligjor, që përkufizohet në **Kushtetutë**, sipas së cilës "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private, synon zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse" (neni 78 and 83).

Ligji për Sportin u miratua së pari në vitin 2005 (Ligji 1976, datë 21 prill 2005, ndryshuar me Ligjin Nr. 9816, datë 21.10.2007, dhe Ligjin nr. 9963, datë 21.07.2008).⁴⁴ Ligji përkufizon parimin e barazisë: "parimi i barazisë, si një e drejtë e çdo shtetasi për t'u marrë me sport" (neni 4a). Në nenin 5 të këtij Ligji thuhet "Ndalohej diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore."

Në këtë Ligj për Sportet ka një nen të veçantë që i kushtohet dhunës në veprimtari sportive, që thekson, ndër të tjera, ndalimin e dhunës me bazë gjinore: "Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose

gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjediset ku ato zhvillohen, ndalohej provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racor, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve" (neni 47). Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, një strukturë me karakter këshillimor në kuadër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (sot në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve) ishte organi që rekomandoi që Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të merrte masa kundër personave që përdorin ose nxisin përdorimin e dhunës. Kjo u bazua në dispozitat e Konventës Evropiane Kundër Dhunës në Sport, në të cilën Shqipëria ka aderuar (neni 50).

Ligji për Sportin i vitit 2005 u konsiderua i pamjaftueshëm për rregullimin specifik të çështjeve që burojnë nga sporti dhe, rrjedhimisht, në vitin 2017 u miratua një ligj i ri për sportin – **Ligji nr. 79/2017 Për Sportin** – për të pasqyruar reformat e kryera në vend në këtë fushë si edhe zhvillimet e reja sociale, politike dhe në fushën e sportit. Ky Ligj ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij kanë

42. Strategjia e Barazisë Gjinore e Këshillit të Evropës 2018-2023. Gjetet në: <https://rm.CoE.int/prems-093618-gbr-gender-equality-strategy-2023-web-a5/16808b47e1>

43. Agjenda e Novacionit është një element i rëndësishëm në realizimin e komponentit të novacionit të Planit Ekonomik dhe të Investimeve. Ministrat e Ballkanit Perëndimor të Novacionit, Kërkimeve Shkencore, Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratuar përmbajtjen e saj në një mbledhje ministrore në dhjetor të vitit 2020. Këshilli i Bashkimit Evropian dha mbështetjen e tij për të në maj të vitit 2021. Gjetet në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/22b8829db786-11eb-8aca-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-233221374>

44. Ligji për Sportin – Ligji nr. 1976, datë 21 prill 2005. Gjetet në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhjet-L51.pdf>

përmirësime të konsiderueshme krahasuar me ligjin e mëparshëm, dhe ofrojnë shumë më tepër mbrojtje për sportistët dhe sportistet. Kjo nismë shënon një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të së drejtës për ushtrimin e sportit në vend dhe u mundëson të gjithë sportistëve dhe sportisteve profesionistë që të mbrojnë të drejtat e tyre të shkelura nga klube të ndryshme ose edhe nga vetë federatat dhe Komiteti Olimpik. Paragrafi 3 i nenit 5 të këtij ligji thotë: “Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore.”

Ligji i ri përcakton dhe garanton autonomi të plotë të federatave të sporteve shqiptare, duke eliminuar ndërhyrjet e organeve shtetërore në veprimtaritë e tyre. Ky Ligj parashikon ushtrimin dhe forcimin e veprimtarive nga organe si Këshilli i Lartë i Sportit dhe Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit si organe që garantojnë vendimmarrjen. Gjithashtu, ai përcakton në hollësi të gjitha kompetencat e organizatave sportive në Shqipëri, si: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat sportive, shoqatat sportive, kompanitë sportive dhe klubet sportive. Ky Ligj ka forcuar më tej autonominë dhe kapacitetet vetadministruese të organizatave sportive në nivel kombëtar dhe vendor, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e politikave të brendshme të tyre, rregullimin e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit, si dhe respektimin e kriterëve të përcaktuara për sportet. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij ligji lidhet me ndalimin kategorik të dhunës kundër përfaqësuesve të federatave, gjyqtarëve dhe vëzhguesve (neni 49). Komisioni Kombëtar kundër Dhunës, si organ këshillimor, merr kompetenca të reja në fillimin dhe hartimin e politikave për parandalimin e dhunës.

Në lidhje me aspektet financiare, Ligji parashikon se gjysma e të ardhurave të shtetit nga lojërat e fatit shkon për sportin. Neni 38 i Ligjit të ri Për Sportet dikton se alokimi i fondeve bëhet bashkërisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave, duke sjellë kështu për herë të parë një

ndryshim rrënjësor në sistemin e financimit të sportit në vend. Një përmirësim tjetër i Ligjit për Sportin paraqitet në nenin 31 “Objektet sportive” që synon parandalimin e ndryshimit të vendndodhjes së objekteve sportive dhe këndeve të lojërave përmes privatizimit ose dhënies së koncesioneve palëve të tjera. Kur ndërtohen objekte të reja, ato duhet të përmbushin standardet dhe kriteret ndërkombëtare.

Sipas Ligjit, sigurimi shëndetësor i sportistëve që marrin pjesë në veprimtari sportive është i detyruar. Për më tepër, ky është detyrim i klubeve sportive për sportistët dhe sportistet e tyre, si dhe i federatave sportive për sportistët/tet e ekipeve kombëtare. Po kështu, edhe organizatat sportive duhet të mbulojnë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistëve/eve të lënduar/a gjatë veprimtarive sportive, në rast se nuk ishin të siguruar/a më parë.

Ndonëse Ligji aktual shërben si një bazë e mirë për barazinë gjinore, ka vend për përmirësime të mëtejshme për të rritur efektivitetin e tij, si për shembull njohja e nevojave, përparësive, roleve, përgjegjësive dhe aftësive të ndryshme të grave dhe burrave dhe promovimi aktiv i mundësive të barabarta për të gjitha gjinitë në sporte. Përveç kësaj është shumë e rëndësishme edhe përfshirja e dispozitave që trajtojnë dhunën me bazë gjinore dhe gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore. Gjuha e urrejtjes me bazë gjinore është e përhapur në nivele alarmante në veprimtaritë sportive dhe bart rreziqe të konsiderueshme, dhe mund të nxisë dhunë të vërtetë kundër grave dhe vajzave pjesëmarrëse në veprimtari sportive, punonjëseve dhe anëtareve të mediave, madje edhe anëtareve të forcave të rendit dhe ligjit.

Ligji nr. 9970, datë 24 korrik 2009, Për Barazinë Gjinore në Shoqëri⁴⁵ shërbeu për krijimin e një kuadri të fuqishëm normativ për barazinë midis grave dhe burrave. Ligjit për Barazinë Gjinore duhet t’i njihet merita e arritjeve themelore, si vendosja e kuotave gjinore në poste të zgjedhura dhe të emëruara vendimmarrëse; krijimi i një mekanizmi të barazisë

45. Ligji nr. 9870/2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/e/36682.pdf>

gjimore në nivel qendror dhe vendor; krijimi i një mjedisi ligjor dhe të politikave për buxhetim reagues gjinor; dhe përmirësimi i mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, në këtë Ligj nuk ka asnjë dispozitë ku të pasqyrohet konkretisht rëndësia e barazisë gjimore në sporte. Ndër dispozitat e tjera në Ligjin për Barazinë Gjimore për të cilat duhet reflektuar më tej janë ato për zhvendosjen e barrës së provës nga pala kërkuese tek pala kundër së cilës bëhet ankim, në ankimet që i paraqiten Komisionerit ose gjykatave. Komisioneri është ngarkuar gjithashtu me monitorimin e zbatimit të Ligjit, por mungojnë hollësitë se si, dhe me çfarë burimesh, do ta bëjë këtë.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD):⁴⁶ Ndryshimet e vitit 2020 sollën një numër dispozitash të reja në kuadër të përafritit të Ligjit me direktivat e BE-së mbi antidiskriminimin, si edhe zgjerimin e përkufizimit të diskriminimit për arsye gjimore për të përfshirë edhe elementë si identiteti gjinor, orientimi seksual dhe karakteristikat seksuale.

Ligji Organik i Buxhetit:⁴⁷ Bazuar në ndryshimet e vitit 2016 të Ligjit Organik të Buxhetit, barazia gjimore është një nga parimet themelore të sistemit buxhetor dhe udhëzimet standarde për buxhetit që jepen çdo vit përmbajnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (BPGJ) si pjesë të kriterëve të buxhetit të shtetit. Që nga viti 2019, Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF) ka shërbyer si një instrument për kontrollimin e reagueshmërisë gjimore në alokimin e burimeve dhe, që nga viti 2022, projektbuxhetit i bashkëlidhet zyrtarisht një Deklaratë e Buxhetit Gjinor. Kjo mundëson përfshirjen efektive të BPGJ-së në të gjitha fazat e cikleve të menaxhimit në nivel qendror: në programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme, në monitorimin dhe raportimin, si dhe në vlerësimin dhe auditimin e tyre. Megjithatë, është e nevojshme që lidhja thelbësore mes Ligjit për Barazinë Gjimore dhe buxhetimit të përgjigjshëm

gjinor të zbatohet edhe përmes akteve nënligjore për të siguruar përfshirjen cilësore të BPGJ-së në sistemin e financave publike.

Ligji për Financimin e Organeve të Vetëqeverisjes Vendore:⁴⁸ Në vitin 2017, BPGJ-ja u përfshi si kërkesë në ciklin e Menaxhimit Financiar të Vetëqeverisjes Vendore. Legjislacioni në lidhje me BPGJ-në kërkon zbatimin e perspektivave gjimore në të gjitha fazat e financimit vendor.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të adresojnë dhe të tregojnë qartësisht rezultatet e barazisë gjimore, si dhe përqindjen e shpenzimeve të tyre të përgjithshme që shkon në mbështetje të politikave për promovimin e barazisë gjimore. Megjithëse Ligji për Barazinë gjimore e ka lehtësuar përparimin në këtë fushë, informacioni se si zbatohen dhe monitorohen në praktikë këto detyrime është i kufizuar, që sugjeron se duhen hartuar akte nënligjore në këtë fushë.

Ligji nr. 75/2019 Për Rininë: Ky Ligj, veçanërisht paragrafi 1 i nenit 3, përcakton që: “Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme: a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet, etj.; b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve.” Çështja e barazisë gjimore dhe sportit nuk përmendet në asnjë nen të Ligjit, përveçse në nivelin e parimeve, në seksionin e parimeve për mbështetjen e veprimtarive të të rinjve dhe të rejave (neni 4, paragrafi 1).

46. Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar. Gjetet në <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pdf>

47. Ligji nr. 57, datë 2 qershor 2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936/2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)’. Gjetet në: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/LOB_i_ri_nr_57_dt_02.06.2016_-_MIRATUAR_ne_KUVEND_ENGLISH.rtf

48. Gjetet në: <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-68-date-27.4.2017.pdf>

KUADRI I POLITIKAVE

Programi Kombëtar Qeverisës 2021-2025⁴⁹ thekson rëndësinë e edukimit sportiv, sidomos për fëmijët. Qeveria synon të shtojë progresivisht numrin e orëve të mësimi me orientim sportiv në të gjithë vendin, nga 223 në 423, duke filluar nga viti shkollor 2021-2022, duke shtuar disiplina të reja, si gjimnastika, atletika dhe tenisi.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030⁵⁰ është dokumenti kryesor strategjik që kombinon agjendën për integrim në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit, përfshirë edhe në lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Në vijim janë aspektet themelore që nevojiten për zbatimin e planit:

- ⊙ Harmonizimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 me arritjet e OZHQ-ve, pjesë e Agjendës 2030, për të cilën Shqipëria është tërësisht e përkushtuar deri në fund të procesit në vitin 2030;
- ⊙ Përbushja e angazhimeve të procesit të integritit evropian në përputhje me agjendën e tij, dhe dobia e krijimit të një kornize strategjike afatgjatë që ndihmon procesin e integritit të Shqipërisë në BE, me një kuadër strategjik të qëndrueshëm dhe të qartë.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) dhe Plani i Veprimit 2021-2030 është një dokument i rëndësishëm kombëtar i politikave, që synon të forcojë më tej angazhimet e qeverisë për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave shqiptare, në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, përmes integritit efektiv të perspektivës gjinore në politika,

ligje dhe programe. SKBGJ 2021-2030 pasqyron qartë dedikimin e qeverisë shqiptare për arritjen e barazisë gjinore si edhe për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si parakushte për zhvillim të qëndrueshëm. Ndonëse ky dokument pasqyron lidhjen e drejtpërdrejtë me përbushjen e OZHQ-ve dhe të Agjendës 2030, të Strategjisë së Barazisë Gjinore 2020-2025 të Bashkimit Evropian, të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës Ndaj Grave, Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të Këshillit të Evropës, etj., ajo nuk përmban një synim dhe/ose objektiv specifik për çështjen e barazisë gjinore në sporte.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2022-2029⁵¹ është një dokument themelor për koordinimin dhe zbatimin e politikave ndërsektoriale për rininë. Dy nga objektivat specifike nën Qëllimin e Politikës 3⁵² lidhen me rininë dhe shëndetin e mirë, si dhe me përfshirjen dhe integrimin e rinisë në shoqëri, përkatësisht:

- ⊙ **Objektivi strategjik 3.2** synon t'u ofrojë të rinjve dhe të rejave shërbime shëndetësore që marrin parasysh nevojat e tyre dhe promovon një stil jetese të shëndetshëm, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien mendore, shoqërore, fizike dhe seksuale të të rinjve dhe të rejave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (MSHMS) organizon veprimtari që lidhen me shëndetin e popullsisë në rang kombëtar dhe strategjitë e përfshirjes. Një nga masat (masa 2.2.3) e përvijuara nën këtë objektiv strategjik lidhet me mbështetjen dhe zhvillimin e sporteve amatore (ndër fusha të tjera, si programet e arteve dhe ato artizanale) dhe veprimtari të tjera jashtëshkollore që kanë për qëllim të zhvillojnë aftësitë për një jetë të shëndetshme,

49. Programi Kombëtar Qeverisës 2021 – 2025, f. 31. Gjetet në: https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

50. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, datë 22 shkurt 2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030".

51. Gjetet në: https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29_Anglisht.pdf

52. Qëllimi i politikës nr. 3.: Mirëqenia aktive, e shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve dhe të rejave. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve dhe të rejave në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për të rinjtë dhe të rejtat që janë në situatë rreziku apo përjashtimi social".

me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë e reja. Angazhimi i të rinjve dhe të rejave në sporte dhe arte konsiderohet i rëndësishëm për përmirësimin e shëndetit të tyre fizik dhe mendor dhe për të vendosur lidhje më të afërta me njëri-tjetrin, me mjedisin dhe komunitetin. Kjo masë siguron zhvillimin e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe evropian përmes lidhjes së programeve të sportit dhe të artit që mbështeten nga Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

- **Objektivi specifik 3.3** synon të sigurojë që asnjë i ri ose e re të mos përjashtohet, dhe që çdonjë prej tyre të ketë mundësi të angazhohet aktivisht në shoqëri, përmes organizimit të aktiviteteve vullnetare dhe hartimit të masave për më shumë aktivitete të kohës së lirë për të rinjtë dhe të rejat (në kulturë, art dhe sport).

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023⁵³ synon njëherazi që të koordinojë procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe të përmbushë detyrimet në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si edhe detyrimet që burojnë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Kapitulli 26, mbi çështje të arsimit dhe kulturës, përfshin disa prioritetë për sportin, përfshirë financime me grante për pjesëmarrjen e drejtë dhe të plotë të Shqipërisë në programin e BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportet, të propozuar nga Komisioni Evropian, që synon të promovojë modernizimin e sistemeve arsimore, si dhe shtimin e lëndëve sportive dhe lëndëve sportive të profilizuara. Ministria e Arsimit dhe Sportit e ka përfshirë barazinë gjinore në planin e saj afatgjatë dhe aktualisht planifikon të hartojë një plan veprimi kushtuar barazisë gjinore në sport. Një strategji e posaçme për sportin do ta përkufizonte më mirë sportin si aktivitet me interes të veçantë social, i lidhur me nevojat e qytetarëve, sidomos me ato të të rejave dhe të rinjve.

Strategjia e Federatës së Futbollit 2022-2025. *Futbolli për Kombin 2025*⁵⁴ – Strategjia e Federatës Shqiptare të Futbollit 2022-2025 përbën një udhërrëfyes në ndihmë të sportistëve, trajnerëve, spektatorëve dhe vullnetarëve për kthimin e Shqipërisë në një komb të madh të futbollit, ku futbollit i grave është një prej nëntë fushave të veçanta në fokus. Ndër objektivat kryesore të këtij dokumenti strategjik është krijimi dhe zhvillimi i mundësive për t'u angazhuar në futboll pavarësisht nga moshja, gjinia, apo gjendja social-ekonomike. Posaçërisht për sa i përket futbollit të femrave, Federata e Futbollit synon të zhvillojë futbollin e femrave dhe të krijojë mjedise të aksesueshme për to – *“Duke siguruar që loja jonë e futbollit të jetë e hapur, e aksesueshme dhe të shijohet nga të gjitha gratë dhe vajzat që duan të merren me futboll në të gjithë vendin”* (një objektivi i përgjithshëm i seksionit të futbollit femëror). Në tabelë në vijim tregohet më konkretisht fokusi mbi gratë në Strategjinë e Federatës së Futbollit 2022-2025.



53. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9 shkurt 2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrim Evropian 2022-2024.”

54. Gjetet në: <https://fshf.org/wp-content/uploads/2022/05/FSHF-Football-for-the-nation-2025-1.pdf>, f.51-52

TABELA 1. GRATË NË STRATEGJINË E FEDERATËS SË FUTBOLLIT 2022-2025: QËLLIMET DHE NDIKIMET STRATEGJIKE

QËLLIMET STRATEGJIKE	NDIKIMI STRATEGJIK
<p>Hartimi dhe vënia në zbatim e një strategjie të re kombëtare për futbollin e femrave për të siguruar burime të posaçme dhe fokusin e duhur për këtë pjesë të futbollit</p>	<p>Vënia në zbatim e një strategjie të re kombëtare për futbollin e femrave deri në pranverë 2023</p>
<p>Të sigurojmë që të gjitha gratë dhe vajzat shqiptare të kenë mundësinë të përjetojnë dhe shijojnë futbollin në mjedise cilësore dhe frymëzuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Shndërrimi i futbollit në sportin numër 1 për femra në Shqipëri ○ Dyfishimi i numrit të femrave që luajnë futboll dhe regjistrimi i së paku 4000 futbollisteve femra deri në vitin 2025 ○ Krijimi i 100 ekipeve të futbollit për femra U-15 – U-17 deri në vitin 2025 dhe vendosja e lidhjeve strukturore me klubet lokale ○ Krijimi i 60 ekipeve rajonale amatore për vajza të moshës U-13 deri në vitin 2025
<p>Të ofrojmë arsimim me cilësi të lartë dhe mbështetje për të krijuar një rrjet gjithëpërfshirës, të mirëtrajnuar dhe të besueshëm trajneresh, gjyqtarësh dhe administratorësh femra në botën e futbollit shqiptar për femra</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Çdo ekip femrash në Shqipëri të ketë të paktën një trajnere femër deri në vitin 2025 ○ Të ofrojmë kurse të trajnimit dhe formimit zyrtar edhe brenda institucioneve arsimore, si për shembull në universitete, shkolla të mesme, etj. ○ Deri në vitin 2023 të sigurojmë që i gjithë arsimimi i trajnereve të femrave të jetë falas për kandidatet dhe të përmirësojmë aksesin në këto mundësi kualifikimi përmes ofrimit të kurseve verore ○ Të paktën 1 trajnere femër të jetë e përfshirë në mënyrë aktive në mbështetjen e çdo grupmoshe dhe ekipit kombëtar të femrave deri në vitin 2025 ○ Të zgjidhet të paktën 1 femër në Komitetin Ekzekutiv të FSHF-së deri në vitin 2025
<p>Rritja e ndërgjegjësimit për futbollin e femrave në të gjithë Shqipërinë, duke thyer barrierat për pjesëmarrjen dhe duke siguruar që futbollin e femrave të jetë i aksesueshëm dhe frymëzues</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Të thejmë barrierat kulturore përmes realizimit të dy fushatave marketingu në vit për futbollin për femra në të gjitha kanalet e komunikimit ○ Të krijojmë dhe të lançojmë imazhe frymëzuese për ekipet kombëtare të femrave deri në vitin 2023, si edhe kampionatet e femrave dhe ndeshjeve të kupave deri në vitin 2024 ○ Të sigurojmë deri në vitin 2022 që çdo javë të transmetohet drejtpërdrejt të paktën një ndeshje e kampionatit elitë të femrave ○ Të arrijmë një marrëveshjeje transmetimi në nivel kombëtar për të gjitha kombëtalet e femrave dhe Kupën e Shqipërisë deri në vitin 2023
<p>Të bëjmë të mundur që të gjitha gratë dhe vajzat e talentuara shqiptare të kenë mundësinë dhe mbështetjen për të shpalosur plotësisht potencialin e tyre në futboll</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Nëpërmjet kushteve të përmirësuara të licencimit, të nisë zbatimin e një programi stimulues për klubet e femrave, duke siguruar financimin e FSHF-së për zhvillimin e infrastrukturës së klubeve dhe për përmirësimin e zhvillimit të talenteve deri në vitin 2022 ○ Implementimi i plotë i një programi kombëtar për zbulimin e talenteve femra, i ngjashëm me programin aktual të meshkujve deri në vitin 2023 ○ Krijimi i një ekipi kombëtar për femra U-15 deri në vitin 2023 ○ Synimi i vendosur është që një ekip femrash të kualifikohet për në Ligën e Kampioneve të UEFA-s për femra deri në vitin 2025

Përveç këtij dokumenti, Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) ka hartuar edhe strategjinë e parë për futbollin e femrave 2023-2027 – *Rising stars!*, që është simbol i angazhimit të vazhdueshëm të Federatës së Futbollit për këtë pjesë të futbollit. Me fokus në përparimin e futbollit të femrave si në skenën kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare, FSHF-ja e prezantoi këtë strategji më 27 nëntor 2023. Kjo nismë ka gjetur mbështetje të konsiderueshme nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që u tregua edhe nga prania dhe mbështetja e ministres, znj. Ogerta Manastirliu, gjatë aktivitetit për prezantimin e strategjisë. Nisma e re *Rising stars*, synon të krijojë një ekosistem shumë aktiv për futbollin e femrave në Shqipëri, jo vetëm përmes formimit të sportistëve të klasit botëror, por edhe duke u ofruar atyre mundësi për role udhëheqëse dhe angazhim në të gjitha nivelet. Strategjia mbështetet në katër fusha kryesore:

- ⊙ Pjesëmarrja: dyfishimi i numrit të lojtarëve të regjistruara femra deri në vitin 2026.
- ⊙ Zbulimi dhe zhvillimi i talenteve dhe ekipet kombëtare: përfshirja e një programi për zbulimin e grave dhe vajzave të talentuara deri në vitin 2025.
- ⊙ Arsimimi dhe licencimi: krijimi i një ekipi femrash në të dhjetë klubet që marrin pjesë në Kampionatin Elitar në nivelet superiore, Under-17, dhe Under-15 deri më 2026.
- ⊙ Marketingu, dukshmëria dhe perceptimi: ngritja e vlerës komerciale të futbollit elitare të femrave.

Strategjia e futbollit të femrave ka për qëllim që:

- ⊙ Futbollin e femrave të rritet në të drejtën e vet, duke shmangur pritshmëritë dhe krahasimet me futbollin e burrave.
- ⊙ Të krijohet dhe zhvillohet një marrëdhënie e fortë me të gjithë pjesëmarrësit dhe klubet e Federatës së Futbollit që janë angazhuar në futbollin e femrave.
- ⊙ Të fitohet mbështetja e një game të gjerë palësh të interesit për sigurimin e aksesit në infrastrukturë të cilësisë së lartë për futbollin e femrave.

- ⊙ Të sigurohet angazhim me futbollin elitare për femra, sa i përket klubeve të kategorisë profesionale dhe nivelit të mundësive që ofrojnë.
- ⊙ Të edukohen punonjësit e angazhuar në futbollin e femrave që të ofrojnë mjedise loje dhe stërvitjeje të cilësisë sa më të lartë.
- ⊙ Të gjenerohen të ardhura të tjera përmes partneriteteve dhe marrëdhënieve për sigurimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për futbollin e femrave, në mënyrë që gratë dhe vajzat të ndiejnë kënaqësi kur luajnë futboll dhe të realizojnë potencialin e tyre.

KUADRI INSTITUCIONAL

Kuadri institucional përfshin sa vijon:

Ministria e Arsimit dhe Sportit është ministria përgjegjëse për sportin që harton dhe zbaton politikën e vendit në fushën e sporteve, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor për sportet, administron fondet buxhetore për sportet, dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive. Ajo administron objektet sportive publike nën juridiksionin e vet dhe financon ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive.

Këshilli i Lartë i Sportit është organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin. Ministri përgjegjës për sportin është kryetar i Këshillit të Lartë të Sportit dhe emëron anëtarët e tij.

Organizatrat sportive në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) **Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar** – person juridik që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë. Programet kryesore që zbatohen nga ky entitet përfshijnë programin e edukimit olimpik, programin rinor të lëvizjes olimpikë; programin e zhvillimit rajonal të lëvizjes olimpikë, dhe programin e përgatitjes dhe

pjesëmarrjes së sportistëve më të mirë të vendit në Lojërat Olimpike (nenet 14 dhe 15). Këshilli i Lartë i Sportit, që kryesohet nga Ministri përgjegjës për sportin, ka 12 anëtarë (2 gra dhe 10 burra) dhe një sekretar, ku përfshihen:

1. Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
2. Përfaqësues të Federatës Shqiptare të Futbollit
3. Përfaqësues të Federatës Shqiptare të Basketbollit
4. Përfaqësues të Federatës Shqiptare të Volejbollit
5. Një përfaqësues të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit
6. Dy përfaqësues nga biznese private që financojnë ndeshje ose veprimtari sportive
7. Tre përfaqësues të nivelit të lartë nga disiplinat sportive anëtare
8. Një jurist
9. Një gazetar sportiv
10. Një specialist nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

b) **Federatat Sportive** – janë person juridik të krijuara në formën e një shoqate, anëtare të të cilave janë shoqatat, shoqëritë dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar dhe që kanë për qëllim të organizojnë, zhvillojnë, promovojnë dhe kontrollojnë rregullimin dhe përhapjen e një sporti të caktuar në të gjithë territorin e Shqipërisë. Detyrat kryesore të federatave përfshijnë:

- ⊙ Të organizojnë, drejtojnë, kontrollojnë dhe vëzhgojnë veprimtaritë sportive zyrtare në nivel kombëtar në bazë të rregulloreve të miratuara;
- ⊙ Të organizojnë kampionate kombëtare dhe të shpallin 'kampionin kombëtar' dhe 'ekipin kampion kombëtar' në sportin përkatës;
- ⊙ Të organizojnë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallin 'fituesin e Kupës së Shqipërisë' në sportin përkatës;
- ⊙ Të marrin masa për parandalimin dhe luftimin e dhunës, si dhe të promovojnë 'sportin e pastër' dhe tolerancën, d.m.th. integritetin dhe lojën e ndershme në sporte, sidomos në lidhje me parandalimin e dopingut, mashtrimin dhe korrupsionit. Termi adreson çështje etike që lidhen me përmirësimin e performancës sportive dhe lojën e ndershme.
- ⊙ të organizojnë ekipin kombëtar dhe të marrin pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të tyre në këto veprimtari;
- ⊙ të organizojnë veprimtari zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë me miratimin e ministrisë përgjegjëse për sportin dhe rininë.
- ⊙ të licencojnë trajnerët për sportin përkatës;
- ⊙ t'u japin pëlqimin anëtarëve të tyre për të marrë pjesë në veprimtari sportive.

c) **Shoqatat sportive** – Qëllimi i shoqatave sportive është që të marrin pjesë në veprimtari sportive ose në zhvillimin e tyre, në përputhje me Ligjin për Sportin dhe legjisllacionin shqiptar në fuqi. Gjithashtu, ato funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse (OJQ). Shoqatat sportive kombëtare nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të



marrin pjesë në to pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit përkatës. Ato mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

- d) **Klubet sportive** – Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët, shoqëritë tregtare dhe OJQ-të. Çdo organizatë që ka personalitet juridik ka të drejtë të krijojë një klube sportive për një ose më shumë sporte. Klubet sportive mund të përfitojnë financime nga organet e qeverisjes qendror ose vendor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, përmes transfertave dhe nga burime të tjera.

Agjencia e Shërbimeve të Sportit⁵⁵ – Agjencia e Shërbimeve Sportive është person juridik buxhetor publik nën Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Ajo u krijua në zbatim të Vendimit nr. 149, datë 24 shkurt 2016, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimeve të Sportit (ASHS),” dhe të Urdhrit nr. 59, datë 5 prill 2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve të Sportit”. Agjencia e Shërbimeve të Sportit ofron shërbime për federatat shqiptare të sportit, shoqatat dhe klubet sportive që kërkojnë mbështetjen e saj, në përputhje me kapacitetet infrastrukturore dhe financiare. Realizimi i këtyre shërbimeve bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi dhe në bazë të marrëveshjeve paraprake ndërmjet palëve.

Universiteti i Sporteve, Tiranë – Universiteti i Sporteve në Tiranë është i vetmi institucion i arsimit të lartë i llojit të tij në Republikën e Shqipërisë dhe përgatit mësues të edukimit fizik dhe specialistë të sportit. Universiteti realizon kualifikimin e plotë shkencor të specialistëve në fushat e edukimit fizik dhe sporteve deri në nivelet e masterit dhe të doktoraturës.

Strukturat e qeverisjes vendore – Këto struktura hartojnë dhe garantojnë politikat vendore në fushat e sporteve shkollore, sportit për të gjithë dhe sportet elitare; krijojnë institucione përgjegjëse për sportin; menaxhojnë objektet sportive në pronësi të tyre; ndërtojnë objekte të reja sipas nevojës; dhe mbështesin zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që kryejnë veprimtari sportive në territorin e tyre.



55. Gjetet në: <https://ashs.gov.al/>

PJESA II.

ANALIZË SHUMËSEKTORIALE E BARAZISË GJINORE
NË SPORT DHE PËRMES SPORTIT NË SHQIPËRI



Analiza gjinore ndërsektoriale shqyrton kornizën ligjore dhe të politikave mbi statusin, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave në sporte (futboll, basketboll dhe volejbol). Analiza bën vlerësimin e mundësive, sfidave dhe dallimeve me të cilat përballen gratë dhe vajzat në këto sporte. Në të trajtohen disa aspekte kyçe, ku përfshihen, ndër të tjera:

- ⊙ Përfaqësimi në rolet udhëheqëse/drejtuese dhe vendimmarrje;
- ⊙ Nivelet e pjesëmarrjes;
- ⊙ Aksesin në sporte;
- ⊙ Pasqyrimi në media;
- ⊙ Pagat e barabarta;
- ⊙ Programet e mbështetjes dhe të zhvillimit;
- ⊙ Politikat dhe legjislacioni;
- ⊙ Investimet në sportet e femrave;
- ⊙ Normat shoqërore tradicionale dhe pjesëmarrja e grave në sporte.

Analiza është strukturuar në gjashtë fusha strategjike kryesore, të cilat janë:

- ⊙ Roli udhëheqës/drejtues: Përfaqësimi dhe ndjeshmëria gjinore në vendimmarrje
- ⊙ Trajnimi: Barazia gjinore në role trajnuese në sporte
- ⊙ Stereotipet në media: Stereotipet gjinore në sport dhe roli i medias
- ⊙ Dhuna ndaj grave/Dhuna me bazë gjinore: Dhuna ndaj grave/Dhuna me bazë gjinore në sport dhe përmes sportit
- ⊙ Pjesëmarrja: Pjesëmarrja në veprimtari sportive, ku merret parasysh edhe se si ndërthuren me njëri-tjetrin faktorë si raca, statusi social-ekonomik, ose aftësia e kufizuar.
- ⊙ Financimi: Investimi në sportet e femrave dhe fuqizimi ekonomik i grave, përfshirë përmes aksesit në objekte dhe pajisje sportive dhe këshillave nga ekspertët

METODOLOGJIA DHE MJETET PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Në studim janë përdorur këto **metoda kërkimore dhe teknika për mbledhjen e të dhënave**:

1. **Studim i literaturës** me informacion sasior dhe cilësor për këtë temë, për të kuptuar situatën aktuale në lidhje me barazinë gjinore në sport. Studimi i literaturës ofron një pamje të përgjithshme të dokumenteve dhe politikave kyçe ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare mbi sportin dhe barazinë gjinore në rajonin e Ballkanit, duke e lidhur atë me kontekstin shqiptar.

Në kuadër të tij u shqyrtuan përpjekjet e Shqipërisë për arritjen e barazisë gjinore në sport në përputhje me Planin e Punës për Sportin të BE-së.⁵⁶

2. **Intervista me palë të interesit dhe aktorë të fushës.** Për këtë qëllim u hartuan dy protokolle intervistash gjysmë të strukturuar:

- ⊙ **Intervista me përfaqësues të nivelit të lartë të federatave** – tre për secilën kategori sportive (futboll, basketboll dhe volejbol);
- ⊙ **Intervista me ushtrues të sporteve** – pesë sportiste dhe tre sportistë nga secila disiplinë.

Krahas këtyre, u hartua edhe një udhëzues metodologjik për kryerjen e intervistave, së bashku me modelet për formularët e pëlqimit, faqet hyrëse të intervistave me përmbledhje të secilës intervistë, dhe listat e citimeve. Intervistat janë të gjysmë strukturuar dhe me pyetje të hapura, bazuar në një varg pyetjesh, tematikash dhe udhëzimesh. Në bazë të disponueshmërisë së personave, intervistat u zhvilluan ose me prani fizike, ose përmes telefonit ose Zoom-it. Me pëlqimin e pjesëmarrësve, pas informimit për këtë, intervistat u regjistruan me zë, ose, sipas preferencës së personit të intervistuar, u mbajtën shënime me shkrim. Në kryerjen e intervistave, studiuesit iu përmbajtën kritereve ligjore

56. EU Work Plan for Sports (Plani i punës për sportet i BE-së). Gjetendet në: <https://www.ecos-europe.com/wp-content/uploads/2020/12/Workplan-UE-sport-2021-2024.pdf>

ndërkombëtare dhe kombëtare lidhur me praktikatat e sigurta të punës, mbrojtjen e të dhënave, dhe të drejtat e pjesëmarrësve për konfidencialitet dhe privatësi, si dhe përcaktuan hapa të personalizuar dhe specifike për kontekstin në përmbushje të atyre kritereve.

3. **Pyetësi:** Për mbledhjen e të dhënave nga institucionet përkatëse, në veçanti nga federatat e tre sporteve objekt i studimit (futbolli, volejboli dhe basketbolli), u hartua një pyetësor mbi politikatat dhe praktikatat ekzistuese në lidhje me barazinë gjinore në sport dhe përmes sportit. Pyetësi përbëhet nga gjashtë pjesë, ku si përgjigje kërkohet vendosja e shenjave në kuti ose jepet një listë përgjigjesh të gatshme shoqëruar me një kontinuum kualitativ. Pjesët përfshijnë: **Roli udhëheqës/drejtuës:** Përfaqësimi dhe ndjeshmëria gjinore në vendimmarrje; **Trajnimi:** Barazia gjinore në role trajnuese në sporte; **Stereotipet në media:** Stereotipet gjinore në sport dhe roli i medias; **Dhuna me bazë gjinore:** Dhuna me bazë gjinore në sport dhe përmes sportit; **Pjesëmarrja:** Pjesëmarrja në veprimtari sportive; dhe **Financimi:** Investimi në sportet e femrave dhe fuqizimi ekonomik i grave. Pyetësi u shpërnda me email në tri federatat e përzgjedhura. Pyetësi u hartua në mënyrë të tillë që të plotësohej nga vetë anëtarët e personelit të institucioneve përkatëse; megjithatë, në rastet kur kërkohet ndihmë për plotësimin e tij, u organizuan takime me personelin e caktuar në institucionin përkatës dhe ekipin e konsulentëve të studimit, për t'u dhënë informacion/detaje të mëtejshme.

KUADRI ETIK I STUDIMIT

Qasja etike ishte në përputhje me udhëzimet përkatëse të UN Women, që shërbyen si bazë për të gjithë protokollat kërkimore dhe të mbledhjes së të dhënave për analizën shumësektoriale. Kjo përfshin intervistat si edhe studimet kërkimore parësore të tjera të planifikuara si pjesë e procesit të analizës. Studimi u hartua në mënyrë të tillë që:

- Të bënte një vlerësim të plotë të ndikimeve të mundshme të kryerjes së studimit kërkimor primar tek individët, duke e përshtatur kërkimin

me qëllim që të minimizoheshin risqet për pjesëmarrësit dhe vetë studiuesit.

- Të zbatonte parimet kyçe etike dhe praktikatat më të mira gjatë kryerjes së kërkimit, përfshirë pëlqimin në bazë të informacionit, konfidencialitetin dhe anonimitetin, për t'i mbrojtur pjesëmarrësit në studim dhe vetë studiuesit nga ndonjë dëm.

Vëmendje e duhur iu kushtua pasojave të mundshme të punës kërkimore tek individë të ndryshëm pjesëmarrës në studim. Metodatat dhe qasjet kërkimore u përshtatën sipas nevojës për t'i mbrojtur të gjithë personat e intervistuar nga dëmtimi (përfshirë intervistuesit/studiuesit). Vëmendje e veçantë iu kushtua grupeve të cenueshme, ndër të cilët personat e marginalizuar për shkak të gjinisë, seksualitetit, aftësisë (së kufizuar), moshës, racës, përkatësisë etnike, fesë, dhe gjendjes social-ekonomike. Intervistat u kryen me individë të cilët dhanë pëlqimin për pjesëmarrje me vullnetin e tyre të lirë. Të gjithë pjesëmarrësit u pyetën nëse jepnin pëlqimin e tyre plotësisht dhe realisht, përpara se sa të kryhej intervista apo ndonjë aktivitet tjetër.

KUFIZIMET

Një kufizim i rëndësishëm i kësaj analize është mungesa e të dhënave të përgjithshme relevante dhe të besueshme mbi barazinë gjinore në sport dhe pjesëmarrjen e grave dhe të burrave në veprimtari të ndryshme sportive në Shqipëri. Kjo u manifestua në informacionin e kufizuar nga institucionet sportive, numrin e kufizuar të kërkimeve shkencore të disponueshme publikisht, dhe të statistikave zyrtare për gjininë dhe sportin. Krahas kësaj, vlerat dhe kultura e rrënjësuar patriarkale në institucionet sportive bëjnë që të ketë mungesë besimi, si brenda institucioneve, ashtu edhe ndaj personave të jashtëm, lidhur me thellimin e njohurive ekzistuese për barazinë gjinore në sporte, gjë që çon në mungesë interesi për të bashkëpunuar me studiues dhe hezitim për të marrë pjesë në procesin kërkimor. Së fundi, për shkak të angazhimeve të mëparshme të palëve të interesit të përzgjedhur për t'u intervistuar, procesi i intervistimit, si për palët e interesit në sporte, ashtu edhe për sportistët, mori më shumë kohë se sa ishte planifikuar.

ANALIZA E SITUATËS: BARAZIA GJINORE NË SPORT

ROLI UDHËHEQËS/DREJTUES: PËRFAQËSIMI DHE NDJESHMËRIA GJINORE NË VENDIMMARRJE

Të gjitha të dhënat e disponueshme konfirmojnë se në nivel global, gratë vazhdojnë të jenë mjaft të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse ose drejtuese të larta në organizatat sportive. Raporti analitik i KiE-së "All In! Towards Gender Balance in European Sport (Të gjithë të përfshirë: drejt balancës gjinore në sport)"⁵⁷ tregon se gratë janë të nënpërfaqësuar në pozita vendimmarrëse si në federatat e sporteve olimpike, ashtu edhe në Komitetet Olimpikë Kombëtare (KOK). Përqindja e presidenteve femra në Evropë është veçanërisht e ulët, ku gratë përbëjnë 19 për qind të presidentëve të Komiteteve Olimpikë Kombëtare, dhe vetëm 7 për qind të federatave olimpikë. Numri i zëvendës-presidenteve gra është më i lartë: ato zënë 29 për qind të këtyre posteve në Komitetet Olimpikë dhe 81 për qind në federatat e sporteve olimpikë. Në të dyja organizatat, 22 për qind e anëtarëve të bordit janë gra.

Pabarazia gjinore në bordet e organizatave sportive, sidomos në pozita vendimmarrëse, mbetet problem i rëndësishëm në Shqipëri. Praktikant patriarkale të seleksionimit dhe kultura organizative përforcojnë pabarazinë, pavarësisht fakteve që tregojnë se burrat në role drejtuese e pranojnë ekzistencën e këtij problemi. Pengesat strukturore të krijuara nga normat, vlerat, dhe praktikant institucionale diskriminuese në sporte, vazhdojnë t'i kufizojnë opsionet, mundësitë dhe ndikimin e grave në vendimmarrje. Praktikant dhe qëndrimet kulturore dhe stereotipet gjinore vazhdojnë t'i zvogëlojnë mundësitë e grave që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh nga politikëbërësit në sporte. Ndonëse ekzistojnë politika të barazisë gjinore, veprimet për realizimin e barazisë gjinore në sport janë më të kufizuara. Gjuha patriarkale, stereotipet

dhe profilizimi gjinore shkaktojnë sfida emocionale dhe praktike për gratë në sporte, përfshirë ato në pozita udhëheqëse/drejtuese. Sipas Raportit Analitik të KiE-së për Shqipërinë, në krye të 22 federatave të sporteve olimpikë janë presidentë meshkuj. Në pozitën e zëvendës-presidentit të Federatës Kombëtare të Sporteve Olimpikë Kombëtare, janë dy gra (14%), nga 14 që është numri i gjithsejtë.

FIGURA 1. ZËVENDËSPRESIDENTË MESHKIJ DHE FEMRA NË FEDERATAT KOMBËTARE TË SPORTEVE OLIMPIKE






FIGURA 2. DREJTUES EKZEKUTIVË FEMRA DHE MESHKIJ NË FEDERATAT KOMBËTARE TË SPORTEVE OLIMPIKE



57. Këshilli i Evropës (2019). All In! Towards Gender Balance in European Sport (Të gjithë të përfshirë: drejt balancës gjinore në sport). Raport analitik i fushatës së mbledhjes së të dhënave. Gjetendet në: <https://rm.CoE.int/analytical-report-of-the-data-collection-campaign-all-in-towards-gende/1680971a71>

FIGURA 3. FEMRA DHE MESHKUJ ANËTARË TË BORDEVE TË FEDERATAVE KOMBËTARE TË SPORTEVE OLIMPIKE DHE KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR



9 nga 22 (41%) federatat sportive olimpik nuk kanë anëtare femra në bordet e tyre.



Indeksi i Barazisë Gjinore i Shqipërisë 2020 vë në dukje nivelin e ulët të përfaqësimit të grave në organet më të larta vendimmarrëse të organizatave sportive olimpik kombëtare, ku burrat zënë mbi 90 për qind të vendeve. Krahasuar me mesataren e BE-së, gratë në Shqipëri janë pak të përfaqësuara në organin më të lartë të organizatave sportive olimpik kombëtare (9,4 për qind kundrejt 14,8 për qind).⁵⁸

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ka ndërmarrë një numër veprimesh korrigjuese për rekrutimin ose shtimin e numrit të grave në pozita vendimmarrëse, që nga vendosja e kuotave gjinore deri tek përgatitja e kurseve të trajnimit mbi gratë në role udhëheqëse/drejtuese dhe kryerja e fushatave për ngritjen e ndërgjegjësimit.^{59,60} Aktualisht, nga 12 anëtarë gjithsej të Bordit të Komitetit Olimpik Kombëtar, 3 janë gra, që përmbush kriterin e kuotës gjinore prej 40 për qind gra. Situata në Federatën e Volejbollit është shumë më e ndryshme nga sportet e tjera.

Gratë aty përfaqësojnë 50 për qind të Komitetit Ekzekutiv dhe më se 50 për qind të sportistëve dhe pozitave drejtuese të larta. Në Federatën e Basketbollit, gratë zënë dy nga rolet drejtuese të larta, nga gjashtë anëtarë të bordit.⁶¹ Sipas informacionit të marrë nga Federata Shqiptare e Futbollit, në Komitetin Ekzekutiv është anëtare një grua, ndërsa pesë gra janë në role menaxhuese, dhe Federata vazhdon të promovojë gratë si përfaqësuese të Federatës Shqiptare të Futbollit në role të ndryshme, si delegate ose gjyqtare në nivel ndërkombëtar.

Megjithatë, për këto aspekte nuk ka të dhëna zyrtare. Federata Shqiptare e Futbollit synon të rrisë përfaqësimin e grave në pozitat e niveleve më të larta vendimmarrëse, që shprehet qartë edhe në Strategjinë e Futbollit të Femrave, **“Rising stars!”**

58. Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020 (Indeksi i barazisë gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020). Gjetet në: https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_albania.pdf

59. Ndër masat dhe mjetet e tjera korrigjuese përfshihen: hartimi i një plani veprimi/strategjie me shkrim për rritjen e numrit të grave në pozita udhëheqëse; organizimi i procedurave transparente, të qarta dhe favorizuese gjinore në proceset zgjedhore dhe të emërimit; përfshirja e përfaqësimit gjinor në statute, në lidhje me bordet/komitetet e tyre; vendosja e kuotave/objektivave gjinore në procedurat zgjedhore/të emërimeve; hartimi i kurseve arsimore/trajnuese mbi udhëheqjen vetëm për gratë; organizimi i seminareve trajnuese, etj. për vendimmarrësit; dhe fushatat ndërgjegjësuere për inkurajimin e grave që të kandidojnë për pozita vendimmarrëse.

60. Gjetet në: <https://rm.CoE.int/albania-gender-equality-in-sport-leaflet-2019-/1680971a1c>

61. Sipas informacionit të marrë nga pyetësi i përdorur me Federatën Shqiptare të Volejbollit dhe Federatën Shqiptare të Basketbollit.

.....

“Futbolli i bashkon njerëzit në të gjitha nivelet, kështu që futbolli i femrave ishte një pikë që mungonte dhe tani është prioritet [...] Ne mund të krijojmë shembuj të mirë që mund të përçojnë mesazhe të fuqishëm për të gjitha gratë..” Përfaësues i lartë në FSHF

.....

Pavarësisht nga këto përpjekje, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në role udhëheqëse dhe në pozita të larta menaxheriale në sport. Aksesi i tyre në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse kufizohet në të gjitha nivelet, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Përfaqësimi më i ulët i grave në pozita udhëheqëse është një prej manifestimeve kryesore të pabarazisë gjinore në sporte.

TRAJNIMI: BARAZIA GJINORE NË ROLE TRAJNUESE NË SPORTE

Trajnimi është një fushë tjetër e sporteve ku gratë janë përgjithësisht të nënpërfaqësuar. Bazuar në shifrat nga shtatë shtete anëtare të BE-së, vlerësohet se vetëm 20-30 për qind e të gjithë trajnerëve sportivë në Evropë janë gra.⁶² Të dhënat evropiane konfirmojnë se trajneret janë shpesh më aktive në sportet me përqindje më të madhe pjesëmarrësesh femra (p.sh. vallëzim, gjimnastikë, patinazh artistik dhe hipizëm) dhe ato më së shumti punojnë me gra, të rinj dhe të reja adoleshentë ose fëmijë, që konkurrojnë në nivel vendor dhe rajonal. Megjithatë, pothuaj në të gjitha sportet, numri i trajnerëve është disproporcionalisht më i ulët krahasuar me pjesëmarrjen e përgjithshme të grave dhe vajzave në sportin përkatës, ku pjesëmarrja e grave si trajnere është sporadike.

Kështu, ndonëse ka shumë burra që janë trajnerë të grave dhe vajzave, madje edhe në sportet ku mbizotërojnë femrat, shumë pak gra janë trajnere të burrave. Në nivelin elitare, numri i trajnerëve gra është shumë i ulët dhe, në rastet kur trajneret gra punojnë me sportistë në nivelet më të larta të performancës, ato zakonisht punojnë si asistent-trajnere, si ndihmëse të trajnerëve kryesorë meshkuj.⁶³

Në Kupën e Botës të FIFA-s për femra të vitit 2019, vetëm 9 nga 24 ekipet kombëtare që konkurruan kishin trajnere femra (37,5 për qind). Në Francë, Gjermani dhe Holandë, përqindja e grave që janë të kualifikuara dhe kanë licencë trajnime “A” të UEFA-s (kualifikimi më i lartë për trajnerë në Evropë) është më pak se 2 për qind e totalit, dhe në Spanjë është më pak se 0,5 për qind. Në Angli, në vitin 2017, vetëm 41 gra kishin licencë trajnime A të Unionit të Shoqatave të Futbollit të Evropës (UEFA), krahasuar me 1672 trajnerë burra.⁶⁴


Në Shqipëri ka nënpërfaqësim të theksuar të trajnerëve gra në të gjithë sportet e vendit.

62. Komisioni Evropian (2014), *Gender Equality in Sport: Proposal for Strategic Actions 2014–2020* (Barazia gjinore në sport: Propozim për veprime strategjike 2014-2020), http://ec.europa.eu/sport/events/2013/documents/20131203-gender/final-proposal-1802_en.pdf

63. IEBGJ. *Gender Equality in Sports* (Barazia gjinore në sporte) Gjetet në: <https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/mh0215937enn.pdf>

64. UN Women (2021). *Guidelines for Gender-Responsive Sports Organizations* (Udhëzime për organizata sportive reaguese gjinore). Gjetet në: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2021/7/UNWOMEN_Guidelines%20ENG-min.pdf

FIGURA 4. TRAJNERËT MESHKUJ DHE FEMRA TË REGJISTRUAR DHE TË PUNËSUAR SI TRAJNERË NË NIVELIN E SPORTIT ELITAR



Trajneret rrallë shihen në sporte që tradicionalisht perceptohen si “sporte të meshkujve”, dhe ekipet sportive të femrave në vend drejtohen kryesisht nga trajnerë meshkuj. Federatat me përqindje më të lartë të trajnereve femra të regjistruara janë si vijon:

Gjymnastikë
60% (n=18)

Atletikë:
40% (n= 20)

Gjuajtje me shigjetë
38% (n=6)




Federatat ku nuk ka trajnere të regjistruara janë boksi, çiklizmi, hendbolli, vozitja, peshëngritja dhe mundja. Në Shqipëri nuk ka federata sportive mebalancë gjinore në radhët e trajnereve të regjistruar.

Sipas një studimi analitik të KiE-së, 50 për qind e federatave sportive në Shqipëri kanë të paktën një trajnere femër, me një maksimum prej tetë trajnesh femra. Në total, në role trajnuese në vend janë 25 gra kundrejt 88 burra.

Sipas informacionit të marrë nga Federata Shqiptare e Futbollit, numri i trajnereve femra të regjistruara është 78 gjithsej, si vijon:

- Me licenca UEFA Pro: 2 për qind
- Me licenca UEFA A: 1 për qind
- Me licenca UEFA B: 6,5 për qind
- Me licenca UEFA C: 8 për qind

FIGURA 5. NUMRI I TRAJNEREVE FEMRA KUNDREJT TRAJNERËVE MESHKUJ QË KANË KUALIFIKIME TRAJNIMI NË FUTBOLL



Sipas informacionit të marrë nga Federata Shqiptare e Futbollit, ndonëse numri i tanishëm i trajnereve të regjistruara është ende i vogël, vitet e fundit është shënuar një rritje e ndjeshme e numrit të tyre. Megjithatë, statistikat zyrtare për këtë mungojnë. Në nivelin e trajnimit elitare janë të punësuar gjashtë gra, sipas të dhënave të Federatës së Futbollit. Nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e grave që punojnë si asistent-trajnere. Numri i trajnereve femra të regjistruara në Federatën e Volejbollit është më i lartë, ku më se 50 për qind e trajnerëve të volejbollit janë gra. Në Federatën e Basketbollit, trajnere gra janë më pak se gjysma, ku të regjistruara si trajnere janë 20 gra, nga 50 trajnerë gjithsej.⁶⁵ Intervistat me palët e interesit nxjerrin në pah disa arsye pse numri i trajnereve femra është i ulët, ndër të cilat stereotipet për rolet gjinore, aksesit i kufizuar në formimin e trajnerëve dhe mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional për trajneret femra. Këto elemente kontribuojnë në minimin e vetëbesimit të grave dhe të aksesit të tyre në mundësi formimi për të fituar aftësitë dhe njohuritë për t'u bërë trajnere profesioniste.

Që nga viti 2015, Komiteti Olimpik dhe federatat kombëtare të sporteve olimpikë kanë marrë një varg masash për rritjen e numrit të trajnereve gra. Sipas studimit analitik të KiE-së, Komiteti Olimpik ka hartuar një plan veprimi me shkrim, ka organizuar fushata ndërgjegjësuese që u drejtohen grave dhe vajzave, dhe ka zhvilluar kurse arsimore/trajnimi vetëm për gratë, për të rekrutuar ose për të rritur numrin e trajnereve femra. Nëntë nga federatat sportive kanë zbatuar masa për rekrutimin ose rritjen e numrit të trajnereve femra (gjuajtje me hark, kanoe, hipizëm, futboll, xhudo, not, taekwondo dhe tenis). Federata e Futbollit ka zhvilluar kurse për licenca trajnimi UEFA C dhe B pa pagesë për gratë dhe ka hapur vende për praktikë profesionale për asistent-trajnere. Në përgjithësi, analiza tregon se gratë janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e trajnimit në Shqipëri, që nga niveli kombëtar deri

në arenën ndërkombëtare. Në nivelin elitare, numri i trajnereve është shumë i ulët dhe, në rastet kur ato punojnë me sportistë në nivelet më të larta të performancës, zakonisht janë në rolin e asistentes, si ndihmëse të trajnerëve kryesorë. Perceptimet stereotipike për trajnimin si punë për meshkujt; mungesa e mbështetjes institucionale për gratë që duan të ndjekin karrierën si trajnere; dhe mungesa e shembujve femërorë në këtë fushë janë arsyt kryesore për situatën aktuale.

STEREOTIPET NË MEDIA: STEREOTIPET GJINORE NË SPORT DHE ROLI I MEDIAS

Stereotipizimi i sportistëve dhe sportisteve në media ka qenë shqetësim i vazhdueshëm. Me gjithë rritjen e ndjeshme të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në sport dhe një audience gjithnjë në rritje të sporteve elitare të femrave, ende ka dallime të konsiderueshme në pasqyrimin në media të sporteve të femrave dhe të meshkujve, ku sportet e meshkujve janë shumë më tepër të pasqyruara në media se ato të femrave.⁶⁶ Sportet kryesisht ndahen në sfera "të meshkujve" dhe "të femrave" dhe, në shumë sporte, pjesëmarrja e përzier gjinore nuk lejohet, ose nuk pasqyrohet në media. Në shumë raste, mediat kanë përcjellë mesazhe që konfirmojnë përmasat diskriminuese gjinore në sport, në vend që t'u kundërvihen atyre. Pasqyrimi në media i sportit të grave vazhdon të ndikohet nga stereotipet gjinore dhe jo vetëm që sportet e grave transmetohen më pak se sa sportet e burrave, por edhe sportistët portretizohen në një mënyrë tejet të seksualizuar që pasqyron dhe përforcon stereotipet gjinore, duke theksuar tërheqjen seksuale në vend të forcës dhe aftësisë si sportiste. Kjo kontribuon në zhvlerësimin dhe njohjen e kufizuar të sportisteve femra. Në vitin 2023, 40 për qind e të gjithë pjesëmarrësve në sporte ishin gra, por sipas UNESCO-s, sportet e femrave zinin vetëm rreth 4 për qind të gjithë pasqyrimin të sporteve në media.⁶⁷

65. Sipas të dhënave të marra përmes pyetësorit të plotësuar nga përfaqësues të Federatës së Volejbollit dhe Federatës së Basketbollit.

66. IEBGJ (2017). *Gender Equality in Sports* (Barazia gjinore në sporte). Gjetet në: https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/ti_pubpdf_mh0616311enn_pdfweb_20170125171327_corr.pdf

67. UNESCO: <https://en.unesco.org/themes/gender-equality-sports-media>

Sipas një vlerësimi të vitit 2018, të mbulimit nga mediat sportive të çështjeve racore dhe gjinore, për qind e redaktorëve sportivë dhe 88,5 për qind e gazetarëve reporterë ishin burra. Krahas kësaj, rezultatet e një studimi të gjerë të kryer në 22 vende në të gjithë botën tregojnë se gazetaria sportive në median e shkruar është shpesh “botë e burrave”, me 90 për qind të artikujve të shkruar nga gazetarë meshkuj. Për më tepër, burrat tradicionalisht mbulojnë sportetsi futbollit, regbi, kriket dhe hokej në akull, kurse grave u caktohen disiplinat “e dorës së dytë” që zakonisht përmenden në rubrikën “sporte të tjera”. Studimi tregon gjithashtu se më shumë se 85 për qind e pasqyrimit në shtyp i kushtohet sportistëve burra. Edhe koha që i kushtohet transmetimit të sporteve të grave në televizion është gjithashtu shumë më e pakët.⁶⁸ Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, ndërsa për ekipin e basketbollit të femrave që fitoi medaljen e pestë të artë rresht në Lojërat Olimpikë të vitit 2012 pati një transmetim prej më pak se gjysmë minute në orarin e pikut, për ekipin e meshkujve, që mori vetëm medaljen e dytë të artë rresht, mbulimi ishte me rreth gjysmë ore në kohën e pikut.⁶⁹ Të dhënat e UNESCO-s tregojnë se vetëm 4 për qind e përmbajtjes në mediat sportive i dedikohet sportit të femrave. Në këtë 4 për qind pasqyrim, raportimet shpesh përmendin pamjen fizike të grave, moshën dhe jetën personale të tyre, në vend të aftësive të tyre si sportiste. Krahas kësaj, vetëm 12 për qind e lajmeve sportive transmetohen nga gratë.⁷⁰ Për më tepër, veprimtaritë sportive të grave mbeten të përjashtuara nga industria mediatike miliardadollarëshe dhe, ndonëse shumë gara dhe kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare përfshijnë aktivitetet sportive të grave dhe të burrave, aktivitetet sportive të burrave gjithmonë dominojnë në media dhe në vëmendjen vendore dhe globale.⁷¹ Sipas një raporti analitik të KiE-së, në Lojërat Olimpikë të Rios në vitin 2016, kishte barazi gjinore ndër gazetarët dhe reporterët shqiptarë. Megjithatë, burrat

ende mbizotërojnë në gazetarinë sportive dhe, për shembull, në Lojërat Olimpikë dimërore në Pjongçang kishte vetëm një reportere femër. Tre nga federatat sportive në Shqipëri kanë udhëzues për sigurimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në materialet e tyre komunikuese, përfshirë në mediat sociale. Për shembull, Federata e Skive ka përcaktuar që në postimet e saj në rrjetet sociale duhet të përdoren pamje si të burrave, ashtu edhe të grave. Sipas informacionit të marrë nga Federata e Futbollit, barazia gjinore theksohet vazhdimisht në të gjitha komunikimet me palët e interesit, ku promovimi i futbollit të femrave është në qendër të vëmendjes, gjë që reflektohet edhe në të gjitha komunikimet e përditshme që postohen në faqen e internetit të FSHF-së.

Intervistat me përfaqësuesit e FSHF-së treguan se sportet e meshkujve dhe të femrave paraqiten në mënyrë të barabartë (në lajme, programe, dhe kohë transmetimi) në botimet dhe postimet e federatës (në mediat sociale, faqen e internetit, revista, radio, televizion, etj.). Megjithatë numri i kampionateve dhe ndeshjeve të femrave në media është më i vogël se në lajmet dhe botimet e FSHF-së. Po kështu, mungon edhe pasqyrimi në media i sportistëve dhe trajnereve si shembuj pozitivë. Në Shqipëri, gratë shpesh portretizohen në mediat sportive si “vajza”, pavarësisht nga moshja e tyre, si dhe përshkruhen pamja dhe atributet fizike dhe reagimet emocionale të tyre, shpesh në mënyra që theksojnë dobësinë, pasivitetin dhe mungesën e rëndësisë së tyre. Ky stereotipizim gjinor në media mund të ketë ndikim të madh në perceptimet dhe qëndrimet e brezit të ri ndaj grave dhe barazisë gjinore. Pasqyrimi, marketingu dhe promovimi i sporteve të grave janë gjithashtu tejet të seksualizuara. Sportistet femra shpesh vlerësohen për formën e trupit, sa të pashme dhe tërheqëse janë seksualisht, dhe jo për cilësitë që kanë si sportiste dhe për aftësitë teknike të tyre.

68. Institute for Diversity and Ethics in Sport (Instituti për Diversitet dhe Etikë në Sport) (2018). *The 2018 Sports Media Racial and Gender Report Card: Associated Press Sports Editors (APSE)* (Vlerësimi i mbulimit nga mediat sportive të çështjeve racore dhe gjinore i vitit 2018: Redaktorët sportivë të Associated Press). Gjetendet në: https://www.tidesport.org/files/ugd/7d86e5_9dca4bc2067241cd-ba67aa2f1b09fd1b.pdf

69. Parlamenti Evropian. *Gender Equality in Sport: Getting Closer Every Day* (Barazia gjinore në sport: më afër çdo ditë). Gjetendet në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/EPRS_BRI\(2019\)635560_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/EPRS_BRI(2019)635560_EN.pdf)

70. <https://www.unesco.org/en>

71. Gjetendet në: <https://www.un.org/womenwatch/daw/public/Women%20and%20Sport.pdf>

“Ne nuk na jepet e njëjta vëmendje, e njëjta mbështetje, e njëjta dukshmëri. Ndashjet tona nuk transmetohen drejtpërdrejt, për shembull, dhe nuk e di se kur do të bëhet e mundur kjo...”

“Megjithëse ne luanim ndeshje në Ligën e Kampioneve të femrave dhe hyrja ishte pa pagesë, ne kishim pak spektatorë në stadium. Me përjashtim të një ose dy ndeshjeve, ku erdhën rreth 7000 deri 8000 sportdashës, pjesa tjetër e ndeshjeve është ndjekur nga më pak spektatorë, krahasuar me ata që ndjekin ndeshjet e luajtura nga meshkujt”.

Menaxheri i përgjithshëm i KFF Vllaznia

DHUNA ME BAZË GJINORE: DHUNA ME BAZË GJINORE NË SPORT DHE PËRMES SPORTIT

Dhuna me bazë gjinore në sport është fenomen i njohur. Studimet e kryera në një numër vendesh tregojnë për përhapjen e dhunës dhe ngacmimeve në sport: 40-50 për qind e sportistëve femra të anketuara në Kanada dhe 27 për qind e tyre në Australi kanë raportuar ngacmime.⁷² Dhuna me bazë gjinore lidhet veçanërisht me aspekte ndërsektoriale, ku gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë më shumë episode dhune se sa gratë e tjera në sporte. Sikurse vëren Komisioni Evropian “veprimi dhe vlerësimi ndryshon nga sporti në sport dhe nga vendi në vend. Dhuna me bazë gjinore në sport përfshin edhe abuzimin dhe ngacmimin seksual të grave dhe vajzave nga trajnerët.”⁷³

Ngacmimi gjinor dhe seksual ndodh në të gjitha sportet. Përjetimet e ngacmimit seksual janë më të shumta në nivelin elitare, dhe ngacmimi me fjalë është forma më e shpeshtë e ngacmimit në sport.⁷⁴ Që nga koha kur studiuesit filluan të botonin të dhëna empirike dhe anekdotike për këtë temë në fillim të viteve 1990, janë mbledhur sasi të mëdha të dhënash dhe njohurish për shpeshësinë dhe përhapjen, parandalimin dhe ndalimin e ngacmimit dhe abuzimit seksual në sporte. Janë mbledhur të

dhëna edhe përmes intervistave me viktimat femra të abuzimit seksual në sport. Për këtë u përdorën një numër treguesish, si mosha dhe seksi i viktimës; ekzistenca e kodeve etike dhe ekzistenca e procedurave të qarta të raportimit, si dhe mosha e personit të abuzuar dhe abuzuesit. Sipas studimit analitik të KiE-së, vetëm dy federata sportive në Shqipëri, futbollit dhe peshëngritja, kanë politika dhe/ose plane veprimi të shkruara për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore në sport. Që të dyja u miratuan në vitin 2016. Nga këto dy federata, vetëm ajo e futbollit ka një mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar përparimin e bërë, si dhe burime njerëzore të dedikuara për zbatimin e politikës/planit të veprimit. Sa u takon veprimeve dhe masave specifike të marra për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore, tri federata sportive kanë zbatuar veprime/masa për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore që nga viti 2015: futbollit, taekwondo dhe volejbollit. Që të tri federatat e ndalojnë dhunën me bazë gjinore në statutet/rregulloret/ligjet e organizatës dhe kanë hartuar kode etike dhe udhëzues etike për trajnerët dhe njerëzit në poste drejtuese dhe vendimmarrëse për mënyrën se si duhen trajtuar rastet e dhunës. Sipas informacionit të marrë nga Federata e Futbollit, çdo episod dhune shqyrtohet nga organi juridik dhe Komisioni i Etikës dhe Disiplinës.

72. Interim Asian Women and Sport Working Group (2001). *Asian Women and Sport Action Plan 2001* (Gratë aziatike dhe Plani i Veprimit për Sportin 2001), 15 dhjetor 2001, Osaka, Japoni. Gjetet në: http://www.iws.or.jp/ae/actionplan_eng.pdf

73. Komisioni Evropian, 2013.

74. IEBGJ, https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/policy-areas/sport?language_content_entity=en


Federata e Futbollit ka qenë veçanërisht aktive në këtë fushë dhe ka zbatuar disa masa të tjera, si organizimi i kurseve dhe seminareve, vendosja e procedurave zyrtare të ankesave dhe udhëzuesve për trajtimin e rasteve dhe organizimi i veprimtarive specifike për parandalimin e dhunës ndaj grave në mjediset josportive. Në raste të tjera, federata ka angazhuar disa nga lojtarët dhe lojtarët më të mirë të futbollit për të qenë ambasadorë të fushatave kundër dhunës. Dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi në kontekstin e sportit janë shqetësim për të gjitha gratë, jo vetëm për ato sportiste. Gratë dhe vajzat mund të përballen me ngacmime me fjalë, përfshirë edhe të një natyre seksuale, që mund të vijnë nga sportistë të tjerë, trajnerë, menaxherë, spektatorë, dhe anëtarë të familjes ose të komunitetit. Nocioni i maskulinitetit i bazuar në dominancën, forcën dhe fuqinë fizike të burrave, që tradicionalisht theksohet nga sportet e burrave, mund të manifestohet në dhunë ndaj të gjitha sportistëve.⁷⁵ Rreziku i dhunës dhe ngacmimit mund të burojë nga rezistenca e burrave ndaj kundërshtimit të kufijve specifike gjinorë dhe ndaj konfirmimit të pavarësisë së grave që rrjedh nga pjesëmarrja e tyre në sport, ose mund të burojë nga fakti që gratë po marrin pjesë në sporte që më parë konsideroheshin si sporte të burrave. Ngacmimet me fjalë dhe ngacmimet fizike nga trajnerët dhe menaxherët, si komentet poshtëruese apo vështrimet apo prekjat e papërshtatshme, janë shqetësim i veçantë. Në kuadër të këtij raporti nuk u raportuan episode të dhunës fizike ose seksuale nga sportistët dhe sportistët e intervistuar.

PJESËMARRJA: PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI SPORTIVE

Tradicionalisht sporti konsiderohet më së shumti si një veprimtari për djem dhe burra. Ndonëse prania

dhe përfshirja e grave në sporte ka ecur përpara në mënyrë progresive me kalimin e viteve,⁷⁶ pjesëmarrja e tyre mbetet e ulët, sidomos sa u takon grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

FIGURA 6. PJESËMARRJA NË SPORT





Ndonëse pabarazitë gjinore në nivelet e pjesëmarrjes janë problem në të gjitha sportet, kjo është veçanërisht e vërtetë për disa sporte që tradicionalisht mendohen si sporte burrash. 17 nga 22 federatat sportive kanë më pak se 40 për qind anëtare femra. Gjimnastika dhe volejboli janë sportet me përqindjet më të larta të pjesëmarrjes së grave, me përkatësisht 72 për qind dhe 62 për qind, ndërsa mundja (99%) dhe skitë (94%) kanë pothuaj vetëm anëtarë meshkuj. Vetëm federata e badmintonit është afër arritjes së balancës gjinore me 54 për qind (n=27) femra dhe 46 për qind (n=23) meshkuj anëtarë.⁷⁷

Të dhënat nga dokumenti strategjik i FSHF-së "Futbolli për kombin: 2022-2025," konfirmon se gratë vazhdojnë të kenë nivel të ulët pjesëmarrjeje ndër lojtarët e regjistruar, lojtarët në kampionate kombëtare dhe në kampionatet rajonale.

75. Melanie Lang, Lut Mergaert, Catarina Arnaut & Tine Vertommen (2023) *Gender-based violence in sport: prevalence and problems, European Journal for Sport and Society* (Dhuna me bazë gjinore në sport: përhapja dhe probleme. Revista Evropiane për Sportin dhe Shoqërinë). 20:1, 57-78, DOI: 10.1080/16138171.2021.2003057.

76. Sipas UN Women, në Lojërat Olimpike të Tokios pothuaj 49 për qind e sportistëve pjesëmarrës ishin femra, duke i bërë ato Lojërat Olimpike më të balancuara gjinore në histori. Po kështu, që të gjithë 206 Komitetet Olimpike Kombëtare kishin si përfaqësues më së paku një sportiste femër dhe një sportist mashkull.

77. Këshilli i Evropës (2019). *Albania Gender Equality in Sport* (Barazia gjinore në sport në Shqipëri). Fletëpalosje 2019. Gjetendet në: <https://rm.CoE.int/albania-gender-equality-in-sport-leaflet-2019-/1680971a1c>

FIGURA 7. NUMRI I PËRGJITHSHËM I LOJTAREVE FEMRA KUNDREJT LOJTARËVE MESHKUJ**FIGURA 8.** NUMRI I LOJTAREVE TË FUTBOLLIT FEMRA KUNDREJT LOJTARËVE MESHKUJ NË KAMPIONATET KOMBËTARE**FIGURA 9.** NUMRI I LOJTAREVE TË FUTBOLLIT FEMRA KUNDREJT LOJTARËVE MESHKUJ NË KAMPIONATET RAJONALE**TABELA 2.** LOJTARE FUTBOLLI PROFESIONISTE

Vitet	Numri i lojtareve femra
2017 - 2018	180
2018 - 2019	223
2020 - 2021	262

Sipas strategjisë së futbollit të femrave të FSHF-së, në vitin 2022 kishte rreth 2000 lojtare të regjistruara (ku përfshihen nivelet profesioniste dhe joprofesioniste) që luanin futboll në Shqipëri.

Bazuar në të dhënat e tabelave të mësipërme, ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e lojtareve profesioniste.

Të dhënat nga dokumenti strategjik i FSHF-së, "Futbolli për Kombën 2022"⁷⁸ tregojnë se numri i ekipeve pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Femrave është rritur në vite:

TABELA 3. EKIPET PJESËMARRËSE NË KAMPIONATIN KOMBËTAR TË FEMRAVE

Vitet	Numri i ekipeve të femrave
2018 - 2019	10
2020 - 2021	12

TABELA 4. LOJTARE AMATORE FEMRA U/18

Vitet	Numri i lojtareve femra
2017 - 2018	132
2018 - 2019	323
2020 - 2021	524

Sipas të dhënave në Strategjinë për Futbollin e Femrave, në periudhën 2021-2022 kishte 124 ekipe të femrave.

78. [FSHF-Football-for-the-nation-2025-1.pdf](#)



TABELA 5. NUMRI I EKIPEVE TË FUTBOLLIT TË FEMRAVE NË PERIUdhËN 2021-2022

Ekipet e futbollit 2021- 2022	
Ekipet	Numri
Ekipe A	10
Ekipe WU16	12
Ekipe WU18	67
Ekipe shkollore	35
Gjithsej	124

TABELA 6. NUMRI I EKIPEVE TË BASKETBOLLIT TË FEMRAVE NË VITIN 2023

Ekipet e basketbollit 2023	
Ekipet	Numri
Ekipe A	9
Ekipe WU16	12
Ekipe WU18	8
Ekipe shkollore	20
Gjithsej	49

TABELA 7. NUMRI I EKIPEVE TË VOLEJBOLLIT TË FEMRAVE NË VITIN 2023

Ekipe Volejboli 2023	
Ekipet	Numri
Ekipe Meshkuj	25
Ekipe Femra	67
Gjithsej	92

TABELA 8. TË DHËNA PËR SPORTET NË BAZË TË VJETARIT STATISTIKOR TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR VITET 2021-2022

Federata Shqiptare e Sportit	Klube (nr.)	Shoqata (nr.)	Veprimtari kombëtare	Veprimtari ndërkombëtare	Sportistë (F+M)	Sportistë të nivelit të lartë (F+M)	Trajnerë	Arbitra	Medaljet e fituara
Basketboll		32	18	7	1,256	74	119		
Futboll	217	217	2,517	6	4,786	80	908	269	
Volejbol	20	6	19	12	1,080	74	127	44	1

TABELA 9. NUMRI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË ANGAZHUAR NË LOJËRAT OLIMPIKE SPECIALE SI SPORTISTË DHE TRAJNERË

	2019		2020		2021		2022		2023	
	Sportistë	Trajnerë	Sportistë	Trajnerë	Sportistë	Trajnerë	Sportistë	Trajnerë	Sportistë	Trajnerë
Basketboll	42	10	22	5	22	5	145	5	126	14
Futboll	52	5	25	3	25	3	6	1	40	2

Të dhënat e marra nga MAS në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në Universitetin e Sporteve në Tiranë për vitin akademik 2021-2022 tregojnë se 513 nga 1576 studentë ishin femra,⁷⁹ që konfirmon më tej se ka dallime të konsiderueshme midis meshkujve dhe femrave që janë të interesuar të merren me sporte.

Ekzistojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në nivelin e federatave dhe të klubeve, por ato nuk janë të reflektuara në Vjetarin Statistikor të MAS-së dhe nuk përdoren sistematikisht për hartimin e programeve dhe politikave. Për personat me aftësi të kufizuara, Special Olympics Albania është organi që promovon dhe mbështet pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në sporte në Shqipëri, me fokus kryesor personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Ai është i vetmi që, prej vitit 2014, ndjek statistikën për numrin e personave me aftësi të kufizuara që merren me sport, qoftë si sportistë apo si trajnerë, përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Ratifikimi nga qeveria shqiptare e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2012) përcakton detyrime të reja për qeverinë, lidhur me ndryshimet ligjore, praktikën administrative dhe qasjet ndaj aftësisë së kufizuar, përfshirë këtu edhe sportet.

Të dhënat e marra nga Special Olympics Albania lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara intelektuale si sportistë dhe trajnerë, për periudhën 2019-2023 është 1311 sportistë (444 femra dhe 867 meshkuj) dhe 168 trajnerë (24 femra dhe 144 meshkuj).

Sipas intervistës me Special Olympics Albania, vajzat, kur rriten, kanë më pak gjasa të marrin pjesë në sporte. Niveli i ulët i pjesëmarrjes së grave me aftësi të kufizuara pasqyron diskriminimin e dyfishtë me të cilin përballen ato, si persona me aftësi të kufizuara dhe si gra, që përfshin barrierat fizike dhe në komunikim dhe aksesin e kufizuar në objekte sportive të përshtatshme dhe mjete teknologjike ndihmëse, si karrige me rrota të përshtatshme për të luajtur sport, proteza, materiale të posaçme për sportistët e verbra si biçikleta dyshe, topa tringëllues, dhe përkthimi në gjuhën e shenjave.

Gjithashtu, nuk ka të dhëna specifike lidhur me pjesëmarrjen e sportistëve nga grupet e tjera të pakicave si gratë rome, gratë me aftësi të kufizuara, personat LGBTQI etj.

79. STATISTICAL-YEARBOOK-ON-EDUCATION-AND-SPORTS-2021-2022-ENG-FINAL.pdf (arsimi.gov.al)

PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE NISMAT QË PO ZBATOHEN NË VIJIMËSI PËR PROMOVIMIN E GRAVE NË SPORTE NË SHQIPËRI

Federatat sportive kanë ndërmarrë një numër veprimesh/masash për rritjen e numrit të vajzave dhe grave që janë aktive në sport dhe/ose aktivitetet fizike.

MAS, si institucioni përgjegjës për vendimmarrjen në fushat e arsimit ashtu dhe të sportit, ka ndërmarrë një varg nismash për kultivimin e barazisë gjinore në sporte, për t'iu kundërvënë stereotipeve të lartpërmendura që janë të rrënjësura thellë në traditën dhe qëndrimet shoqërore shqiptare.

Duke filluar nga viti shkollor 2014-2015, u hartuan programe të reja për lëndët e edukimit fizik, si pjesë e nismës së qeverisë për të reformuar sistemin arsimor parauniversitar. Në kuadër të kësaj reforme, theks të veçantë ka marrë edukimi fizik, jo vetëm për sa i përket rëndësisë së tij në raport me lëndët e tjera, por edhe për rishikimin rrënjësor të tij. Programi i ri mësimor ndërthur njohuritë praktike nga mësimdhënia tradicionale e edukimit fizik në Shqipëri me njohuritë teorike dhe zhvillimet bashkëkohore evropiane në kurrikulat arsimore parauniversitare. Për pasojë, lënda është riemërtuar në "Edukim fizik, sporte dhe shëndet".

Njohuritë teorike që trajtohen në kuadër të edukimit shëndetësor përfshijnë edhe një fokus të konsiderueshëm në dhënien e njohurive dhe edukimin e të rejave dhe të rinjve me koncepte që u përkasin aspekteve sociale të sporteve, duke theksuar në veçanti gjithëpërfshirjen dhe luftimin e stereotipeve gjinore në sporte. Kjo përfshin edhe pranimin se dallimet gjinore në aspekte fizike dhe fiziologjike nuk duhet të pengojnë përfshirjen në aktivitetet fizike dhe sportive, pavarësisht nga gjinia.

EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA

Po kështu, projekti "Ekipet sportive në shkolla", i financuar nga qeveria dhe zbatuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar në bashkëpunim me shkollat nëntëvjeçare dhe të mesme në të gjithë vendin, përfaqëson zbatimin e politikave nga institucionet kryesore që hartojnë politikën në fushën e sportit (MAS, KOKSH, dhe federatat sportive) të cilat synojnë promovimin e gjithëpërfshirjes në sporte, me fokus të veçantë mbi barazinë gjinore. Në edicionin e vitit 2022, i financuar nga qeveria me një fond prej afërsisht 5,5 milion USD,⁸⁰ u përfshinë **9546 nxënës/të rinj e të reja**, në ekipe volejboli dhe basketbolli në 61 qytete në të gjithë Shqipërinë, në tre nivelet shkollore (fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë). Në të **morën pjesë gjithsej 271 shkolla**, nga të cilat 179 shkolla nëntëvjeçare dhe 92 shkolla të mesme. U krijuan rreth **760 ekipe basketbolli dhe volejboli** për të dyja gjinitë, duke kontribuar në një pjesëmarrje mbarëkombëtare në arsimin parauniversitar.

Në nivelet e arsimit nëntëvjeçar dhe të mesëm morën pjesë 641 ekipe dhe 324 trajnerë.

- 3348 nxënës, 128 trajnerë dhe 254 ekipe morën pjesë në basketboll.
- 5116 nxënës, 197 trajnerë, dhe 387 ekipe morën pjesë në volejboll.

Në nivelet e arsimit fillor morën pjesë **119 ekipe dhe 65 trajnerë**.

- 782 nxënës morën pjesë në basketboll.
- 154 nxënës morën pjesë në volejboll.

Në edicionin e vitit 2023, të financuar nga qeveria me një shumë ekuivalente me 2,7 milion USD,⁸¹ morën pjesë mbi 10,000 nxënës, 395 trajnerë, dhe u konfirmuan gjithsej 760 ekipe.

80. Në bazë të Vendimit nr. 870, datë 30 dhjetor 2022, të Këshillit të Ministrave "Për financimin e projektit 'ekipet sportive 2022' në kuadër të Lëvizjes Olimpik Shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)".

81. Miratuar me Vendimin nr. 893, datë 27 dhjetor 2022, të Këshillit të Ministrave "Për financimin e projektit 'Ekipet sportive në shkolla' në kuadër të Lëvizjes Olimpik Shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)".

- Të gjithë ekipet po vazhdojnë stërvitjen në bazë të planit të stërvitjes të miratuar nga federatat për të dyja disiplinat (volejboll/basketboll) që nga tetori 2023.
- Në tetor filloi faza e tretë e matjeve antropometrike në bashkinë e Kamzës, dhe më tej do të vijohet në rrethet e Kukësit, Dibrës dhe Durrësit. Ndërkohë po përgatiten plane për të vazhduar me matjet antropometrike në tetë rrethet e tjera.

FIGURA 10. NUMRI I VAJZAVE DHE DJEMVE TË PËRFSHIRË NË PROJEKT





FIGURA 11. NUMRI I TRAJNEREVE DHE TRAJNERËVE TË PËRFSHIRË NË PROJEKT



Edicioni i tretë do të mbështetet me financim nga shteti me një buxhet mbi 3,8 milion USD.

Të gjitha shkollat e zgjedhura për këtë projekt kanë përbushur kriterin bazë për të pasur dy objekte sportive – një palestër të brendshme dhe një të jashtme për stërvitje – si dhe një trajner(e) të specializuar. Përveç kësaj, çdo ekip përfshin edhe nxënës të tjerë në role vullnetare dhe si gazetarë ose gazetare sportive. Me fillimin e vitit shkollor 2023-2024, u shpërndanë plane stërvitjeje dhe seancat e rregullta stërvitore filluan më 13 shtator 2023. Këto janë caktuar të mbahen tri herë në javë, ku çdo seancë zgjat 90 minuta, sikurse është përcaktuar në kalendarin stërvitor të paraqitur paraprakisht nga çdo trajner. Mësuesit e angazhuar në projekt, të cilët janë në rolin e trajnerëve të ekipeve, marrin pjesë edhe ata në trajnimet në vijimësi, të financuara nga projekti. Në këto trajnime angazhohen instruktorë lokalë që bashkëpunojnë me federatat e basketbollit dhe volejbollit, si dhe instruktorë të huaj nga Federata Evropiane e Volejbollit (CEV) dhe Federata Evropiane e Basketbollit (FIBA Europe). Me përfundimin me sukses të trajnimit, trajnerët marrin certifikatë që njihet nga FIBA dhe CEV-i.

Komiteti Olimpik Shqiptar ka ndërmarrë disa nisma për promovimin e barazisë gjinore në sporte dhe për të nxitur pjesëmarrjen e grave në to. Për këtë është zbatuar një kuotë gjinore në përbërjen e bordit të Komitetit Olimpik, sipas së cilës 40 për qind e anëtarëve të bordit duhet të jenë gra. Gjithashtu, është e detyruar që në Komitetin Ekzekutiv të marrin pjesë dy sportistë, një grua dhe një burrë.

Komiteti Olimpik Shqiptar ka krijuar edhe një komision të specializuar, të quajtur "Gratë dhe sporti", i drejtuar nga një grua, që ka për qëllim të mbështesë dhe fuqizojë pjesëmarrjen e grave në sporte. Edhe FSHF-ja ka ndërmarrë disa veprime konkrete për rritjen e pjesëmarrjes së grave në futboll. Ajo ka filluar një nismë të quajtur "Futbolli për shkollat" që është projekt bashkëpunimi ndërmjet FSHF-së dhe the MAS-së, që synon të promovojë futbollin në shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Programi i FIFA-s Futbollit për shkollat (FIFA F4S) / Programi i FSHF-së është pjesë e marrëveshjes. Kjo nismë ka për qëllim:

- Të mbështesë shkollat përmes trajnimit të mësuesve të edukimit fizik për të zhvilluar dhe përfshirë futbollin në aktivitetet jashtëshkollore.
- Të mbështesë shkollat përmes shpërndarjes së materialeve për zhvillimin e futbollit përmes FSHF-së.
- Të koordinojë bashkëpunimin midis FSHF-së, si anëtare e FIFA-s, dhe MAS-së.

Ndër nisma të tjera të FSHF-së janë:

- **Playmakers Disney**, në partneritet me UEFA-n – një program që përfshin fëmijët që nga moshën 6-vjecare në shumë shkolla të vendit.
- **Kampionatet shkollore** – një aktivitet tjetër që zhvillohet rregullisht nga FSHF-ja çdo vit, ku marrin pjesë 2000 vajza.
- **Kupa Coca-Cola** (që u pezullua pas pandemisë së Kovidit, por është planifikuar të rifillojë në vitin 2024), ku marrin pjesë më shumë se 2000 fëmijë (djem dhe vajza) nga shkollat fillore. Kupa Coca-Cola ka për qëllim t'i edukojë fëmijët me një mënyrë jetese të shëndetshme dhe synon një sistem arsimor ku ushtrimet fizike dhe lojërat janë të rëndësishme.

Veprimet specifike të lartpërmendura kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në futboll. Për shembull, nisma e Kupës Coca-Cola filloi me 900 djem dhe asnjë vajzë. Megjithatë, ajo u zbatua për gjashtë vjet rresht dhe në vitin e fundit morën pjesë pothuaj 900 vajza. Ka një program të tërë që ofron stimuj që synojnë të rrisin numrin e grave që luajnë futboll në klube dhe akademi, përfshirë mbështetje financiare për ekipet e femrave. FSHF-ja

ka përfshirë edhe ligat e femrave dhe tani po punon për të shtuar numrin e ekipeve dhe të lojtarëve. FSHF-ja rregullisht organizon "Ditën futbollit në rrugë" në qytetet kryesore shqiptare, ku vajzat dhe djemtë njihen me futbollin.

FSHF organizon aktivitete ku sportistë dhe sportiste shqiptare u flasin për përvojat e tyre nxënësve të shkollave, me synimin që të frymëzojnë brezin e ri të luajë futboll. Ndër ta janë lojtarë dhe lojtare futbollit që vizitojnë shkollat për të shtuar interesin e fëmijëve në futboll, për të promovuar vlerat e futbollit dhe për të tërhequr sa më shumë djem dhe vajza pa dallime gjinore. Federata e Basketbollit në Shqipëri ka qenë pjesë e nismës së FIBA-s në kuadër të fushatës "Bota e saj, rregullat e saj" (*Her World, Her Rules - #HWHR*). Një nga nisimat më të njohura të FIBA-s në basketbollin e femrave është një projekt dhe fushatë e veçantë në mediat sociale që synon promovimin e basketbollit të vajzave dhe grave në të gjithë globin, përmes aktiviteteve të realizuara në partneritet me federatat kombëtare. #HWHR ka për qëllim të bashkojë gratë dhe vajzat përmes basketbollit dhe të ndihmojë zhvillimin e projekteve të basketbollit të fëmijëve, duke synuar përfshirjen e nxënësve të moshës 6 deri 15 vjeç. Në Shqipëri janë 700 vajza që marrin pjesë në aktivitete të organizuara në të gjithë vendin.

INTERVISTAT ME SPORTISTE DHE SPORTISTË

Intervistat me lojtarët femra treguan se stereotipet mund të kenë mjaft ndikim në qëndrimet ndaj grave në sport, ku perceptimet e prindërve janë veçanërisht të rëndësishme për promovimin ose jo të pjesëmarrjes në sporte të vajzave. Pjesëmarrja e vajzave dhe grave ndikohet edhe nga faktorë të tjerë, si infrastruktura,

.....

“Problemi ishte se nëna ime nuk e pranonte dot idenë që vajza e saj të luante një sport “meshkujsh”. Nëna ime ishte kundër idesë që unë të luaja futboll dhe për një kohë të gjatë e mbajti të fshehtë sa munda. Ajo nuk u thoshte njerëzve se vajza e saj luante futboll. Për ca kohë, duhet të kërkoja leje që të shkoja të luaja me ekipin.” – lojtare futbollit”

Lojtare Futbollit

.....

.....

“Unë kam hasur shumë paragjykime. Kur luaja me djemtë, shoqet më thoshin që të mos luaja më me ta, sepse nuk isha djalë, se do më bëhej trupi me muskuj dhe se do të kthehesha në tjetër njeri.” Lojtare Futbollit

.....

mungesa e mjediseve të përshtatshme, aksesit në burime, orari i aktiviteteve dhe i kohës së stërvitjes për ekipet e grave, etj. Për shembull, kalendari i aktiviteteve ndonjëherë kufizon pjesëmarrjen e tyre – oraret e stërvitjes të ekipeve të femrave ndonjëherë janë shumë vonë natën, janë në vende ku ato e kanë të vështirë të shkojnë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e tyre. Përveç kësaj, objektet ekzistuese jo gjithmonë kanë ndjeshmëri gjimore dhe nuk ofrojnë pajisje dhe programe të përshtatshme për gratë.

Financimi: Investimi në sportet e femrave dhe fuqizimi ekonomik i grave, që përfshin aksesin në objekte dhe pajisje sportive, dhe në këshilla ekspertësh.

Kufizimet në financime janë një faktor i rëndësishëm përgjegjës për pjesëmarrjen e kufizuar të grave dhe vajzave në sporte në Shqipëri. Niveli i ulët i investimeve në sportet femërore rezultoi në fonde dhe burime më të pakta për organizatat sportive të grave, duke bërë të vështirë rritjen e lëvizjes sportive të grave dhe duke çuar në paga dhe shpërblime të pabarabarta. Një nga çështjet më të rëndësishme gjimore që prek Shqipërinë, sikurse edhe shumë vende të tjera në të gjithë botën, është hendeku i vazhdueshëm në paga ndërmjet burrave dhe grave që kryejnë punë të ngjashme. Dallimi në paga është i dukshëm edhe në sektorin e sporteve, një pikë që theksohet shumë në të gjitha intervistat me sportistët. Shumë sportistë meshkuj fitojnë dy herë më shumë se sa koleget e tyre femra në Shqipëri. Në nivel global, këto shifra mund të shkojnë deri në dhjetë herë më të larta.⁸² Gjatë intervistave, shumica e pjesëmarrësve theksuan se të ardhurat e pamjaftueshme nga sporti janë arsyeja pse kërkojnë punë tjetër të paguar, me kohë të plotë ose të pjesshme, krahas angazhimit në sport. Siç u konfirmua nga intervistat, sporti me dallimet më të mëdha në pagat e burrave dhe të grave është futbollit, ku lojtarët

në kategorinë superiore paguhen disa mijëra euro në vit, ose, në disa raste, më shumë se 100 000 euro në vit. Shifrat tregojnë se gratë paguhen shumë më pak se burrat në futboll, dhe në të gjithë sportet e tjera. Arsyeja kryesore për këto dallime është audienca më e vogël dhe interesi më i ulët komercial në sportet e grave. Ekipet e kategorisë superiore në futboll luajnë në kuadër të një lige të sponsorizuar dhe ndeshjet transmetohen drejtpërdrejt, me të drejtat televizive që blihen përmes tenderit në tregun e mediave. Futbollit i femrave, si edhe ndeshjet në volejboll dhe basketboll (të luajtura si nga meshkujt, ashtu edhe nga femrat) nuk transmetohen nga asnjë stacion televiziv në Shqipëri.

Intervistat tregojnë gjithashtu se ka mungesë investimesh për sigurimin e objekteve dhe pajisjeve të përshtatshme sportive, që kufizon më tej pjesëmarrjen e femrave në sporte. Sportistët femra konfirmuan se ofrimi i mjediseve sportive në komunitet do të inkurajonte gratë dhe anëtarë të tjerë të komunitetit që të marrin pjesë në veprimtari sportive. Gjithashtu, gjatë procesit të intervistave, palët kyçe të interesit dhe sportistët dhe sportistët përmendën edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm si aksesueshmëria, intensiteti, siguria, mbështetja dhe pamja e ambienteve, të cilat janë kyçe për të krijuar motivimin e duhur për pjesëmarrje më të mirë. Ofrimi i hapësirave të posaçme për aktivitetet sportive të grave dhe të vajzave mund të ketë përfitime praktike, por edhe një kuptim simbolik, sidomos nëse ato hapësira janë publike. Në përgjithësi, akses në hapësirat komunitare i jepet më shumë burrave dhe djemve dhe, në rastet kur ato përdoren nga gratë dhe vajzat, ato zakonisht lejohen t'i përdorin, me kushte të caktuara (p.sh., vetëm kur janë të shoqëruara nga një anëtar mashkull i familjes). Intervistat me sportiste kryesore treguan se në qoftë se gratë dhe vajzat përdorin hapësirat publike, komuniteti mund të mësohet që t'i shohë gratë dhe vajzat të ndajnë hapësirat publike me burrat dhe djemtë.

82. *Forbes*, 2016; *Monster Salary Index* (Indeksi i pagave *Monster*), 2017.

PËRFUNDIME

- Brenda kornizës së krijuar të të drejtave të njeriut dhe sportit për zhvillim dhe paqe, një numër procesesh ndërqeveritare dhe në kuadër të traktateve, si dhe një numër procesesh rajonale, kanë trajtuar posaçërisht disa nga çështjet kritike të barazisë gjinore në sport dhe edukim fizik. Janë hartuar korniza globale dhe rajonale normative dhe të politikave mbi gratë, barazinë gjinore dhe sportin, që kanë hedhur themelet për një botë sporti të drejtë dhe të barabartë për gratë dhe burrat. Me gjithë ekzistencën e standardeve në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare që garantojnë parimin e barazisë gjinore dhe të drejtën që të gjithë të marrin pjesë në sport, vazhdon të ekzistojë një hendek midis standardeve dhe praktikës. Disa nga këto korniza të politikave dhe normativave pasqyrohen në kuadrin kombëtar në Shqipëri, por ende duhet të bëhet më shumë për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në politikat kombëtare dhe kuadrin ligjor për sportin, dhe që sporti të merret parasysh në politikat, strategjitë dhe ligjet kombëtare mbi barazinë gjinore. Krahas kësaj, zbatimi i këtyre kornizave në nivelin e vendit vazhdon të kufizohet nga diskriminimi gjinor në të gjitha fushat dhe të gjithë nivelet e sportit dhe edukimit fizik.
- Stereotipet gjinore dhe rolet gjinore tradicionale, përfshirë modelet tradicionale gjinore të maskulinitetit dhe feminitetit në botën e sportit, ndikojnë në aksesin dhe pjesëmarrjen e grave në shumë nivele dhe fusha të sportit, si edhe në kulturat organizative të administratave sportive dhe organeve sportive. Pavarësisht nga përparimi i bërë, pabarazitë gjinore midis grave dhe burrave vazhdojnë të ekzistojnë në sport, në veçanti për sa i përket: aksesit dhe ushtrimit të sportit, edukimit fizik dhe aktiviteteve fizike, aksesit në role me përgjegjësi; pjesëmarrjes në organet drejtuese sportive dhe në role vendimmarrëse; aksesit në burime, paga, stimuj financiarë dhe objekte sportive; pasqyrimin në media të sportistëve dhe të sporteve të femrave; riintegrimin në tregun e punës pas përfundimit të karrierës sportive; dhe dhunës me bazë gjinore, ku përfshihen ngacmimet dhe abuzimet.
- Rezultatet pozitive të sportit për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave kufizohen nga diskriminimi gjinor në të gjitha fushat dhe në të gjithë nivelet e sportit dhe të aktivitetit fizik, që ushqehet nga stereotipet për aftësitë fizike dhe rolet sociale të grave që vazhdojnë të ekzistojnë. Grave shpesh u caktohen disa lloje të ndryshme sportesh, aktiviteteve dhe garash apo kampionatesh, që janë vetëm për gratë. Janë identifikuar një numër elementesh kritike për të kundërshtuar diskriminimin gjinor dhe marrëdhëniet e pabarabarta gjinore dhe për të krijuar një mjedis që mundëson barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në shumë fusha, përfshirë edhe gratë dhe sportin. Ndër to janë përmirësimi i aftësive të grave përmes arsimit; rritja e aksesit dhe kontrollit të tyre mbi mundësitë dhe burimet, si punësimi dhe asetet ekonomike; forcimi i roleve të tyre si aktiviste dhe udhëheqëse; mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të tyre të njeriut; dhe garantimi i sigurisë së tyre, përfshirë të drejtën për të mos përjetuar dhunë.
- Pabarazia gjinore në bordet e organizatave sportive, sidomos në pozita vendimmarrëse, vazhdon të jetë problem i konsiderueshëm në Shqipëri. Praktikant patriarkale të seleksionimit dhe kultura organizative i përforcojnë këto pabarazi. Ndonëse politikat e barazisë gjinore ekzistojnë, veprimet për realizimin e barazisë gjinore në sport janë më të kufizuara. Gjuha patriarkale, stereotipet dhe profilizimet gjinore shkaktojnë sfida emocionale dhe praktike për gratë në sporte, qoftë ato sportiste, trajnere apo në pozita udhëheqëse ose drejtuese. Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe pozita të larta drejtuese dhe aksesit të tyre në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse kufizohet nga barrierat sociale dhe kulturore, si dhe paragjykimet gjinore.
- Trajneret janë të nënpërfaqësuar në të gjithë nivelet e garave apo kampionateve, që nga niveli vendor deri në arenën ndërkombëtare. Numri i

grave trajnere është i ulët në Shqipëri, qoftë si trajnere të regjistruara ashtu edhe si trajnere të nivelit elitar. Kur punojnë me sportistë dhe sportiste në nivelet më të larta të performancës, ato zakonisht punojnë si asistent-trajnere, si ndihmëse të trajnerëve kryesorë meshkuj. Perceptimet stereotipike për trajnimin si punë për burrat, mungesa e mbështetjes institucionale për gratë që duan të bëjnë karrierë si trajnere, pengesat sistematike në shumicën e organizatave sportive, dhe mungesa e shembujve femërorë mbeten arsye kryesore për situatën aktuale.

- Stereotipizimi gjinor i sportistëve në media ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm. Përveç marginalizimit të sportit të grave, pasqyrimi i sporteve të grave në media vazhdon të ndikohet nga stereotipet gjinore, që përforcojnë imazhet tradicionale të burrave dhe grave. Sportistët vazhdojnë të hiperseksualizohen, dhe seksizmi në sportet e grave është një problem i vazhdueshëm që pengon përparimin dhe barazinë e sportistëve. Pavarësisht progresit të bërë në njohjen dhe dukshmërinë e sporteve të femrave, paragjykimet dhe stereotipet gjinore vazhdojnë të kenë ndikim negativ në perceptimin e grave në sporte. Vazhdojnë komentet seksiste dhe kritikët e papërligjura ndaj performancës së sportistëve femra, që kontribuojnë në nënvlerësimin e arritjeve dhe talenteve të tyre.
- Dhuna me bazë gjinore në sport është fenomen i njohur dhe gratë me aftësi të kufizuara janë objekt i më shumë episodeve të dhunës se sa gratë e tjera.⁸³ Ngacmimi me fjalë është forma më e zakonshme e ngacmimit në sport dhe mund të vijë nga sportistët e tjerë, trajnerët, menaxherët, spektatorët, ose anëtarët e komunitetit. Ngacmimet me fjalë dhe ngacmimet fizike nga trajnerët dhe menaxherët, si komentet poshtëruese apo vështrimet apo prekjet e papërshtatshme, janë shqetësim i veçantë. Nocioni i maskulinitetit i bazuar në dominancën, fuqinë fizike dhe pushtetin e burrave, që tradicionalisht përforcohet

nga sportet mashkullore, mund të manifestohen në dhunë ndaj grave. Nocione të tilla të maskulinitetit mund të jenë faktor në rritjen e niveleve të dhunës seksuale të kryer nga sportistët meshkuj.

- Pabarazitë dhe paragjykimet shoqërore ndaj grave kanë qenë të pranishme edhe në aktivitetet sportive. Tradicionalisht, sporti është konsideruar kryesisht si aktivitet për burrat dhe djemtë. Në Shqipëri, pjesëmarrja e grave në veprimtari sportive është më e vogël se e burrave. Ndonëse prania dhe përfshirja e grave në sport ka përparuar me kalimin e viteve, pjesëmarrja e grave dhe vajzave në sporte vazhdon të jetë e pabalancuar kur krahasohet me pjesëmarrjen e burrave dhe të djemve.
- Financimi i pamjaftueshëm është një prej problemeve me të cilin përballen shumë ekipe në sportet e femrave. Ekipet e meshkujve marrin shumicën e sponsorizimeve dhe ofertave televizive. Shumica e kompanive hezitojnë të mbështesin sportet e grave; edhe ato që i mbështesin, e bëjnë këtë më shumë nisur nga ndjenja e detyrimit moral, se sa si investim. Ndonëse sportet e grave po përparojnë, ato mund të arrijnë nivele shumë më të larta po të kenë asistencën e duhur financiare. Po kështu, ka mungesë investimesh për sigurimin e objekteve dhe pajisjeve të duhura sportive. Sipas intervistave me sportistët, mungesa e objekteve dhe pajisjeve sportive për to është një pengesë e konsiderueshme. Kjo situatë kufizon më tej pjesëmarrjen e grave në sporte në vend. Financimi konsiderohet një vështirësi e konsiderueshme dhe kontribuon në pjesëmarrjen më të ulët të grave në sporte në Shqipëri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sportistët femra, të cilat nuk fitojnë të ardhura të mjaftueshme nga ushtrimi i sportit profesionist, kështu që detyrohen të bëjnë punë të tjera. Kjo kufizon kohën për stërvitje dhe përmirësimin e aftësive dhe teknikave të tyre në disiplinën përkatëse sportive, që është me rëndësi kyçe për karriera cilësore dhe të suksesshme sportive.

83. Un Women (2019). *The Value of Intersectionality in Understanding Violence Against Women and Girls (Vawg)*, korrik 2019 (Vlera e përkatësive të shumëfishta në kuptimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave). Gjetet në: <https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2019/10/The%20value%20of%20intersectionality%20in%20understanding%20violence%20against%20women%20and%20girls.pdf>

REKOMANDIME

Për organet e qeverisjes qendrore: (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), dhe Ministri i Shtetit për Fëmijët dhe Rininë, si dhe Kuvendi i Shqipërisë:

- Të miratojnë dhe/ose rishikojnë legjisllacionin dhe politikat që kanë lidhje me sportin me synim zbatimin e strategjive dhe masave të përfshira në standardet ndërkombëtare lidhur me gjininë dhe sportet. Të përfshijnë parimin e barazisë gjinore dhe strategjinë e integritit gjinor në ligjet kombëtare për sportin dhe edukimin fizik, në tërësinë e legjisllacionit dhe/ose rregulloret që kanë të bëjnë me sportet; të përditësohet terminologjia e përdorur në hartimin e ligjeve në përputhje me parimin e barazisë midis burrave dhe grave;
- Të vlerësojnë ndikimin gjinor të ligjeve të ardhshme mbi, ose që kanë lidhje me, sportin dhe edukimin fizik dhe, aty ku është e nevojshme, të rishikojnë ligjet ekzistuese nga këndvështrimi i barazisë gjinore, si edhe të sigurojnë mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë;
- Të hartojnë plane veprimi për arritjen e barazisë substantive midis grave dhe burrave në sport dhe të përfshijnë strategjinë e integritit gjinor në politikat dhe programet për sportin dhe edukimin fizik, duke përfshirë në to edhe monitorimin dhe vlerësimin;
- Të sigurojnë që në të gjitha aspektet e politikave dhe programeve sportive të përfshihen edhe interesat e grave dhe burrave nga grupe të pafavorizuara të cilët përballen me diskriminim të shumëfishtë, duke marrë parasysh të gjitha format e diskriminimit, pavarësisht nga arsyet e tij, sikurse paraqitet shprehimisht në standardet ndërkombëtare përkatëse, si edhe të ofrohet mbështetje e përshtatur posaçërisht për këto grupe aty ku është e nevojshme;
- Të integrojnë perspektivën gjinore në procesin buxhetor që lidhet me sportin, me qëllim që të promovohet akses në burimet sportive dhe përdorim i barabartë i tyre nga gratë dhe burrat për sa u përket fondeve, objekteve, burimeve njerëzore (përfshirë mundësitë për stërvitje dhe për të pasur trajner), kohës, hapësirës dhe pajisjeve për pjesëmarrje dhe gara;
- Të promovojnë dhe inkurajojnë politika dhe praktika që synojnë përfshirjen, zbatimin dhe sigurimin e integritit gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet e sportit dhe të krijojnë mekanizma specifike për këtë qëllim;
- Të sigurojnë që autoritetet publike të kërkojnë zbatimin e kriterëve të barazisë gjinore përpara se t'u japin subvencione organizatave sportive;
- Të inkurajojnë bashkëpunimin mes palëve të interesit në nivel kombëtar që janë përgjegjës ose kanë ndikim mbi sportin, edukimin fizik dhe politikat e barazisë gjinore;
- Të inkurajojnë autoritetet përgjegjëse për arsim dhe edukim në shkolla dhe jashtë tyre që të integrojnë parimin e barazisë gjinore dhe strategjinë e integritit gjinor në programet mësimore të edukimit fizik dhe sporteve;
- Të sigurojnë që shkollat të ofrojnë edukim fizik cilësor për të gjithë, përfshirë edhe përmes të mësuarit nga distanca, aty ku është e mundur;
- Të mbështesin organizatat e sportit për zhvillim⁸⁴ që të zgjerojnë gamën e aktiviteteve sportive të

84. Termi 'organizata të sportit për zhvillim' u referohet shoqatave ose grupeve që i përdorin sportet si mjet për arritjen e synimeve më të gjera sociale, arsimore ose zhvillimore. Këto organizata përdorin fuqinë e sportit jo vetëm për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit fizik ose garave, por edhe për të promovuar rezultate pozitive si gjithëpërfshirja sociale, barazia gjinore, arsimit, shëndeti, dhe zhvillimi i komunitetit.

ofruara për të gjithë, duke i përfshirë gratë dhe vajzat në mënyrë të barabartë;

- ⊙ Të vazhdojnë të investojnë në programe sportive me fokus vajzat e vogla dhe të reja, mundësisht në kombinim me seanca mbi aftësitë për jetën, për trajtimin e çështjeve gjinore;
- ⊙ Në qoftë se paketat për stimulimin ekonomik do të përfshijnë mbështetje për rimëkëmbjen e sporteve, të sigurojnë që të ketë shpërndarje të barabartë të burimeve për sportet e grave dhe të burrave dhe llogaridhënie për përdorimin e atyre burimeve;
- ⊙ Në bashkëpunim me organizatat sportive, të miratojnë, zbatojnë dhe monitorojnë politika dhe masa për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në sport, si frikësimi ose dhuna fizike, ngacmimi me fjalë, ngacmimi dhe abuzimi psikologjik dhe seksual;
- ⊙ Të hartojnë dhe zbatojnë politika dhe masa për parandalimin dhe luftimin e bullizmit, ngacmimit dhe dhunës me bazë gjinore në ushtrimin e aktivitetit fizik dhe sportit, si dhe të nxisin shkollat, organet e pushtetit vendor dhe organizatat dhe klubet sportive që t'i zbatojnë ato dhe të monitorojnë zbatimin e tyre;
- ⊙ Të promovojnë nisma ndërgjegjësuese dhe formim të trajnerëve – formim paraprak dhe në detyrë – mbi barazinë gjinore, integrimin gjinor, dhe për nevojat e ndryshme të personave të përfshirë në sport – për personelin e organeve publike përgjegjëse për formulimin dhe zbatimin e këtij rekomandimi, si dhe për personat që merren me sport;
- ⊙ Të kryejnë dhe promovojnë fushata ndërgjegjësuese për promovimin e barazisë mes grave dhe burrave në akses, pjesëmarrje dhe përfitime nga sporti dhe aktivitetet fizike gjatë gjithë fazave të ndryshme të jetës;
- ⊙ Të miratojnë kuota gjinore për organet vendimmarrëse në sporte, me kriterin e detyrueshëm që në një pjesë e pozitave të larta vendimmarrëse në organizatat sportive të jenë gra.

Për organet e vetëqeverisjes vendore:

- ⊙ Të përmirësojnë komunikimin në nivel vendor për aktivitetet sportive të organizuara, të vetorganizuara dhe të ofruara, si dhe mbështetje financiare për personat me të ardhura të ulëta. Të krijojnë, për këtë qëllim, një platformë digjitale të përbashkët në internet, ku të përfshihet, në një vend të vetëm, i gjithë informacioni që lidhet me objektet sportive;
- ⊙ T'u japin më shumë informacion nxënësve për klubet dhe mundësitë sportive vendore;
- ⊙ Të organizojnë fushata informuese lidhur me disiplina të ndryshme sportive, përfaqësimin pozitiv dhe aktivitetet e disponueshme për vajzat dhe gratë (përmes aktiviteteve si ditët e informimit, ditët e hapura, dhe ditët 'e grave dhe sportit');
- ⊙ Të sigurojnë që në programet dhe nismat sportive vendore të mbahen parasysh infrastruktura e aksesueshme dhe pajisjet sportive të përshtatshme;
- ⊙ Të sigurojnë që në planin për ndërtimin e kapaciteteve të stafit vendor të përfshihen programe reaguese gjinore trajnimit;
- ⊙ Të investojnë në objekte sportive që u përgjigjen nevojave të grave në sporte (p.sh., ndriçim të mjaftueshëm, banja, dhoma zhveshjeje, objekte sportive që janë afër transportit publik, etj.).
- ⊙ Të bashkëpunojnë me OSHC-të për promovimin e pjesëmarrjes së grave në sporte.

Për sponsorët nga sektori privat dhe donatorët:

- ⊙ Të shtojnë mbështetjen për ekipet profesioniste të femrave dhe të shtojnë sponsorizimet për sportistet femra;
- ⊙ Të vazhdojnë të promovojnë mesazhe pozitive për barazinë gjinore në marketingun e lidhur me sportet;
- ⊙ Të zgjerojnë mbështetjen për programet sportive për gratë dhe vajzat si pjesë e trashëgimisë sociale të aktiviteteve sportive të sponsorizuara nga kompania e tyre;

- Të zgjerojnë mbështetjen për sporte të sigurta dhe për hartimin e programeve që fokusohen tek vajzat.

Për Komitetin Olimpik:

- Të sigurojë që të ketë barazi të plotë gjinore në kuotat e sportistëve dhe aktivitetet ku jepen medalje;
- Për të gjitha sportet/disiplinat/aktivitetet ekipore, të sigurojë që të ketë numër të barabartë ekipesh dhe, ku është e përshtatshme, numër të barabartë sportistësh të të dy gjinive;
- Të sigurojë që formatet e garave dhe kampionateve, për sa i përket distancave, kohëzgjatjes së segmenteve të garave/kampionateve, numrit të raundeve, etj., të jenë të sa më të barabarta midis grave dhe burrave;
- Të sigurojë që uniformat e garave/kampionateve të reflektojnë kërkesat teknike të sportit dhe të mos kenë dallime të pajustificueshme;
- Aty ku është e mundur, pajisjet dhe aparatet sportive duhet të jenë të njëjta për burrat dhe gratë;
- Të sigurojë që gratë dhe burrat të përdorin të njëjtat mjedise sportive dhe fusha loje;
- Të sigurojë përfaqësim të barabartë të aktiviteteve të grave dhe burrave në kalendarët e garave/kampionateve;
- Të sigurojë trajtim të barabartë të sportistëve dhe sportistëve, dhe vizitat dhe/ose studimet mjekësore duhet të kryhen për të dyja gjinitë kur studiojnë aspekte si shëndeti dhe siguria, pajisjet dhe ndryshimet e aparateve;
- Të promovojë sporte të sigurta dhe mbrojtjen e sportistëve dhe sportistëve nga të gjitha format e ngacmimit dhe abuzimit;
- Të hartojë një plan strategjik me fokus tranzicionin e sportistëve olimpikë në karrierën e tyre pas-olimpikë;
- Të caktojë një pjesë të buxhetit të tij operativ për arritjen e synimeve të barazisë gjinore në sport, në qeverisje dhe në vetë administrimin e tij;

- Të krijojë mekanizma për trajtimin e pabarazive mes gjinive në shumat që jepen për çmimet apo pagesat e tjera për sportistët dhe sportistët;
- Të krijojë mekanizma strategjike për të shtuar numrin e kandidatëve të ardhshme për role drejtuese në përgjithësi, si edhe si anëtare të bordit ekzekutiv;
- Të zbatojë një sistem konkret raportimi për monitorimin, matjen dhe vlerësimin e aktivitetëve dhe rezultateve të barazisë gjinore në vijimësi. Ky mekanizëm monitorimi dhe raportimi duhet të jetë i drejtpërdrejtë, i lehtë për t'u përdorur dhe i koordinuar në mënyrë efikase në të gjitha fushat funksionale dhe organizatat.

Për organizatat sportive:

- Të shtojnë investimet në sportet e grave;
- Të kryejnë konsultime të gjera me vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat (sportistë, trajnerë, gjyqtarë, ekupe mjekësore dhe profesionistë të tjerë në fushën e sportit) për të kuptuar më mirë mënyrat e ndryshme se si ndikohen nga pabarazia gjinore në sport dhe të reagojnë ndaj tyre;
- Të angazhojnë sportistë, gazetarë, trajnerë, dhe aleatë të tjerë meshkuj për promovimin e sporteve të grave;
- Të përdorin personalitete të njohura për ngritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore;
- Të investojnë në politika dhe procedura për mbrojtjen dhe sigurinë e personave të angazhuar në sport dhe t'i zbatojnë ato;
- Të bashkëpunojnë me organizata dhe institucione të tjera sportive për të ndjekur dhe vlerësuar përparimin e pjesëmarrjes së balancuar të vajzave, djemve, grave dhe burrave në sport, bazuar në të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht;
- Të sigurojnë hartimin e një dokumenti politikash mbi parandalimin e dhunës me bazë gjinore, si edhe krijimin e një mekanizmi monitorimi dhe vlerësimi;
- Të promovojnë shkëmbimet e informacionit, njohurive dhe praktikave më të mira që forcojnë barazinë mes vajzave, djemve, grave dhe burrave në sport;

- Të zhvillojnë programe trajnimi, mentorimi dhe vëzhgimi për gratë, në mënyrë që ato të inkurajohen dhe t'u jepet mundësia të kualifikohen për role udhëheqëse/drejtouese, dhe t'u krijojnë atyre mundësi t'i ushtrojnë ato role;
- Të ofrojnë objekte sportive të cilat mund të arrihen lehtë me mjetet e transportit publik dhe që u përgjigjen nevojave të tyre si përdoruese, në kuptimin që duhet të jenë mikpritëse dhe të përshtatshme;
- Të përmirësojnë ofrimin e aktiviteteve argëtuese sportive dhe të caktojnë orare për aktivitetet e organizuara nga vetë komunitetet; të shohin mundësinë e ofrimit të orëve të mësimi dhe të caktojnë orare posaçërisht për gratë, ndërkohë që ofrojnë njëkohësisht edhe mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete të përziera gjinore;
- Të konsultohen rregullisht me banorët, anëtarët e klubeve dhe nxënësit në mënyrë që aktivitetet dhe kushtet në të cilat praktikohen ato t'i përshtaten kërkesave të tyre sa më shumë që të jetë e mundur;
- Të ofrojnë trajnime në vendin e punës për personelin administrativ, vullnetarët e angazhuar në klubin sportiv dhe gazetarët, për t'i bërë të vetëdijshëm për çështjen e dallimeve dhe pabarazive gjinore.

Për mediat:

- Të përcjellin imazhe, role dhe vizibilitet jo të stereotipizuar të grave dhe burrave në sporte dhe të sporteve të grave, pa riprodhuar portretizimet seksiste dhe duke eliminuar përmbajtjen dhe gjuhën seksiste që mund të çojnë në nxitje për urrejtje, dhunë dhe diskriminim me bazë gjinore, si dhe duke pasqyruar përparimin e bërë drejt arritjes së barazisë gjinore në sport;
- Të sigurojnë pjesëmarrje të balancuar të grave dhe burrave në media përmes punësimit të gazetareve sportive dhe përmes mbështetjes së karrierave të tyre nga personeli redaktorial;
- Të shtojnë ndërgjegjësimin dhe të forcojnë kapacitetet e profesionistëve të mediave sportive dhe nxënësve përmes ofrimit të programeve të rregullta arsimore dhe formuese që synojnë fitimin e njohurive të thelluara për barazinë gjinore dhe rolin themelor të saj në një shoqëri demokratike;

- Të përipiqen për arritjen e balancës në mbulim dhe sasinë e kohës së transmetimit të sporteve të grave;
- Të theksojnë sukseset e sportistëve të nivelit të lartë dhe të promovojnë shembuj pozitivë të grave që kanë arritur sukses në sport dhe përmes sportit;
- Të përmirësojnë përhapjen e informacionit dhe të imazheve të sportit të grave;
- T'u bëjnë publicitet praktikave të mira dhe të denoncojnë dhe dënojnë të gjitha rastet e diskriminimit, seksizmit dhe racizmit që prekin vajzat dhe gratë.

Për OJQ-të 'Sporti për zhvillim':

- Të hartojnë protokolle për mbështetjen e grave dhe vajzave që i kanë mbijetuar dhunës me bazë gjinore;
- Të rrisin ndërgjegjësimin ndër prindërit dhe anëtarët e komunitetit për të promovuar pjesëmarrjen e grave në sporte.



PJESA III.

INTEGRIMI I BARAZISË GJINORE NË SPORT



SI TË INTEGROHET BARAZIA GJINORE NË PROJEKTE DHE PROGRAME SPORTIVE

Për integrimin e barazisë gjinore në projekte dhe programe sportive këshillohen hapat e mëposhtëm:

Konsultimi. Është e nevojshme të sigurohen kohë dhe burime të mjaftueshme për proceset e konsultimit si me sportistet femra ashtu edhe me ata meshkuj në hartimin e programeve sportive. Këto konsultime ofrojnë një hapësirë ku mund të identifikohen barrierat dhe të negociohen nevojat që kanë gratë dhe burrat për të pasur qasje të drejtë në shërbime dhe burime. Për të shmangur marginalizimin e mëtejshëm të grupeve dhe individëve të caktuar – përfshirë marginalizimin për shkak të gjinisë – është e rëndësishme të caktohet kohë e mjaftueshme për proceset e konsultimit. Konsultimet duhet të kryhen me:

- ⊙ Komunitetet e synuara. Për të kuptuar perceptimet dhe nevojat e njerëzve duhen zbatuar metodologji pjesëmarrëse dhe të ndjeshme gjinore. Duhet të konsultohen përqindje të barabarta burrash dhe grash, ndoshta edhe në grupe më vete, për t'i bërë njerëzit të ndihen mirë dhe të flasin më lirisht. Ndër çështjet që mund të diskutohen me komunitetet e synuara (domethënë, familjet dhe anëtarët e familjeve më vete) janë: rolet dhe përgjegjësitë e burrave dhe grave në familje; qëndrimet e tanishme të bashkëshortëve, bashkëshorteve, prindërve dhe të afërmeve ndaj sportit; sasia e kohës që gratë dhe burrat shpenzojnë me punë "prodhuese" dhe "riprodhuese", sporte dhe aktivitete argëtuese.
- ⊙ Grupet që punojnë në fushën e gjinisë dhe zhvillimit (OJQ-të, sindikatat, donatorët dhe stafi i projekteve). Konsultimet me këto grupe duhet të fokusohen në përvojat dhe njohuritë e tyre lidhur me gjininë dhe zhvillimin e sporteve. Ndër temat që mund të diskutohen janë strategjitë për promovimin e barazisë gjinore në sporte, vështirësitë ekzistuese me të cilat përballen gratë dhe vajzat, dhe nismat e suksesshme që kanë përmirësuar mundësitë e drejta gjinore në sporte.
- ⊙ Qeveria dhe shoqatat sportive. Ndër aspektet që mund të diskutohen janë rolet e burrave dhe grave në trajnim; trajnimet dhe

afërsitë ekzistuese; aksesit dhe vendndodhja e objekteve sportive ekzistuese; çështje të sigurisë; ekzistenca e dhomave të zhveshjes, të hapësirave vetëm për gratë dhe kujdesit për fëmijët; pjesëmarrja e burrave dhe grave si vendimmarrës në menaxhimin sportiv; dhe lidhjet me organizatat e grave dhe komunitetet.

Konsultimet janë më të efektshme në qoftë se bazohen në ekspertizë gjinore specifike për kontekstin, për shembull nga OJQ, universitete ose organizata të tjera kërkimore.

Planifikimi. Analiza dhe konsultimi duhet të përbëjnë bazën për hartimin dhe planifikimin e çdo projekti/planit. Ndër çështjet kryesore që duhet të shqyrtohen në këtë fazë janë:

- ⊙ Formulimi i një strategjie të barazisë gjinore për projektin/programin, me objektiva specifike për avancimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave. Formulimi i objektivave specifike për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave mund të bëjë që perspektiva gjinore të mos "harrohet" gjatë ciklit të projektit (në pjesën në vijim jepen një numër treguesish që sugjerohen për secilin dimension). Po kështu, ekzistenca e një "pike fokale" gjinore mund të sigurojë që barazia gjinore të mbetet prioritet në vijimësi.
- ⊙ Krahasimi i roleve që u atribuohen burrave dhe grave në projekt me rolet e tyre në shoqëri. Analiza gjinore duhet të japë informacion të detajuar për rolet që u caktohen burrave dhe grave në sporte, si negociohen këto role, dhe pengesat që grupe dhe individë të veçantë duhet të kapërcejnë për t'i ndryshuar këto role. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë me ndjeshmëri gjinore. Mund të duhen të bëhen përpjekje për t'u bërë sportiste, trajnere dhe instruktore profesioniste. Puna avokuese për ndryshim mund të përfshijë edhe aktivitete informuese dhe komunikuese, si vizita në familje/tek prindërit etj.

- Angazhimi i organizatave të grave dhe/ose mekanizmit të barazisë gjinore në procesin e planifikimit të masave, për t'u mundësuar të gjitha grupeve dhe të gjithë individëve – sidomos grave – që të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme në projekt. Analiza gjinore mund të tregojë se disa grupe ose individë mund ta kenë të vështirë të qëndrojnë në projekt për kohë të gjatë. Dhënia e mundësisë që t'i bashkohen projektit dhe të largohen nga projekti sipas mundësisë, mund të sigurojë pjesëmarrjen e tyre afatgjatë.
- T'i kushtohet vëmendja e duhur shqetësimeve të sigurisë dhe mbrojtjes së grave dhe vajzave. Ndër masat specifike që mund të merren për t'i bërë njerëzit – sidomos gratë dhe vajzat – që të ndihen dhe të jenë më të sigurt kur marrin pjesë në programe/projekte sportive janë: përmirësimi i ndriçimit të mjediseve publike; organizimi i aktiviteteve në orare gjatë ditës, kur lëvizja është më e sigurt; organizimi i aktiviteteve sportive në zona të sigurt dhe/ose në zona afër shtëpive të pjesëmarrësve në mënyrë që të mos jetë e nevojshme të përdorin transport, etj. Mund të nevojitet gjithashtu që të hartohen kode etike për trajnerët dhe për anëtarët e tjerë të personelit të projektit/programit.
- Përfshirja e aktiviteteve të tjera zhvillimore në projekt. Programi mund të marrë më tepër mbështetje nga komuniteti në qoftë se, krahas sportit, në të përfshihen edhe aktivitete të tjera, si aktivitete të edukimit shëndetësor dhe shërbime në komunitet. Kryerja e aktiviteteve sportive dhe aktiviteteve të tjera kulturore në të njëjtin vend mund të shtojë pjesëmarrjen e grave. Edukimi për barazi gjinore dhe të drejtat e grave mund të përfshihet edhe në kontekstin e projekteve sportive.
- Të sigurohet që partnerët e projektit të kenë aftësi të mjaftueshme dhe akses në informacion. Secili projekt duhet të ketë një komponent trajnimi dhe të ndërtimeve të kapaciteteve në fushën e gjinisë, në mënyrë që të gjithë personat pjesëmarrës në projekt të jenë të vetëdijshëm për problemet e stereotipizimit gjinor dhe ndryshimeve kulturore. Këtu përfshihen stafi i projektit dhe partnerët e projektit, si shoqatat sportive dhe vajzat, djemtë, gratë dhe burrat pjesëmarrës.
- Të sigurohet që gratë të marrin pjesë në vendimmarrje. Inkurajimi i grave që të kandidojnë për role udhëheqëse/drejtuese do të thotë se duhet të kuptohet që gratë mund ta kenë të vështirë të shprehen në prani të burrave, sidomos në një fushë që tradicionalisht konsiderohet e lidhur me meshkujt. Veprimtaritë në fushën e sportit me pjesëmarrjen vetëm të një gjinie mund të ofrojnë kontekstin e duhur për forcimin e vetëbesimit dhe të mirëqenies fizike. Për këtë duhet të ketë një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues. Gjithashtu, mund të duhet që projekti të bëjë përpjekje të posaçme për identifikimin dhe tërheqjen e mentoreve dhe figurave të shquara femërore që shërbejnë si shembull për të tjerët.
- Të sigurohet që të gjithë partnerët e projektit të ndërgjegjësohen plotësisht për përmasat gjinore të projektit. Gratë dhe burrat në institucione duhet të ndërgjegjësohen më shumë për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave. E gjithë literatura e organizatës duhet të jetë me ndjeshmëri gjinore dhe të përdorë gjuhë gjithëpërfshirëse gjinore.
- Të përfshihen organizatat e grave dhe/ose mekanizmi kombëtar i grave në zbatimin e projektit.
- Të sigurohet që anëtarët e komunitetit të informohen dhe që të bëhen komunikime të rregullta për të siguruar që ata të angazhohen gjatë gjithë fazës së zbatimit, duke garantuar që çdo përmirësim në planin e projektit të vazhdojë të fokusohet në nevojat e komunitetit.

Zbatimi. Gjatë fazës së zbatimit duhet të merren parasysh këto aspekte:

- Të sigurohet që ekipi i projektit të ketë ekspertizë gjinore të mjaftueshme. Ekspertët dhe ekspertet gjinore të përfshira duhet të kenë përvojë të vendit dhe sektorit përkatës. Ato duhet të kenë përvojë në zbatimin e strategjive gjinore dhe metodave pjesëmarrëse, si dhe në monitorim dhe vlerësim.

Monitorimi dhe vlerësimi

- Monitorimi: Të sigurohet që sistemet e raportimit të projektit (mbledhjet e anëtarëve, vlerësimet vjetore, etj.) të trajtojnë edhe çështjet gjinore. Monitorimi i aktiviteteve, rezultateve, arritjeve dhe proceseve duhet të përdorë tregues të

ndjeshëm gjinorë, sikurse sugjerohet në pjesën në vijim. Krahas kësaj, raportet e monitorimit duhet të përmbajnë një seksion të veçantë për përparimin e bërë në arritjen e objektivave të projektit në lidhje me barazinë gjinore.

- Të sigurohet hartimi i treguesve me ndjeshmëri gjinore për vlerësimin e rezultateve. Treguesit duhet të nxirren nga një analizë gjinore fillestare/studim i gjendjes para zbatimit të projektit. Në to mund të përfshihen rubrika si gjendja fizike e pjesëmarrësve, tendenca për ndërmarrjen e rreziqeve seksuale, rezultatet shkollore, kuptimi i rregullave dhe taktikave të sportit, si edhe lehtësia për të pasur akses në program, shkalla e pjesëmarrjes në të, shkalla e largimit të pjesëmarrësve nga projekti, etj. Po kështu, në to mund të përfshihen edhe të dhëna të ndara sipas

gjinisë mbi: frekuentimin e seancave të trajnimit dhe pjesëmarrjen në konsultime; gratë dhe burrat në pozita drejtuese; dhe gratë dhe burrat në pozita mediatike jotradicionale. Të dhënat duhet të jenë si sasiore ashtu edhe cilësore dhe duhet të shmangët fokusi në objektivat numerikë. Gratë dhe burrat duhet të përfshihen në vlerësimin e rëndësisë së dallimeve dhe ndryshimeve dhe në formulimin e strategjive të ardhshme bazuar në ato vlerësime. Në përbërjen e ekipit të vlerësimit duhet të ketë ekspertë gjinorë.

- Të sigurohet që të formulohen “mësimet e nxjerra” për të dokumentuar sukseset dhe dështimet e strategjisë gjinore të projektit, si edhe më përgjithësisht, mënyrën se si i trajtoi projekti çështjet gjinore.

SI TË INTEGROHET BARAZIA GJINORE NË GJASHTË FUSHAT STRATEGJIKE TË SPORTIT

Nisur nga pabarazitë gjinore midis grave dhe burrave në sporte në Shqipëri, të përshkruar në kapitullin e mësipërm, fuqizimi i grave dhe vajzave dhe avancimi i barazisë gjinore në sporte është me rëndësi thelbësore dhe duhet të kryhet përmes përfshirjes reale të perspektivës së barazisë gjinore në të gjashtë fushat e sportit të analizuar në këtë dokument.

Treguesit e barazisë gjinore masin dallimet në pjesëmarrjen, përfitimet, rezultatet, dhe ndikimet tek gratë, burrat, vajzat dhe djemtë; ndryshimet pozitive ose negative në marrëdhëniet gjinore – domethënë, ndryshime drejt barazisë, ose drejt pabarazisë midis burrave dhe grave dhe midis djemve dhe vajzave; si ndikojnë këto ndryshime në arritjen e objektivave të zhvillimit, sidomos në rritjen ekonomike, uljen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Gjithashtu, treguesit luajnë rol kyç në promovimin e integritetit gjinor në të gjitha politikatat dhe programet dhe janë një instrument thelbësor për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe strategjive të barazisë gjinore.

Ka një numër nismash ku përparimi i elementëve që kanë lidhje me barazinë gjinore në sporte matet me anë të treguesve specifikë. Për shembull, ekziston një grup treguesish për matjen e përparimit të bërë në fushat e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse në role udhëheqëse ose role drejtuese të larta. Tabela e vlerësimit e Sidnit (Sydney Scoreboard) është nisma kryesore që dëshmon fuqinë e treguesve të thjeshtë, të besueshëm dhe të transferueshëm.⁸⁵ Ajo ishte rezultat i diskutimeve në Konferencën e Pestë të GNP-së mbi Gratë dhe Sportet, dhe konsultimeve me federata sportive kombëtare dhe ndërkombëtare. Qëllimi i saj është i thjeshtë: rritja e përfaqësimit të grave në bordet sportive në të gjithë botën. Falë kësaj nisme, tani janë të disponueshme të dhëna të krahasueshme të mbledhura gjatë viteve, për të dokumentuar përparimin pozitiv të grave në pozita udhëheqëse/drejtuese në sporte, ose rënien e këtyre treguesve. Tabela e vlerësimit e Sidnit operon si një instrument i fuqishëm në internet, ku mund të evidentohen gratë në rolet udhëheqëse/drejtuese në organizatat sportive,

85. Faqja e internetit e Grupit Ndërkombëtar të Punës për Gratë dhe Sportin (International Working Group on Women and Sport – IWG) The Sydney Scoreboard (Tabela e Vlerësimit e Sidnit). Gjetet në: <http://sydney scoreboard.com/>

si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, përmes evidentimit të përfaqësimit të grave në borde në organizatat sportive kombëtare dhe në federatat ndërkombëtare. Ajo përdor tre tregues kryesorë:

- Drejtorët e bordeve (anëtarë ekzekutivë),
- Kryetarët e bordeve (presidentët), dhe
- Drejtorët ekzekutivë (sekretarët e përgjithshëm).

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON) ka krijuar tregues specifikë për vlerësimin e përparimit për zbatimin e politikës së KON-it mbi rolin udhëheqës/drejtues të grave në Lëvizjen Olimpikë. Disa nga treguesit mbledhin të dhëna mbi

- proceset e rekrutimit të grave në strukturat vendimmarrëse,
- karrierën e tyre deri në pozita udhëheqëse në lëvizjen olimpikë,
- ndikimin e tyre në aktivitetet e vetë organizatave,
- natyrën e trajnimit dhe mbështetjes së duhur, si nga anëtarët femra, ashtu edhe organizatat sportive, për realizimin e përfitimeve nga përfshirja më e gjerë e grave në vendimmarrje.

Krahas kësaj, vlerësohen edhe mendimet e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe të sekretarëve të përgjithshëm të komiteteve olimpikë kombëtare mbi zbatimin dhe ndikimin e politikave.

Një punë e rëndësishme mbi treguesit e barazisë gjinore është bërë edhe nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ). Për monitorimin e përparimit të barazisë gjinore në sporte, IEBGJ-ja filloi mbledhjen e të dhënave mbi bazën e katër treguesve kryesorë:

- përqindja e grave në të gjitha pozitat vendimmarrëse në federatat sportive kombëtare në BE, 2015;
- përqindja e grave dhe burrave në pozitat vendimmarrëse në konfederatat kontinentale të sporteve olimpikë në Evropë 2015;
- përqindja e burrave dhe grave në bordet dhe komitetet ekzekutive të organeve kombëtare qeverisëse të sporteve;
- përqindja e burrave dhe grave në poste në organizata sportive ndërkombëtare me seli në Evropë.

Edhe UN Women Guidelines for Gender-Responsive Sports Organizations (Udhëzimet e UN Women për Organizata Sportive të Përgjegjshme Gjinore) ka përcaktuar tregues specifikë për secilin prej gjashtë parimeve, të cilët u hartuan bazuar në qëllimet e Planit të Veprimit të Kazanit (Veprimi 4) dhe fushat shqetësuese kritike të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim të saj. Organizatat ndërkombëtare si *Women Sport International* (WSI) kanë promovuar për një kohë të gjatë parandalimin e dhunës me bazë gjinore në sporte, përmes përdorimit të një grupi treguesish konkretë si udhëzues për hartimin e propozimeve dhe aktiviteteve të tyre.

Barazia gjinore dhe pjesëmarrja janë aspekte veçanërisht të vështira për t'u trajtuar, sepse nivelet e pjesëmarrjes varen nga shumë faktorë, që janë të vështirë të përmbledhen në tregues të thjeshtë. Megjithatë, praktikat më të mira se si mund të bëhet kjo janë të mirëdokumentuara. Federata Spanjolle e Bashkive dhe Krahinave ka hartuar një udhëzues për integrimin gjinor në objektet sportive vendore.⁸⁶ Udhëzuesi përdor një qasje shumëdrejtimëshe për të vlerësuar:

- organizatat sportive vendore dhe strukturat e tyre (politikat në sport, numri i grave në organe drejtuese, nivelet e buxheteve dhe të fondeve për aktivitete, etj.);
- si dhe nga kush përdoren objektet sportive vendore (aktivitetet që ofrohen, përdorimi i burimeve materiale, analiza e aktiviteteve të ushtruara);
- Çfarë aktivitetesh ofrohen nga klubet sportive (numri i anëtarëve, numri i të larguarve, përdorimi i financimit publik ose privat, menaxhimi i burimeve njerëzore, caktimi i objekteve, etj.);
- Aktivitetet e sporteve në shkolla (pjesëmarrja dhe lënia e aktiviteteve, kualifikimet e mësuesve, alokimi i subvencioneve shtetërore, lidhja midis ofrimit të sporteve në shkolla dhe ofrimit të sporteve nga shoqatat sportive, objektet sportive, vendndodhja e qendrave sportive, aksesit, cilësia e shërbimeve të ofruara, ndarja

86. Gjetet në: <https://sede.educacion.gob.es/publiventa/detalle.action?cod=14967>

e grupeve të pjesëmarrësve sipas gjinisë). Vlerësimi ofron gjithashtu një grup treguesish për monitorimin e përparimit të bërë, vlerësimin e politikave dhe për gjetjen e zgjidhjeve të duhura. Bazuar në analizën e të gjithë dokumenteve dhe praktikave të mësipërme dhe të materialeve të tjera burimore, propozohen **treguesit në vijim për matjen e suksesit për secilën prej fushave strategjike të sportit** të analizuar më lart:

FUSHA STRATEGJIKE 1. ROLI UDHËHEQËS/ DREJTUES

Treguesit e fushës strategjike 1. Roli udhëheqës/drejtues (për t'u përdorur në nivel kombëtar):

- ⊙ Ekzistenca e një politike kombëtare për promovimin e barazisë gjimore;
- ⊙ Organizata sportive drejtohet nga një grua (Po/Jo);
- ⊙ Përqindja ose numri i grave në bordet ekzekutive;
- ⊙ Përqindja ose numri i grave në komitete;
- ⊙ Numri i personave me aftësi të kufizuara në pozita vendimmarrëse në federatat sportive, të ndara sipas seksit;
- ⊙ Përqindja e drejtuesve ekzekutivë që kanë marrë trajnim në fushën e barazisë gjimore;
- ⊙ Përqindja e kandidatëve për poste ekzekutive kanë marrë mentorim;
- ⊙ Përqindja e grave që përfitojnë mundësi për zhvillim profesional në sport;
- ⊙ Dokumente të brendshme të politikave në federatat sportive që promovojnë dhe mbështesin balancën punë-jetë.

FUSHA STRATEGJIKE 2: TRAJNIMI

- ⊙ Përqindja ose numri i trajnereve femra (sipas degëve dhe niveleve të sportit);
- ⊙ Përqindja e trajnereve femra të kualifikuara;
- ⊙ Përqindja e femrave në trajnim elitare;
- ⊙ Përqindja e femrave që punojnë si ndihmëstrajnerë;
- ⊙ Përqindja e trajnereve që kanë marrë zhvillim profesional/mentorim;
- ⊙ Ekzistenca e udhëzimeve dhe trajnimit të përshtatshëm gjinor;
- ⊙ Ekzistenca e nismave/politikave për promovimin e përfaqësimit të trajnereve të punësuar dhe vullnetare në radhët e trajnerëve.

FUSHA STRATEGJIKE 3: STEREOTIPET NË MEDIA

- ⊙ Përqindja e grave dhe burrave që kanë pozita në organizatat mediatike;
- ⊙ Ekzistenca e politikave/praktikave që synojnë rritjen e përfaqësimit të sportistëve femra në organizatat e mediave;
- ⊙ Përqindja e njoftimeve për shtyp/artikujve/videove mbi sportistët/trajnerët meshkuj e femra;
- ⊙ Përqindja e lajmeve/komenteve/reklamave/programeve për sportistët dhe sportistet apo për sportet e meshkujve dhe të femrave;
- ⊙ Numri i spoteve televizive që fokusohen në sportistet femra;
- ⊙ Mbulimi i personave/aktorëve me interes në fushën e sportit të paraqitur në mediat vizuale, sipas gjinisë, dhe përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjimore në media;
- ⊙ Numri i gazetareve në shtypin sportiv dhe media;
- ⊙ Numri i postimeve në mediat sociale ku paraqiten sportiste me aftësi të kufizuara.

FUSHA STRATEGJIKE 4: DHUNA ME BAZË GJIMORE

- ⊙ Ekzistenca e një dokumenti të politikave mbi parandalimin e dhunës me bazë gjimore, me një mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi;
- ⊙ Ekzistenca e një kodi etik dhe të sjelljes për trajnerët;
- ⊙ Ekzistenca e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjimore;
- ⊙ Numri i diskutimeve/mbledhjeve si ekip për ngacmimin dhe abuzimin seksual;
- ⊙ Ekzistenca e programeve për edukimin e sportistëve dhe prindërve për informimin dhe këshillimin e sportistëve për të drejtat e tyre dhe si të ruajnë integritetin dhe autonominë e tyre;
- ⊙ Ekzistenca e programeve të trajnimit për të gjithë individët e përfshirë në sport në lidhje me një sport pa ngacmime, dhe se si të pakësohen rastet e abuzimit të pushtetit;
- ⊙ Numri i rasteve të ngacmimeve seksuale në sportet ekipore dhe individuale të raportuara nga sportiste;
- ⊙ Ekzistenca e mekanizmave dhe procedurave për trajtimin e rasteve të dhunës (Po/Jo).

FUSHA STRATEGJIKE 5: PJESËMARRJA

- ⊙ Përqindja e vajzave, grave, djemve dhe burrave në të gjitha degët e sportit;
- ⊙ Numri i aktiviteteve që ka kryer një organizatë sportive për sportistet, për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave me vajzat në shkolla/ qendra komunitare;
- ⊙ Numri i programeve sportive dhe të aktivitetit fizik që synojnë fuqizimin e vajzave;
- ⊙ Numri i trajnimeve të kryera nga një organizatë sportive për vajzat dhe djemtë, për rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore përmes sporteve;
- ⊙ Numri i objekteve sportive që kanë dhoma zhveshjeje dhe banja për sportistet femra;
- ⊙ Numri i objekteve sportive me sistem ndriçimi funksionues;
- ⊙ Numri i objekteve sportive të aksesueshme me autobus ose ku stacioni i autobusit është deri në 200 metra nga objekti.

- ⊙ Institucionalizimit të trajnimeve ndërgjegjësuese

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA NGA VENDE TË TJERA

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË NGA TURQIA: KRIJIMI I KUSHTEVE TË BARABARTA PËR BARAZI GJINORE

Në kuadër të lëvizjes globale të solidaritetit *HeForShe* të iniciuar nga UN Women, zyra e UN Women në Turqi po bashkëpunon me organizata sportive për fuqizimin e vajzave dhe grave për të luftuar barrierat gjinore dhe diskriminimin. Në vitin 2018, UN Women Turqi dhe klubi sportiv Fenerbahçe bashkuan forcat me mbështetjen e Typrash (Tüpra) – një nga kompanitë e Koç Holding dhe mbështetës i ndikimit të *HeForShe* – që ta kthenin Fenerbahçen në një klub reagues ndaj çështjeve gjinore, duke dhënë kështu një shembull për klubet sportive në nivel kombëtar dhe botëror përmes:

- ⊙ Qasjes me tolerancë zero ndaj të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave;
- ⊙ Miratimit të politikave dhe procedurave të ndjeshme gjinore;

FUSHA STRATEGJIKE 6: FINANCIMI DHE INVESTIMI NË SPORTET E GRAVE

- ⊙ Pagat (të ardhurat e rregullta) të sportistëve, trajnerëve, arbitrave/gjyqtarëve dhe zyrtarëve teknikë/profesionistëve mbështetës meshkuj dhe femra;
- ⊙ Raporti i shpërblimeve për çmimet e marra nga sportistët dhe sportistët, trajnerët dhe trajneret;
- ⊙ Numri i sponsorëve dhe vlera e sponsorizimit që marrin sportistët;
- ⊙ Raporti i pjesëmarrjes në kampionate dhe gara ndërkombëtare midis sportistëve dhe sportistëve;
- ⊙ Ekzistenca e stafit mjekësor në mbështetje të sportistëve dhe sportistëve (Po/Jo);
- ⊙ Mbështetja me trajner atletik për sportistët dhe sportistët;
- ⊙ Cilësia e infrastrukturës/hapësirave për stërvitje: disponueshmëria e dhomës së peshimit, prania e objekteve të përshtatshme dhe të aksesueshme nga femrat.

në lidhje me barazinë gjimore;

- ⊙ Vendosjes së praktikave për kthimin e stadiumeve në vende të përshtatshme për gratë dhe fëmijët;
- ⊙ Mobilizimit të publikut dhe sportdashësve rreth barazisë gjimore.

Ndër veprimtaritë kryesore të planifikuara ishin:

- ⊙ Hartimi i planit për një klub sportiv me ndjeshmëri gjimore:
 - Përcaktimi i parimeve dhe udhëzimeve për zbatim, me përfshirjen e palëve kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit në sporte;
 - Përhapja e parimeve dhe udhëzimeve për zbatim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- ⊙ Transformimi i politikave dhe procedurave:
 - Rishikimi i politikave dhe procedurave të brendshme në përputhje me rekomandimet në analizën gjimore;
 - Hartimi dhe zbatimi i planit të veprimit.
- ⊙ Avokim dhe komunikim për barazinë gjimore në sport dhe përmes sportit:
 - Fuqizimi i palëve interesit brenda sportit, si sportistët, trajnerët dhe punonjësit, që të bëhen mbrojtës dhe shembuj të barazisë gjimore;

- Zbatimi i fushatave avokuese për parandalimin e dhunës me bazë gjimore në sport dhe përmes sportit;
- Organizimi dhe kryerja e veprimtarive avokuese për t'iu kundërvënë stereotipeve gjimore në sport dhe përmes sportit.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË NGA MBRETËRIA E BASHKUAR: PËRSHPEJTUESI I INVESTIMEVE NË SPORTIN E GRAVE

Investimi në sportin e grave do të fuqizohet përmes një skeme të nisur nga Departamenti i Biznesit dhe Tregtisë (DBT), i quajtur Përsheptuesi i Investimeve në Sportin e Grave. Kjo nismë e re, në bashkëpunim me Grupin e Biznesit të Sporteve të kompanisë Deloitte dhe me mbështetjen e Grupit Ndërkombëtar të Punës mbi Gratë dhe Sportet, do të vazhdojë për një vit, duke filluar nga vjeshta e vitit 2023. Nisma do të sjellë së bashku mbajtësit e të drejtave të sporteve të grave me bazë në Mbretërinë e Bashkuar – ligat, ekipet, kampionatet dhe garat dhe veprimtaritë sportive – që kërkojnë investime, me ekspertë nga bota e biznesit dhe investuesit në sporte. Programi i ri do të ofrojë një varg seancash informuese për tregun, aktivitete në ndihmë të krijimit të lidhjeve dhe të rrjeteve, si edhe këshillime të gjithanshme për mbajtësit e të drejtave. Ndër ata që do të përfitojnë nga këto veprimtari janë Superliga e Shoqatës së Futbollit të Grave, Superliga e Netbollit, etj. Qëllimi kryesor është që MB-ja të kthehet në vendin e parë në botë për investime në sportin e grave dhe vajzave. Në procesin e zbatimit mund të marrin pjesë mbajtësit e të drejtave të çdo lige, ekipi, kampionati apo veprimtari sportive të grave me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, që duan të tërheqin investime dhe të zhvillohen më tej. Kjo do të bëhet pa kosto për taksapaguesit, ku të gjithë lektorët dhe këshilltarët do të ofrojnë kohën dhe ekspertizën e tyre falas. Skema do të realizohet përmes partneritetit midis DBT-së dhe Deloitte, që ofrojnë mjediset për mbajtjen e aktiviteteve dhe drejtojnë disa prej seancave. Projekti pilot i Përsheptuesit do të ndihmojë ekipet dhe ligat sportive të grave që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të çojnë përpara sportin e grave dhe vajzave.⁸⁷

87. <https://eu.eventscloud.com/website/12237/>.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË NGA BOSNJA DHE HERCEGOVINA: PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI FIZIKE TË ORGANIZUARA – NJË MËNYRË PËR LUFTIMIN E STRESIT TEK GRATË⁸⁸

Lufta në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 1992 pati ndikim shumë të madh në shëndetin e grave boshnjake. Në vitin 1998, një studim i kryer nga Universiteti i Sarajevës tregoi se vetëm 13 për qind e grave në moshë të mesme (rreth moshës 50 vjeç) kryenin aktivitete fizike ose sport. Si rezultat, Universiteti krijoi një program të sporteve posaçërisht për gratë. Në kuadër të këtij projekti u organizuan veprimtari nga Nahla, një qendër arsimore-edukative e një OJQ-je në Sarajevë. Një nga qëllimet e kësaj nisme ishte që të përmirësonte cilësinë e jetës së grave dhe të familjeve. Kjo nismë kishte për qëllim të krijonte një hapësirë të dedikuar për gratë, ku ato të ndihen të sigurta, të shoqërohen me njëra-tjetrën, të përmirësojnë njohuritë e tyre dhe të fitojnë aftësitë e nevojshme për të gjetur punë dhe për të marrë pjesë aktive në jetën e komunitetit. Nisma synonte veçanërisht që:

- T'i përfshinte gratë në veprimtari sportive të përshtatshme për moshën dhe aftësitë e tyre;
- T'i ndihmonte gratë e traumatizuara nga lufta që të ndiheshin më të qeta fizikisht dhe mendërisht;
- T'u lehtësonte atyre stresin dhe t'u jepte këshilla praktike për mënyrat e relaksimit gjatë ushtrimit të sporteve individuale apo ekipore.

PRAKTIKA TË TJERA TË MIRA NGA VENDET E BE-SË PËR SECILËN NGA GJASHTË FUSHAT STRATEGJIKE

Praktikat e mira që përshkruhen në vijim janë nxjerrë nga Programi i Përbashkët i KiE-së "Të gjithë të përfshirë plus: Promovimi i një barazie më të madhe gjinore në sport."⁸⁹ Për qëllimet e këtij dokumenti, është dhënë një shembull praktikash të mira për secilën prej fushave strategjike të analizuar në këtë dokument.

FUSHA STRATEGJIKE 1:

GRATË NË ROLE UDHËHEQËSE/DREJTUESE

Shembull nga Finlanda: "Udhëheq si grua" – Edukim për rol udhëheqës/drejtues për gratë

"Udhëheq si grua" 2017-2018 ishte pjesë e veprimtarive ndërgjegjësuese dhe përpjekjeve të Komitetit Olimpik Kombëtar të Finlandës për t'i mbështetur organizatat anëtare të tij për ta bërë sportin më të barabartë. Për këtë program njëvjeçar u zgjodhën njëzet udhëheqës vullnetarë nga nivelet vendore, rajonale dhe kombëtare. Programi përbëhej nga pesë sesione dyditore, me detyra të caktuara për t'u kryer midis sesioneve, dhe mentorim. Trajnimi ofroi mjete dhe teknika praktike për caktimin e synimeve personale, si dhe për zhvillim personal dhe krijimin e imazhit personal. Temat kryesore ishin lëvizjet sportive dhe struktura e sportit në Finlandë, vetë-menaxhimi, udhëheqja e të tjerëve, udhëheqja strategjike dhe caktimi i qëllimeve, komunikimi efektiv, menaxhimi konflikteve dhe aftësitë për krijimin e rrjeteve. Koncepti u përhap si praktikë e mirë për federatat sportive dhe do të zhvillohet më tej, sepse Komiteti Olimpik Kombëtar finlandez vazhdon të organizojë programe edukative mbi gratë në role udhëheqëse/drejtuese në periudhën 2019-2021. Programi i parë pati vlerësime pozitive dhe disa pjesëmarrëse kanë marrë pozita të reja në sportet përkatëse. Rezultatet mbështesin pikëpamjen se programet për gratë ndikojnë pozitivisht në barazinë gjinore në sport. Ndër veprimtaritë kryesore të kryera si pjesë e kësaj nisme janë: edukimi me anë të pesë seancave dyditore; një program pjesërisht i strukturuar mentorimi; përpjekje komunikuese për promovimin e udhëheqëseve femra që morën pjesë në program; dhe komunikime për rëndësinë e barazisë gjinore në pozita udhëheqëse/drejtuese, përfshirë një analizë të situatës aktuale në Finlandë dhe si mund të përmirësohet ajo.

Për informacion të mëtejshëm: <https://www.olympiakomitea.fi/olympiakomitea/vastuullisuus/tasa-arvo/johtaa-kuin-nainen/>

Personi i kontaktit: Sari Kuosmanen, sari.kuosmanen@olympiakomitea.fi

⁸⁸. Gjendet në: <https://www.icsspe.org/system/files/CoE%20%20Gender%20Equality%20in%20Sports%20%20Handbook%20on%20Good%20Practices.pdf>

⁸⁹. KiE.(2019). 25 best practices. All in: Towards Gender Balance in Sport (Të gjithë të përfshirë: drejt barazisë gjinore në sport), gjendet në: <https://pip-eu.coe.int/en/web/gender-equality-in-sport/online-library-25-best-practices>

FUSHA STRATEGJIKE 2. TRAJNIMI

Shembull nga Estonia: "Zhvillimi i trajnereve femra"

Në procesin e përgatitjes së një plani strategjik për futbollin e femrave, është thelbësore që të shtohet numri i trajnereve femra, të fokusohet vëmendja tek trajneret aktive, dhe të mbështetet përparimi i kualifikimit të tyre. Gjatë periudhës 2014-2015, Shoqata Estoniane e Futbollit (EFA) u përqendrua në tre grupe: ish-lojtare të nivelit të lartë, trajnere aktive, dhe lojtare aktuale që janë të interesuara të bëhen trajnere ose mësuese të edukimit fizik. Për ish-lojtaret e nivelit të lartë, EFA përdori qasje individuale të përshtatur për secilën. Bazuar në kualifikimet e tyre, EFA ofroi kurse në vijimësi dhe i përfshiu ato në trajnimet të ndryshme të ekipeve kombëtare, duke i mbështetur me mentorim. Për trajneret aktive, EFA organizoi kurse të veçanta për licencën EFA C dhe UEFA B. Një e treta e kursit UEFA B u drejtuan nga një ekspert teknik i UEFA. Për mësueset e edukimit fizik, EFA organizoi një kurs të ri 16-orësh për futbollin masiv, me vëmendje të veçantë tek futbollin e femrave. Për të mbështetur trajneret e futbollit të fëmijëve dhe amator dhe mësuesit e edukimit fizik, EFA botoi një manual me ushtrime futbollit të veçanta. Ai u zhvillua në të gjitha shkollat pjesëmarrëse në këtë nismë, ku u dhuruan edhe topa futbollit dhe jelekë sportivë Nike. Qëllimi i përgjithshëm i nismës ishte që të rritej numri i trajnereve femra të kualifikuara dhe të përgatiteshin klubet për një sistem licencimi në Meistriliga, që është ligë e kategorisë superiore në Estoni.

Kjo nismë synonte të rriste numrin e trajnereve femra të kualifikuara në futbollin e femrave në të gjitha nivelet. EFA vlerësoi nevojat dhe burimet e mundshme njerëzore dhe përgatiti programe trajnimi në të gjitha nivelet, nga mësueset e edukimit fizik deri në nivelin UEFA A, duke synuar përgatitjen e trajnereve potenciale. Objektivat specifike të nismave ishin sa vijon:

- Të rritet numri i trajnereve të kualifikuara në të gjitha nivelet;
- Të organizohen për herë të parë kurset për licencën EFA C dhe UEFA B për futbollin e femrave;
- Të pajisen ish-lojtare të ekipit kombëtar me certifikata trajnimi dhe të përfshihen ato në programet e ekipit kombëtar, me synim që të përdoret përvoja dhe ekspertiza e këtyre ish-

lojtareve të ekipit kombëtar duke i angazhuar në role të ndryshme, si në trajnim, këshillim, ose mbështetje për zhvillimin e lojtareve të tanishme të ekipit kombëtar;

- Të përfshihen trajnerët dhe trajneret e klubeve të femrave në projektin e EFA-s për shkollat, me qëllim aftësimin e tyre për të praktikuar me sukses, përmes organizimit të vizitave shkollore;
- Të mbështeten mësuesit e edukimit fizik dhe trajnerët e futbollit amator dhe të fëmijëve, duke i pajisur me një manual të përgjithshëm me ushtrime futbollit;
- Të përgatiten klubet më kryesore të futbollit të femrave për procesin e licencimit brenda klubit.

Ndër veprimtaritë kryesore të kryera gjatë kësaj nisme ishin:

- Vlerësimi i profileve të trajnereve aktuale të futbollit të femrave dhe identifikimi i kandidateve të mundshme për trajnerë ndër lojtaret aktuale;
- Në konferencën vjetore të futbollit të femrave, drejtori teknik i futbollit të femrave paraqiti projektin, së bashku me një shpjegim për situatën aktuale, objektivat dhe treguesit kyçë të performancës;
- Përgatitja dhe zbatimi i kurseve të veçanta EFA C dhe UEFA B të futbollit të femrave, në bashkëpunim me departamentin e futbollit të femrave dhe departamentin e trajnimeve të EFA-s;
- Krijimi i një seksioni të futbollit të grave në kurset e futbollit amator dhe të fëmijëve për mësuesit e edukimit fizik;
- Vëmendje e veçantë tek futbollin e vajzave në projektin e EFA-s për shkollat, duke përfshirë trajnerët vendorë të futbollit të femrave në vizitat shkollore;
- Përfshirja e ish-lojtareve të ekipit kombëtar në programet e ekipit kombëtar, në rolin e trajnereve dhe mentoreve;
- Hartimi i një manuali të veçantë për ushtrime futbollit për nivelin e futbollit amator dhe të fëmijëve.

Për informacion të mëtejshëm:

Women's Coaches Development - All In: Towards Gender Balance in Sport (coe.int)

Personi i kontaktit: Anne Rei, anne@jalgpall.ee

FUSHA STRATEGJIKE 3: STEREOTIPET NË MEDIA

Shembull nga Kroacia: Rrija e vizibilitetit të sportisteve femra në mediat elektronike

Në kuadër të kësaj nisme, Agjencia për Mediat Elektronike, Komiteti Olimpik Kroat dhe Zyra për Barazi Gjinore e Qeverisë së Republikës së Kroacisë, krijuan dy videoklipe dhe dy reklama muzikore në radio, të cilat u transmetuan në një numër të madh stacionesh televizive dhe radiostacionesh në Kroaci. 100 radiostacione dhe 23 kanale TV i transmetuan videoklipet pa pagesë, që ishte hera e parë në historinë e sportit në Kroaci që sporti i femrave pati pasqyrim kaq të konsiderueshëm në media. Në periudhën nga marsi deri në qershor 2018, u krijuan një numër programesh televizive dhe në radio. Ambasadorë të kësaj fushate ishin sportistë dhe sportiste që u ftuan për të folur për sportin e femrave në programe të ndryshme televizive dhe në radio. Objektivi kryesor i projektit ishte përmirësimi i dukshmërisë së sporteve të femrave në media përmes një fushate mediatike dyjavore.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara në kuadër të kësaj nisme ishin:

- Një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar nga palët kryesore të interesit;
- U krijuan materiale elektronike;
- U identifikuan dhe rekrutuan ambasadorët e nismës;
- Shpërndarja e materialeve elektronike në stacionet televizive dhe radio;
- Bashkëpunimi midis mediave elektronike dhe ambasadorëve që morën pjesë në programe;
- Aktivitete të ndryshme për rritjen e dukshmërisë së fushatës gjatë dhe pas fushatës.

Për informacion të mëtejshëm: <https://www.e-mediji.hr/hr/novosti/zapocela-kampanja-za-vecu-vidljivost-zenskih-sportova-u-elektronickim-medijima/>, <https://www.youtube.com/watch?v=dMGlU9o39D0>, <https://www.youtube.com/watch?v=olbaM5BEzJI>

Personi i kontaktit:

Alma Papi, alma.papic@hoo.hr

FUSHA STRATEGJIKE 4: DHUNA ME BAZË GJINORE

Shembull nga Gjermania: Fushata "Rrjete të forta kundër dhunës"

Fushata u iniciua nga Konfederata Gjermane e Sporteve Olimpikë (KGJSO) në vitin 2008 dhe shërben si platformë për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Çdo vit që nga fillimi i fushatës, KGJSO-ja, në bashkëpunim me një numër shoqatash të arteve marciale dhe partnerë të tjerë të fushatës, ofron kurse prezantuese dhe kurse vetëmbrojtjeje për vajzat dhe gratë.

Gjithashtu, klubet dhe organizatat e përfshira kryejnë më shumë se 200 aktivitete ndërgjegjësuese çdo vit. Fushata përdor parimin e tolerancës zero ndaj dhunës së çdo lloji dhe synon të forcojë vetëbesimin dhe vetësigurinë përmes sporteve, duke zhvilluar dhe ofruar trajnime mbi vetëmbrojtjen dhe vetëbesimin. Për këtë arsye, fushata ofron mjete për përmirësimin e gjendjes fizike dhe mirëqenies së përgjithshme të pjesëmarrësve. Në fushatë janë përfshirë edhe shërbime vendore të këshillimit, si dhe janë bërë publike masa për parandalimin e dhunës. Me fushatën e saj, KGJSO-ja ka krijuar një format me anë të të cilit vajzat dhe gratë ndërtojnë aftësi të vetësigurisë, vetëmbrojtjes dhe vetëbesimit në sport dhe përmes sportit. Përveç kësaj, masat parandaluese për mbrojtje nga dhuna do të zgjerohen dhe do të lidhen në mënyrë më të efektshme përmes bashkëpunimit të gjerë me shoqata të ndryshme të arteve marciale dhe me partnerë të fushatës. Kështu, KGJSO-ja angazhohet me parimin e tolerancës zero ndaj dhunës si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel vendor.

Aktivitetet kryesore të kryera në kuadër të kësaj nisme janë:

- Zhvillimi i partneriteteve;
- Këshillimi i organizatave anëtare;
- Krijimi i një grupi ekspertësh dhe ofrimi i njohurive eksperte;
- Ofrimi i materialeve të fushatës.

Për informacion të mëtejshëm:

www.aktiongegengewalt.dosb.de

Personi i kontaktit: Natalie Rittgasser,
rittgasser@dosb.de

FUSHA STRATEGJIKE 5. PJSËMARRJA

Shembull i praktikës së mirë nga Suedia: Pesë hapa drejt një lëvizjeje sportive të barabartë gjinore dhe gjithëpërfshirëse

Kursi ofrohet nga Konfederata Suedeze e Sporteve. Kursi është hartuar për udhëheqës, trajnerë dhe vendimmarrës në organizatat sportive. Pjesëmarrësit e synuar janë individë që mund të ushtrojnë ndikim dhe të zbatojnë ndryshime në klubet ose organizatat e tyre, duke pasur në fokus promovimin e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjen në sporte.

Kursi trajnuet zhvillohet në një ditë të plotë, qoftë me pjesëmarrje në person, ose me anë të videokonferencës. Gjatë kursit ne trajtojmë pesë hapa drejt një lëvizjeje sportive me barazi gjinore dhe gjithëpërfshirëse (që përshkruhet më poshtë), dhe pjesëmarrësit njihen me mjete për të filluar dhe vazhduar një punë me qasje kritike ndaj normave ekzistuese⁹⁰ për promovimin e përfshirjes në organizatat e tyre. Kyç për zbatimin është se pjesëmarrësit mund t'i përdorin këto mjete në mjediset e tyre dhe të fitojnë njohuri dhe besim për t'i ngritur këto pyetje.

Një kurs tjetër i lidhur me atë që u përmend më lart fokusohet në mënyrat që mund të përdoren për të frymëzuar dhe motivuar klubet dhe organizatat për të punuar me barazinë gjinore, sidomos ato që në fillim nuk duken të interesuara. Kursi merr në shqyrtim pyetje si: "Çfarë argumentesh ngrihen kundër barazisë gjinore ose përfshirjes në sporte? Si bëhet më e fortë puna zhvillimore në organizatat ose klubet sportive, e parë nga këndvështrimi i 'barazisë gjinore dhe përfshirjes'? Pse janë të rëndësishme barazia gjinore dhe përfshirja në lëvizjen sportive në të ardhmen?"

Trajnimit dhe mjetet synojnë të shtojnë ndërgjegjësimin për mënyrën se si ndikojnë normat tek individët, grupet dhe klubet/organizatat ku disa njerëz përfitojnë prej tyre, ndërsa disa të tjerë kanë më pak burime dhe më pak pushtet për shkak të tyre. Një pjesë e rëndësishme e kësaj praktike është ngritja e ndërgjegjësimit se si të kundërshtohen këto norma për të siguruar që njerëzit dhe grupet të kenë mundësi të barabarta në ushtrimin e sporteve, trajnime dhe proceset vendimmarrëse në sporte në Suedi. Barazia gjinore është në themel të kësaj pune, por edhe aspekte të tjera, si identiteti gjinor, orientimi seksual, mosha, prejardhja sociale dhe etnike, dhe aftësitë e kufizuara janë gjithashtu pjesë e trajnimit dhe e mjeteve të ofruara për këtë qëllim, për shkak të rëndësisë së të kuptuarit të ndërthurjeve të strukturave të pushtetit në këtë lloj pune.

Ndër aktivitetet/hapat kryesorë në kuadër të kësaj nisme përfshihen:

- ⊙ *Gjendja aktuale: cila është gjendja e organizatave sot?* Pjesëmarrësit nxiten të mendojnë për gjendjen e tanishme dhe të reflektojnë se kush e ka të lehtë të bëhet pjesë e organizatës – cila është norma në organizatën tonë? Gjatë këtij hapi përdoret një mjet i quajtur "samtalsduk," ose "shalli i diskutimit" ku pjesëmarrësit analizojnë dhomën e sportistëve, dhomën e bordit, trajnimit dhe arenën e kampionateve dhe garave, për të menduar se kush është i pranishëm aty, kush nuk është, si tingëllon gjuha e përdorur – a do të ndiheshin të gjithë të mirëpritur? Pjesëmarrësit kanë gjithashtu kohë të reflektojnë për pyetjen "Pse?" Pse është kështu?

Në këto veprimtari u përdor edhe një mjet që quhet "prova teflon", ku pjesëmarrëset identifikojnë nëse kanë përjetuar seksizëm, racizëm, homofobi, ose transfobi. Ato diskutojnë edhe se çfarë privilegjesh sjell qenia pjesë e normës dhe mospërjetimi i shtypjes së çfarëdo lloji, që mund të jetë një fillim i mirë që dikush të

90. Puna me qasje kritike ndaj normave përkufizohet si shqyrtim dhe kundërshtim i normave, praktikave dhe strukturave ekzistuese të pushtetit në një organizatë, të cilat mund të çojnë në vazhdimin e pabarazisë ose përjashtimit. Qëllimi është që të vlerësohen këto norma me sy kritik dhe të promovohen praktika më gjithëpërfshirëse.

realizojë rolin e vet në strukturë.

- *Synimet: ku po shkon organizata?*
Pjesëmarrëseve u jepet mundësia të mendojnë se ku duan të arrijnë dhe çfarë është realiste të caktohet si synim për të ardhmen e afërt.
- *Kontrolli i njohurive: çfarë duhet të mësojë organizata për të arritur këto synime?*
Pjesëmarrëseve u jepet mundësia të reflektojnë: çfarë nuk dimë sot? Për shembull, nëse klubi është i përbërë vetëm nga anëtarë të racës së bardhë dhe synon të ketë anëtarësi më të gjerë, anëtarët mund të përballen me vështirësi që lidhen me njohuritë për racizmin dhe privilegjin e racës së bardhë, dhe duhet të marrin masa që t'i fitojnë këto njohuri për ta çuar klubin në një drejtim më gjithëpërfshirës.
- *Veprimi: Çfarë duhet të bëjë organizata dhe çfarë ndryshimesh duhen bërë për t'i arritur këto synime?*
Fjalët duhet të kthehen në vepra dhe klubet e praktikojnë këtë për të parë se çfarë duhet bërë. A ka diçka që duhet të fillojnë të bëjnë, të vazhdojnë të bëjnë ose të mos e bëjnë më?
- *Mbështetja dhe mbështetje mund të gjatë*
mbështetje o...
për ndryshime...
ncë? Tema...
në lidhje me stru...
mund të bëhen shkas...
fajit dhe zemërimit, dhe këto mund...
një grup ose organizatë. Për këtë...
rëndësishme të mendohet se çfarë rezistenc...
të haset gjatë kësaj pune dhe si mund të...
ajo. Pjesëmarrësit identifikojnë se kë du...
si aleatë (për shembull, bordet e klub...
çuar përpara punën dhe ndryshimet.

Për informacion të mëtejshëm:

www.inkluderandeidrott.se,
www.strategi2025.se

Personi i kontaktit: Sofia B. Karlsson, Sofia.
bkarlsson@rf.se

FUSHA STRATEGJIKE 6: FINANCIMI DHE INVESTIMET PËR SPORTET E FEMRAVE

Shembull praktike të mirë nga Irlanda: Programi “Gratë në Sporte”

Në tetor 2005, në Irlandë filloi zbatimi i nismës ‘Gratë në Sport’ i organizatës *Sport Ireland* (që më parë njihet si Këshilli Sportiv i Irlandës). Kjo nismë u krijua për të mbështetur realizimin e vizionit strategjik të *Sport Ireland* sidomos përmes rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave të të gjitha moshave në sport. Që nga viti 2005, në kuadër të këtij programi janë investuar mbi 18 milion euro. Këto fonde i janë dhënë organeve që financohen nga *Sport Ireland*, konkretisht organeve kombëtare qeverisëse të sportit (*National Governing Bodies of Sport -NGB*) dhe rrjetit të partneriteteve sportive vendore (*local sport partnerships – LSP*). Niveli më i lartë i investimeve ishte në vitin 2008, me mbi 2.5 milion euro investime. Përmes këtij programi, *Sport Ireland* po mbështet një numër grash në veprimtaritë sportive që realizohen nga marrësit e këtyre fondeve (NGB-të dhe LSP-të).



BIBLIOGRAFI

Sa u takon grave në sport, vizioni strategjik i *Sport Ireland* ka qenë që të rrisë nivelin e përgjithshëm të aktivitetit fizik në radhët e grave; të mbështesë rolet e grave në organizatat sportive në fusha si trajnimi dhe menaxhimi dhe të mbështesë mirëqeverisjen përmes përfaqësimit të balancuar gjinor në të gjitha nivelet. Ndër veprimtaritë kryesore të kësaj nisme janë:

- ⊙ Sektori i sporteve (NGB-të dhe LSP-të) u ftuan të propozonin projekte, aktivitete, dhe programe novatore të bazuara në fakte, të cilat synojnë të rrisin përfshirjen e femrave në sport në të gjitha nivelet.
- ⊙ Sport Ireland do të ofrojë mbështetje për vlerësimin e ndikimit dhe të rezultateve të projekteve të mbështetura.

Për informacion të mëtejshëm:

www.sportireland.ie

Personi i kontaktit: Shane Califf,
scaliff@sportireland.ie

1. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. *Gender & Sport. Mainstreaming Gender in Sports Projects* (Gjinia dhe sporti. Integrimi i perspektivës gjinore në projekte sportive).
2. Bashkimi Evropian (2020). *Bashkimi Evropian (2020) Joint Communication to the European Parliament and the Council: EU Gender Action Plan (GAP) III – an Ambitious Agenda for Gender Equality and Women’s Empowerment in EU External Action* (Komunikatë e përbashkët drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit: Plani i Veprimit Gjinor (PVGJ) III i BE-së – një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shërbimin e Jashtëm të BE-së). Gjetet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020JC0017>
3. Brady, M. (2005). *Creating Safe Spaces and Building Social Assets for Young Women In The Developing World: A New Role For Sport* (Krijimi i hapësirave të sigurta dhe ndërtimi i aseteve sociale për vajzat dhe gratë e reja në vendet në zhvillim: një rol i ri për sportin), *Women’s Studies Quarterly* 33:1&2.
4. *Central European Journal of Sport Sciences and Medicine*, Vol. 33, No. 1/2021: 27–41 | DOI: 10.18276/cej.2021.1-03. *Gender Inequality and Female Sports Participation in Turkey* (Pabarazia gjinore dhe pjesëmarrja e femrave në sporte në Turqi)
5. Çela, K. dhe Haxhi, P. (2015). “E drejta e krahasuar e punës”, Tiranë.
6. Çela, K., (2011). “E drejta e punës”, Tiranë.
7. Deklarata e Maglingenit. Gjetet në: https://www.sportanddev.org/sites/default/files/downloads/18_the_maglingen_declaration.pdf

8. Divizioni i Kombeve të Bashkuara për Përparimin e Grave (UN Women) Departamenti i Çështjeve ekonomike dhe Sociale (2007). *Women, gender equality and sport, Women 2000 and beyond* (Gratë, barazia gjinore dhe sporti: Gratë në vitin 2000 e tutje).
9. *EU Work Plan for Sports* (Plani i punës për sportet i BE-së). Gjendet në: <https://www.ecos-europe.com/wp-content/uploads/2020/12/Workplan-UE-sport-2021-2024.pdf>
10. Fasting, K. et al. (2011). *Sexual Harassment in sport toward Females in Three European Countries* (Ngacmimi seksual në sport ndaj femrave në tre shtete evropiane), *International Review for the Sociology of Sport* (Revista ndërkombëtare e sociologjisë në sport), 46, Nr. 1, 76–89, <https://doi.org/10.1177/1012690210376295>;
11. Federata Shqiptare e Futbollit (2023). *Rising Stars*. Plani Strategjik i Federatës Shqiptare të Futbollit të Femrave 2023-2025
12. Garson, F., C. McCormack, dhe J. Walsh (2018). *Women in Sport Training: Challenges, Stress and Well-being* (Gratë në trajnimin sportiv: sfidat, stresi dhe mirëqenia), *ACTIVE: Journal of Physical Education, Sport, Health and Recreation* (Aktive: Revista e edukimit fizik, sportit, shëndetit dhe argëtimit) 7, Nr. 2, 63–67, <https://doi.org/10.15294/active.v7i2.22100>.
13. *Gender Equality Index for the Republic of Albania 2020* (Indeksi i barazisë gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020). Gjendet në: https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_albania.pdf
14. https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/LOB_i_ri_nr._57_dt_02.06.2016_-_MIRATUAR_ne_KUVEND_ENGLISH.rtf
15. <https://rm.coe.int/analytical-report-of-the-data-collection-campaign-all-in-towards-gende/1680971a71>
16. <https://www.un.org/womenwatch/daw/public/Women%20and%20Sport.pdf>
17. <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/News%20and%20events/Stories/2020/Sport-GenerationEquality.pdf>
18. IEBGJ (2017). *Gender in sport* (Gjinia në sport). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/publications/gender-sport>
19. IEBGJ, *Gender Equality in sports* (Barazia gjinore në sporte). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/mh0215937enn.pdf>
20. Institute for Diversity and Ethics in Sport (Instituti për Diversitet dhe Etikë në Sport) (2018). *The 2018 Sports Media Racial and Gender Report Card: Associated Press Sports Editors (APSE)* (Vlerësimi i mbulimit nga mediat sportive të çështjeve racore dhe gjinore i vitit 2018: Redaktorët sportivë të Associated Press (APSE) gjendet në: https://www.tidesport.org/files/ugd/7d86e5_9dca4bc2067241cdba67aa2f1b09fd1b.pdf
21. Interim Asian Women and Sport Working Group (2001). *Asian Women and Sport Action Plan 2001* (Gratë aziatike dhe Plani i Veprimit për Sportin 2001), 15 dhjetor 2001. Osaka, Japonin. Gjendet në http://www.jws.or.jp/ae/actionplan_eng.pdf
22. *International Platform on Sport & Development* (Platforma ndërkombëtare mbi sportin dhe zhvillimin) (qershor 2009). *Sport and Gender thematic profile* (Profili tematik sporti dhe gjinia),
23. Katsarova, I. (2019). *Gender Equality in Sport: Getting Closer Every Day* (Barazia gjinore në sport: më afër çdo ditë), Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian. Gjendet

- në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/ EPRS_BRI\(2019\)635560_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635560/ EPRS_BRI(2019)635560_EN.pdf)
24. Këshilli i Evropës (2015). *Reccomendation CM/Rec(2015)2 of the Committee of Ministers to member States on gender mainstreaming in sport* (Rekomandimi CM/Rec(2015)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me integrimin gjinor në sport), Pub. L. Nr. CM/Rec(2015)2 (2015). Gjetet në: <https://www.icsspe.org/system/files/Council%20of%20Europe%20Recommendation%20Gender%20Mainstreaming%20CM%20Rec%20%282015%292.pdf>
 25. Këshilli i Evropës (2018). Këshilli i Evropës Strategjia e Barazisë Gjimore 2018-2023, Strasbourg. Gjetet në: <https://rm.coe.int/prems-093618-gbr-gender-equality-strategy-2023-web-a5/16808b47e1>.
 26. Këshilli i Evropës (2019) *Recommendation CM/Rec(2019)1 on Preventing and combating sexism* (Rekomandimi CM/Rec(2019) mbi parandalimin dhe luftimin e seksizmit). Gjetet në: <https://rm.coe.int/cm-rec-2019-1-on-preventing-and-combating-sexism/168094d894>.
 27. Këshilli i Evropës (2019). *25 best practices - ALL IN: Towards gender balance në sport* (25 praktikat më të mira: Të gjithë të përfshirë: drejt balancës gjimore në sport) . Gjetet në: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/gender-equality-in-sport/online-library-25-best-practices>
 28. Këshilli i Evropës (2019). *All In! Towards Gender Balance in European Sport* (Të gjithë të përfshirë: drejt balancës gjimore në sport). Raport analitik i fushatës së mbledhjes së të dhënave.
 29. Këshilli i Evropës, (2011). *Handbook on good practices. Gender equality in sports* (Manual i praktikave të mira: Barazia gjimore në sporte)
 30. Këshilli i Evropës, Strategjia e Barazisë Gjimore 2018-2023.
 31. Këshilli i Evropës, Strategjia e Barazisë Gjimore 2018-2023. Gjetet në: <https://rm.coe.int/prems-093618-gbr-gender-equality-strategy-2023-web-a5/16808b47e1>
 32. Kombet e Bashkuara (2010). *Agreed Conclusions of the Commission on the Status of Women on the Critical Areas of Concern of the Beijing Platform for Action 1996-2009* (Përfundimet e rëna dakord të Komisionit për Statusin e Grave dhe fusha shqetësuese kritike të Platformës për Veprim të Pekinit 1996-2009). Gjetet në: <https://doi.org/10.18356/5fa286bb-en>.
 33. Kombet e Bashkuara (2015). *Transforming Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development* (Të Shndërrojme Botën Tonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm). Gjetet në: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>
 34. Komisioni Evropian (2011). *Developing the European Dimension in sport* (Zhvillimi i dimensionit gjinor në sport), Bruksel. Gjetet në: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0012:FIN:en:PDF>
 35. Komisioni Evropian (2020). Komunikatë e Komisionit Drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve, *A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025* (Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjimore 2020-2025), Bruksel. Gjetet në: <https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN>
 36. Komisioni Evropian (2021). *Recommendation CM/Rec(2021) of the Committee of Ministers to Member States on the Revised European*

- Sports Charter* (Rekomandimi CM/Rec(2021) i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi Kartën Evropiane të Sportit, e rishikuar), Bruksel. Gjetet në: <https://rm.coe.int/recommendation-cm-rec-2021-5-on-the-revision-of-the-european-sport-cha/1680a43914>.
37. Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin, Rininë, Sportin dhe Kulturën (2022). *Towards more gender equality in sport: Recommendations and Action Plan From the High Level Group on gender equality in sport* (Drejt një barazie më të madhe gjinore në sport: rekomandime dhe plan veprimi nga grupi i nivelit të lartë mbi barazinë gjinore në sport) Bruksel. Gjetet në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/684ab3af-9f57-11ec-83e1-01aa75ed71a1>
38. Komisioni Evropian. *Towards more gender equality in sport* (Drejt një barazie më të madhe gjinore në sport).
39. Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007). *White Paper on Sport* (Libri i Bardhë për Sportin), Bruksel. Gjetet në: <https://eurlex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52007DC0391&from=CS>.
40. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (2020). *Olympic Charter* (Karta Olimpikë) Lozanë. Gjetet në: <https://stillmed.olympic.org/media/Document%20Library/OlympicOrg/General/EN-Olympic-Charter.pdf>
41. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (2021). *Gender equality & inclusion report 2021* (Raport i barazisë gjinore dhe përfshirjes gjinore 2021).
42. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (2022). *Gender Equality and Inclusion Objectives 2021-2024* (Objektivat e barazisë dhe përfshirjes gjinore 2021-2024), Lozanë. Gjetet në: <https://stillmed.olympics.com/media/Documents/Beyond-the-Games/GenderEquality-in-Sport/IOC-Gender-Equality-and-Inclusion-Objectives-2021-2024.pdf>
43. Ligji nr.10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Gjetet në: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/2.pd>
44. Ligji nr.57, datë 2 qershor 2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. .9936/2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)'" . Gjetet në: Ligji nr.9870/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri". Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/e/36682.pdf>
45. Ligji nr.1976, datë 21 prill 2005, "Ligji për Sportin". Gjetet në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Permbledhje-L51.pdf>
46. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, (2022). *Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029*.
47. Ministria e Arsimit dhe Kulturës e Finlandës (2018). *Sport and Equality 2017. An overview of the current status of gender equality in sports and physical activity* (Sporti dhe barazia 2017. Një pasqyrë e gjendjes aktuale të barazisë gjinore në sporte dhe aktivitete sportive).
48. Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) (1978). *International Charter of Physical Education and Sport* (Karta Ndërkombëtare e Edukimit Fizik dhe Sportit). Gjetet në: https://en.unesco.org/sites/default/files/sport_e.pdf
49. Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) (2015). *International Charter of Physical Education, Physical Activity and Sport* (Karta Ndërkombëtare e Edukimit Fizik, Aktiviteteve Fizike dhe Sportit). Gjetet në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000235409>
50. Parlamenti Evropian (2012). *Charter of Fundamental Rights of the European Union* (Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian). Gjetet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:12012P/TXT&from=cs>

51. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024.
52. Programi Kombëtar Qeverisës 2021-2025. Gjendet në: https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf, f. 31
53. UN Women (2014). *Beijing Declaration and Platform for Action: Beijing+5 Political Declaration and Outcome* (Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim: Deklarata politike e Pekinit +5 dhe rezultati). Gjendet në: https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/KSG/PFA_E_Final_WEB.pdf
54. UN Women (2020). *Sports for Generation Equality Framework: Driving Implementation of the Beijing Platform for Action through the Power of the Sport Ecosystem* (Sportet në kuadrin e brezit të barazisë: Forcimi i zbatimit të Platformës për Veprim të Pekinit përmes ekosistemit të sportit). Gjendet në:
55. UN Women (2021). *Guidelines for Gender-Responsive Sports Organizations* (Udhëzues për Organizata Sportive Reaguese Gjinore). Gjendet në: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ECA/Attachments/Publications/2021/7/OKBWOMEN_Guidelines%20ENG-min.pdf
56. UN Women (2022). *Analysis on Gender Equality in Sport In North Macedonia* (Analizë e barazisë gjinore në sport në Maqedoninë e Veriut)
57. Un Women. *COVID-19, Women, Girls and Sport: Build Back Better* (Gratë, vajzat dhe sporti: të rindërtojmë më mirë).
58. Un Women. *HeForShe Turkey Fenerbahçe Sports Club Partnership: Levelling the playing field for gender equality* (Partneriteti midis HeforShe Turqi dhe klubit sportiv Fenerbahçe: Krijimi i kushteve të barabarta të lojës për barazi gjinore).
59. UNESCO (2017) *Kazan Action Plan International Conference of Ministers and Senior Officials Responsible for Physical Education and Sport* (Plani i Veprimit i Konferencës së Gjashtë Ndërkombëtare të ministrave dhe zyrtarëve të lartë përgjegjës për edukimin fizik dhe sportin, Kazan, Federata Ruse, 2017. Gjendet në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000252725>
60. Vinciguerra et al., (2019), *Sport Management. Legal Sports Aspects of the Law on Sport in Albania* (Menaxhimi sportiv: Aspekte ligjore sportive të Ligjit për Sportin në Shqipëri). Në *European Journal of Health and Science in Sports* (Periodiku evropian mbi shëndetin dhe shkencën në sport). Volume 6, issue 1.

Lidhje në internet

https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2012-0025_EN.html

<https://rm.coe.int/168008482e>

<https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-68-date-27.4.2017.pdf>

https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29_Anglisht.pdf

<https://ashs.gov.al/>

<https://rm.coe.int/albania-gender-equality-in-sport-leaflet-2019-/1680971a1c>

<https://en.unesco.org/themes/gender-equality-sports-media>

[STATISTICAL-YEARBOOK-ON-EDUCATION-AND-SPORTS-2021-2022-ENG-FINAL.pdf \(arsimi.gov.al\)](https://arsimi.gov.al/STATISTICAL-YEARBOOK-ON-EDUCATION-AND-SPORTS-2021-2022-ENG-FINAL.pdf)

[https://eu.eventscloud.com/website/12237/.](https://eu.eventscloud.com/website/12237/)

